



STUDIMI BALLKANIK EPIDEMIOLOGJIK MBI ABUZIMIN & NEGLIZHIMIN E FËMIJËVE (BECAN)

DG-RESEARCH [Nr. i kontratës: FP7-HEALTH-F2-2009-223478]

MANUAL TRAJNIMI & UDHËRRËFYES *PËR PYETËSORËT E MODIFIKUAR ICAST-CH & ICAST-P*

Përgatitur nga



Instituti për Shëndetin e Fëmijës
Departmenti i Shëndetit Mendor dhe Çështjeve Sociale
Qendra për Studimin dhe Parandalimin e
Abuzimit dhe Neglizhimit të Fëmijëve

ATHINË, Prill 2010



*Puna për përgatitjen e këtij dokumenti është financuar nga Programi
7th Framework i Komunitetit Europian (FP7/2007-2013)
nën marrëveshjen e grantit nr HEALTH-F2-2009-223478*

PËRMBAJTJA

KREU A. PYETËSORËT ICAST-C & ICAST-P	6
A.1. Kush i hartoi dokumentet ICAST?	6
A.2. Pse duhet hartuar nje dokumentacion ndërkombëtar mbi disiplinën dhe abuzimin?	6
A.3. Pse janë të rëndësishme këto dokumente dhe pse janë të rëndësishme dokumentet e e përbashkëta?	7
A.4. Kush mund t'i përdorë dokumentet ICAST?	8
A.5. Si përkufizohet dhuna ose abuzimi në këto dokumente?	8
KREU B. STUDIMI EPIDEMIOLOGJIK BALLKANIK MBI ABUZIMIN DHE NEGLIZHIMIN E FËMIJËVE (BECAN)	9
B.1. Metodologjia e Studimit Epidemiologjik	9
B.2. Përzgjedhja e kampioneve	10
B.3. Faza Përgatitore e Studimit Epidemiologjik	10
B.3.1. Lejimi i përdorimit të Dokumenteve	11
B.3.2. Përshtatja dhe përkthimi i dokumenteve	11
B.3.3. Pilotimi i dokumenteve	12
KREU C. ORGANIZIMI I SONDAZHIT	15
C.1. Kualifikimet e studiuësve kërkimorë	15
C.2. Seminar trajnimi për studiuësit	15
C.3. Koordinimi i punës kërkimore në terren	17
C.4. Organizimi i sondazhit në shkolla	20
C.5. Organizimi i sondazhit për fëmijët që kanë lënë shkollën	22
C.6. Prërgatitja e materialeve të studiuësve	23
C.7. Mënyrat e raportimit nga studiuësit	26
KREU D. KRYERJA E SONDAZHIT	28
D.1. Shpërndarja e pyetësorëve ICAST-C dhe ICAST-P	28
D.1.1. Pyetësori që plotësohet nga vetë pjesëmarrësit	28
D.1.2. Intervistat e strukturuar	29
D.1.2.1. Përgatitja e intervistës	30
KREU E. PAS MBLEDHJES SË TË DHËNAVE	32
E.1. Verifikimi i cilësisë së të dhënave	32
E.2. Siguria e të dhënave	32
E.3. Hedhja e të dhënave dhe kodimi i tyre	32
KREU F. ÇËSHTJE TË ETIKËS DHE SIGURISË	34
F.1. Çështje të etikës	34
F.1.1. Privatësia dhe konfidencialiteti	35
F.1.2. Fshehja e e pjesshme e qëllimit të studimit	36
F.1.3. E drejta për të refuzuar pjesëmarrjen dhe për t'u tërhequr	36
F.1.4. Miratimi i pjesëmarrjes në sondazh	37
F.1.5. Takimet Informuese	37
F.1.6. Ruajtja dhe aksesimi i të dhënave	38
F.1.7. Përshtetja e sondazhit në publik	38
F.2. Çështje të Sigurisë	38
F.2.1. Mbikëqyrja e rasteve kritike dhe ndërhyrja në to	38
F.2.2. Reagimi në rastet e abuzimit dhe neglizimit (CAN)	40
F.2.3. Siguria e pjesëmarrësve dhe studiuësve	42
F.3. Çfarë duhet bërë nëse...	43
REFERENCA	

UDHËRRËFYES PËR STUDIUESIT KËRKIMORË

KREU A. DETYRIMET ESTUDIUESVE DHE PËRGATITJA E TYRE

- A.1. Kualifikimet e studiuësve**
- A.3. Përshkrimi hap pas hapi i një dite të zakonshme kërkimi në terren"**
- A.4. Materialet që nevojiten gjatë mbledhjes së të dhënave**

KREU B. KRYERJA E SONDAZHIT

- B.1. Pyetësi që plotësohet nga pjesëmarrësit**
- B.1.1. Udhëzime për pyetësit**
- B.2. Intervistat e strukturuar**
 - B.2.1. Këshilla të vlefshme për intervistuesit gjatë intervistave**
 - B.2.2. Udhëzues interviste për prindër**
 - B.2.3. Udhëzues interviste për fëmijë**

KREU C. PAS MBLEDHJES SË TË DHËNAVE

- C.1. Verifikimi i cilësisë së të dhënave**

KREU D. ÇËSHTJE TË ETIKËS DHE TË SIGURISË

- D.1. Privatësia dhe konfidencialiteti**
- D.2. Fshehja e e pjeshme e qëllimit të studimit**
- D.3. E drejta për të refuzuar pjesëmarrjen dhe për t'u tërhequr**
- D.4. Miratimi i pjesëmarrjes në sondazh**
- D.5. Takimet informuese**
- D.6. Siguria e të dhënave**
- D.7. Përshkrimi i sondazhit në publik**
- D.8. Reagimi në rastet e abuzimit dhe neglizhimit (CAN)**
- D.9. Siguria e pjesëmarrësve dhe studiuësve**
- D.10. Çfarë duhet bërë nëse...**

SHTOJCA

- Shtojca 1: Pyetje të Mundshme të Pjesëmarrësve dhe Përgjigje Standarde**
- Shtojca 2a: Formulari i Raportimit - Pyetësorë të Vetëadministruar (në shkollë)**
- Shtojca 2b: Formulari i Raportimit – Intervista të Strukturuar**
- Shtojca 3a: Skeda Interviste për Prindërit**
- Shtojca 3b: Skeda Interviste për Pëmijët**
- Shtojca 4a: Pyetësi i Përshtatur ICAST-C (për fëmijë)**
- Shtojca 4b: Pyetësi i Përshtatur ICAST-P (për prindër)**

NJOHURI TË PËRGJITHSHME MBI MANUALIN

Ky Manual, i cili është hartuar në kuadrin e Projektit “Studimi Epidemiologjik Ballkanik mbi Abuzimin dhe Neglizimin e Fëmijëve” (BECAN), bazohet mbi parimet e Manualeve ICAST-C dhe ICAST-P të cilët janë hartuar nga Shoqata Ndërkombëtare për Parandalimin e Abuzimit dhe Neglizimin së Fëmijëve (ISPCAN, 2006a,b). Manuali është plotësuar me disa nëndarje specifike me qëllim që të plotësojë të gjitha nevojat metodologjike dhe edukative të Studiuesve Kërkimorë të Terrenit të cilët do të ndërmarrin mbledhjen e të dhënave në kontekstin e studimeve epidemiologjike BECAN në 9 vende Ballkanike.

Synimi i këtij Manuali është të ofrojë udhëzime të vlefshme për Trajnuesit e Ekipeve Kombëtare të Studiuesve Kërkimorë, Koordinatorët e Studiuesve në Terren dhe/ose Koordinatorët Lokalë e kryesisht për Studiuesit Kërkimorë në Terren me qëllim që Studimi Epidemiologjik BECAN të kryhet në mënyrë uniforme në të gjitha vendet. Grupet e interesit të këtij Manuali janë si Trajnuesit e Ekipeve të Studiuesve Kombëtarë ashtu edhe vetë Studiuesit Kërkimorë në Terren. Si rrjedhim, përveç Shtojcave ai përbëhet nga dy Pjesë:

- **PJESA I: “Manuali i Trajnimit”** përmban Udhërrëfyesin për Koordinatorët Kombëtarë dhe personat që do të ndërmarrin organizimin e sondazhit, por ai është ndërtuar në mënyrë të tillë që të përdoret edhe nga **Trajnuesit** e Ekipeve të Studiuesve Kombëtarë me qëllim që të sigurojë një trajnim të standardizuar të studiuesve kërkimorë në të gjitha vendet pjesëmarrëse.
- **PJESA II: “Udhërrëfyes për Studiuesit Kërkimorë”** është hartuar në mënyrë të tillë që të ofrojë një material të gatshëm për shtyp i cili do t’u shpërndahet Studiuesve në Terren gjatë trajnimit të tyre, duke i pajisur kështu me një udhëzues të dobishëm që ata do ta mbajnë me vete gjatë punës në terren.

Të gjithë Studiuesit Shkencorë Kombëtarë dhe anëtarë të tjerë të ekipeve kombëtare që janë trajnuar në Seminarin “Trajno Trajnuesit”, duhet ta përdorin këtë manual për të trajnuar ekipet e studiuesve në vendet e tyre. Manuali ndahet në disa krerë, të cilët trajtojnë në mënyrë të detajuar të gjitha çështjet që lidhen me metodologjinë, përzgjedhjen e kampioneve, administrimin e pyetësorëve, mënyrën e kryerjes së intervistave të strukturuar, çështjet etike dhe kodimin e të dhënave. Në mënyrë më specifike **Pjesa I** e manualit përbëhet nga **6 krerë**:

- ▶ **Kreu A** përmban informacion rreth Pyetësorëve ICAST-CH (për fëmijë) dhe ICAST-P (për prindër) të hartuar nga ISPCAN
- ▶ **Kreu B** përmban informacion mbi fazën përgatitore të Sondazhit Epidemiologjik në kontekstin e projektit BECAN (metodologjia, përzgjedhja e kampionëve, si u bë përshtatja dhe testimi pilot i dokumenteve ICAST, etj.)
- ▶ **Kreu C** përmban informacion mbi organizimin e sondazhit kryesisht, kualifikimin e studiuesve dhe trajnimin e tyre, organizimin dhe koordinimin e sondazhit epidemiologjik BECAN në nivel kombëtar dhe materialet që u nevojiten studiuesve gjatë mbledhjes së të dhënave.
- ▶ **Kreu D** përmban informacion mbi procesin që duhet ndjekur për mbledhjen e të dhënave përmes dy metodave të ndryshme, konkretisht, si të përgatisim një sondazh që bazohet

në pyetësorë që plotësohen nga vetë pjesëmarrësit dhe një sondazh që bazohet në intervista të strukturuar.

- ▶ **Kreu E** përmban informacion mbi hapat që duhen ndjekur pas mbledhjes së të dhënave, konkretisht, kontrolli i cilësisë së të dhënave, ruajtja e të dhënave, hedhja e të dhënave dhe kodimi i tyre.
- ▶ **Kreu F** përmban informacion mbi çështje të etikës dhe sigurisë për studiuesit dhe pjesëmarrësit në këtë studim.

PJESA II e Manualit, konkretisht Udhërrëfyeni për Studiuesit Kërkimorë, përmban të gjithë informacionin që u nevojitet studiuesve në terren. Në të përfshihen detyrimet që ata kanë si studiues, para, gjatë dhe pas mbledhjes së të dhënave, listat e plota të materialeve që u nevojiten gjatë mbledhjes së të dhënave, udhëzime për kryerjen e sondazhit me anë të pyetësorëve dhe intervistave të strukturuar, çfarë duhet bërë pas mbledhjes së të dhënave dhe çështje të tjera të rëndësishme etike dhe sigurie.

Katër **Shtojcat** e përfshira në Manual përmbajnë:

Shtojca 1: Përgjigjet e standardizuara të pyetjeve të mundshme të pjesëmarrësve

Shtojca 2: Formularët e Raportimit

Shtojca 3: Skedat e Intervistave

Shtojca 4: Pyetësorët e përshtatur ICAST-CH dhe ICAST-P.

KREU A. PYETËSORËT ICAST-C & ICAST-P

A.1. Kush i Hartoi Dokumentet ICAST?

Pyetësorët ICAST-C dhe ICAST-P janë hartuar pas shumë takimesh dhe rishikimesh të kryera nga Shoqata Ndërkombëtare për Parandalimin e Abuzimit dhe Neglizhimin të Fëmijëve (ISPCAN) në bashkëpunim me UNICEF-in. “Kjo punë është e lidhur ngushtësisht me Studimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara mbi Dhunën ndaj Fëmijëve. Më shumë se 130 ekspertë nga 43 vende kanë marrë pjesë në procesin e hartimit dhe rishikimit. Procesi për hartimin e dokumenteve ICAST është koordinuar nga drejtuesit e ISPCAN dhe studiues nga Universiteti i Teknologjisë i Queensland-it në Australi (Queensland University of Technology), dhe Universiteti i Karolinës së Veriut në Chapel Hill, SH.B.A” (ISPCAN, 2006a, fq.3).

Dokumentet synojnë të analizojnë format e viktimizimit të fëmijëve në të gjithë botën, por edhe të ofrojnë dokumentacionin e duhur për të gjithë investiguesit që janë të interesuar të analizojnë fenomenin e dhunës ndaj fëmijëve (ISPCAN, 2006a).

A.2. Pse Duhet Hartuar një Dokumentacion Ndërkombëtar mbi Disiplinën dhe Abuzimin?

Të nxitur nga Thirrja e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për një studim mbi Fëmijët dhe Dhunën ndaj tyre, Shoqata Ndërkombëtare për Parandalimin e Abuzimit dhe Neglizhimin të Fëmijëve (ISPCAN) “ka ndërmarrë sfidën e hartimit të dokumenteve që mund të përdoren nga investigues në mbarë botën për të përcaktuar nivelin e dhunës që ushtrohet mbi fëmijët në familje, shkolla,” në punë “dhe komunitete” (ISPCAN, 2006b, fq.1). Për shkak të “kuptimeve të ndryshme në vende dhe kultura të ndryshme, është e vështirë të jepet një përkufizim i plotë i asaj që përbën abuzim në vende të ndryshme. Bazuar në përvojën e mëparshme, ISPCAN mbledhi një grup studiuesish, profesionistësh të kujdesit shëndetësor dhe të tjerë në Brisbane, Australi, në Shtator 2004 për të filluar punën për hartimin e një dokumentacioni ndërkombëtar. ISPCAN nuk ka hartuar një studim, ajo është përqendruar në përgatitjen e një dokumentacioni që mund të përdoret nga të gjithë investiguesit në mbarë botën për të vlerësuar komunitetet dhe vendet e tyre, por duke përdorur një matës të përbashkët për krahasimin e komuniteteve të tyre me komunitetet e tjera. Qasja e ISPCAN është e ngjashme me qasjet e organizatave të tjera për sa i takon inventarizimit të sjelljeve të të rriturve ndaj fëmijëve dhe atyre fëmijë-fëmijë, duke shmangur vënien e etiketave si: kjo sjellje është e pranueshme apo kjo është abuzive. Detyra për çdo dokument ka qenë të përfshijë ato sjellje që janë më të dëmshme apo që hasen më shpesh, ose të dyja” (ISPCAN, 2006b, fq. 1).

“Disiplina e ashpër ndaj fëmijëve dhe abuzimi i tyre mund të jenë akte private, jo publikisht të dukshme për të cilat mund të jenë në dijeni vetëm pjesëmarrësit. ISPCAN ka zgjedhur të hartojë një paketë dokumentesh që mund të përdoren për të mbledhur të dhëna nga pjesëmarrësit, fëmijët (pyetësori ICAST-CH) ose prindërit” (ICAST-P) (ISPCAN, 2006b, fq.1). Pyetësori ICAST-P (për prindër) “është hartuar për të mbledhur të dhëna nga sjellja disiplinore e prindërve ndaj një fëmije të caktuar. Këto të dhëna lejojnë përlllogaritjen e nivelit të formave të ndryshme të disiplinës sipas moshës së fëmijës, dhe përqindjen e prindërve që përdorin forma të ashpra discipline. Kufizimi kryesor është se prindërit mund të mos tregojnë

gjithçka që kanë bërë. Megjithatë eksperiencia në 5 vende ka treguar se kjo qasje mund të prodhojë të dhëna rreth 40 herë më të larta mbi shpeshësinë e rasteve të dhunës se ajo që prodhojnë statistikat zyrtare të autoriteteve, edhe në vende ku ligjet mbi raportimin ka kohë që ekzistojnë”. Përparësi e kësaj qasjeje është se mund të pyeten si prindërit e fëmijëve të vegjël ashtu edhe ata të fëmijëve më të rritur duke përdorur dokumentin në fjalë dhe “përqindja mund të llogaritet pavarësisht nga aftësia e fëmijës për t’iu përgjigjur pyetësorit. Ky dokument mund të kombinohet edhe me masa të tjera ndaj dhunës mes të rriturve, eksperiencia pune, ose edukim të prindërve për të dhënë një tablo të qartë të jetës familjare dhe rreziqet që shoqërojnë disiplinën e ashpër ndaj fëmijëve.”¹ (ISPCAN, 2006b, fq. 1)

ISPCAN ka hartuar gjithashtu edhe pyetësorin ICAST-CH për t’u përdorur me fëmijë 11-vjeçarë e lart (nga ≥ 11 deri në < 18 vjeç). Është e qartë se “shumë studime janë kryer në mbarë botën ku janë pyetur fëmijët e shkollës fillore apo të mesme mbi dhunën që kanë provuar. Këto sondazhe kanë treguar nivele të larta të dhunës ndaj fëmijëve në shumë vende. Çdo sondazh ka përdorur matësin e vet të ndryshëm dhe të pavarur, duke e kufizuar kështu mundësinë e investiguesve për të krahasuar të dhënat e tyre lokale me të dhënat e mbledhura në shkolla, komunitete ose vende të tjera.” (ISPCAN, 2006b, fq. 1-2). Ekziston një debat mbi “çështje etike dhe ligjore që kanë të bëjnë me marrjen drejtpërdrejt në pyetje të fëmijëve lidhur me abuzimin. Në të vërtetë, disa organizata kanë arritur në konkluzionin se përdorimi i pyetësorëve me fëmijët nuk është etik ose i drejtë. Megjithatë, tashmë është kryer një numër i konsiderueshëm studimesh dhe shumë investigues kanë konkluduar se sondazhet me fëmijët janë të drejta, etike dhe të sigurta për t’u përdorur brenda komuniteteve të tyre. Kjo është një fushë në të cilën investiguesit duhet të procedojnë me kujdes dhe shumë shqetësim për mirëqenien e fëmijëve” (ISPCAN, 2006b, fq. 2).

A.3. Pse Janë të Rëndësishme këto Dokumente dhe pse Janë të Rëndësishme Dokumentet e Përbashkëta?

Sipas ISPCAN (2006a, fq.2) “dhuna në familje po bëhet gjithnjë e më e njohur në mbarë botën si një problem social që sjell pasoja serioze shëndetësore dhe ekonomike. [...] të dhëna nga vendet që kanë histori të gjatë në studimin e problemit tregojnë se ajo është epidemike”. Megjithatë, të dhënat ekzistuese nga vende të ndryshme “shpesh nuk janë mjaftueshmërisht bindëse për të garantuar njohjen e një problemi që fshihet me turp brenda familjeve dhe komuniteteve”. Në disa vende është e nevojshme të rritet ndërgjegjësimi për ekzistencën e këtij problemi, ndërsa në disa të tjera, është e nevojshme të kuptohet më mirë rreziku dhe faktorët mbrojtës përmes krahasimit ndërvendor (ISPCAN, 2006a), ose të vlerësohen përpjekjet që janë bërë për parandalimin e këtij fenomeni. Ka vende me histori të gjatë në studimin e këtij problemi, por ka në të vërtetë edhe vende me të dhëna të kufizuara ose dhe inekzistente epidemiologjike (si vendet e Ballkanit) të cilat mund të kenë probleme

¹ ISPCAN ka hartuar edhe një dokument tjetër [ICAST-R (Retrospektiv)] për të pyetur të rinj të emancipuar rreth përvojave të tyre të dhunës në familje. Kjo qasje mund të përdoret aty ku pasojat ligjore janë komplekse nëse një i rritur pranon sjelljen abuzive ndaj fëmijës, ose një i rritur nuk i kupton rreziqet potenciale dhe jep miratimin për të raportuar për sjelljen prindërore. Ky dokument mund të kombinohet me masa të tjera punësimi ose edukimi dhe mund të jetë pjesë e një sondazhi të shumanshëm të të rinjve. Të dhënat për përhapjen e sjelljeve abuzive mund të vlerësohen lehtë, por koha kur ato reflektohen më shumë janë vitet e adoleshencës dhe fëmijërisë së vonë. Kjo qasje mund të jetë më pak e efektshme për vlerësimin e dhunës ndaj të rinjve ose dhunës që ka pasoja të thella në funksionimin e mëvonshëm intelektual të një fëmije (ISPCAN, 2006b).

më serioze nga ato që paraqesin të dhënat e vendeve të tjera” (ISPCAN, 2006a, fq. 2). Është evidente që “të dhënat nevojiten për të

orientuar zhvillimin e arsimit, politikës dhe shërbimeve sociale” të cilat do të “ndihmojnë në dokumentimin e problemit dhe informimin e vendimmarrësve dhe edukatorëve” (ISPCAN, 2006a, fq.2). Së fundi, “krahasimet ndërvendore mund të ndihmojnë në të kuptuarit e modeleve që përdorin kultura të ndryshme për të formësuar disiplinën ndaj fëmijëve. Të dhënat e mbledhura në mënyra të ngjashme nëpër komunitete e kultura të ndryshme do të ndihmojnë në dokumentimin e problemit dhe informimin e autoriteteve lokale për të planifikuar ndërhyrjen e tyre për trajtimin dhe zgjidhjen e problemeve” (ISPCAN, 2006b, fq. 2).

“Njohuritë dhe këndvështrimi i fëmijëve shpesh nuk janë marrë në konsideratë nga studiuesit e dhunës në familje. Statusi i zhvillimit ose kufizime të tjera mund të kushtëzojnë aftësinë e disa fëmijëve për të treguar atë që kanë provuar realisht. Megjithatë, aty ku fëmijët mund të pyeten, këndvështrimi i tyre mund të ndihmojë mjaft në të kuptuarit e problemit në tërësinë e tij. Qasja e të drejtave të fëmijëve mbështet përpjekjet për të kuptuar atë që fëmijët kanë provuar, porë nga këndvështrimi i tyre” (ISPCAN, 2006a, fq.2).

Megjithatë, “pa dokumente të standardizuara”, është e vështirë të krahasosh ose të bësh dallimin midis raporteve për fëmijët mes studimesh e kulturash të ndryshme”. Hartimi i dokumenteve që “mund të përdoren në kultura të ndryshme dhe që lehtësojnë punën kërkimore duke pyetur vetë fëmijët në mënyrë etike dhe të sigurt mbi keqtrajtimin, do të përmirësojë bazën shkencore të ekzistencës së dhunës ndaj fëmijëve” (ISPCAN, 2006a, fq.2).

A.4. Kush Mund t’i Përdorë Dokumentet ICAST?

ISPCAN “i harton këto dokumente si një shërbim ndaj komuniteteve shkencore dhe atyre të mbrojtjes së fëmijëve. Investigues të veçantë ose grupe investiguesish në OJQ lokale, Universitete, ose edhe Agjenci Qeveritare mund t’i përdorin dokumentet e ISPCAN si pjesë të punës së tyre. Synimi është përdorimi i një matësi të përbashkët ndërstudimor, ndërkomunitar e ndërkulturor (ISPCAN, 2006b, fq. 2).

A.5. Si Përkufizohet Dhuna ose Abuzimi në Dokumente?

“Njerëzit në vende të ndryshme kanë opinion të ndryshme mbi atë çka përbën dhunë ose sjellje abuzive”. Për këtë arsye, në sondazhin dhe në pyetësorët e ISPCAN, “pjesëmarrësit nuk do të pyeten për terma si *dhuna* ose *abuzimi* në përgjithësi, por për forma shumë specifike të sjelljes”. Në këtë mënyrë bëhet e mundur që interpretimi i rezultatit të bëhet “në kontekstin e normave të komunitetit lokal për një sjellje të pranueshme si dhe përdorimi i përkufizimeve më të standardizuara për krahasimin ndërvendor të të dhënave” (ISPCAN, 2006a, fq.3; ISPCAN, 2006b, fq.2).

KREU B. STUDIMI EPIDEMIOLOGJIK BALLKANIK MBI ABUZIMIN DHE NEGLIZHIMIN E FËMIJËVE (BECAN)

BECAN është një studim epidemiologjik që synon të pasqyrojë shtrirjen e lokalizimin e abuzimit dhe neglizhimit së fëmijëve (CAN) në fëmijët e moshave 11, 13 dhe 16 vjeçare që frekuentojnë shkollën dhe atyre që kanë lënë shkollën, dhe të analizojë lidhjen midis CAN (abuzimit dhe neglizhimit së fëmijëve) dhe karakteristikave socio-demografike, përmes një kampioni të përzgjedhur në 9 vende Ballkanike (Shqipëri, Bosnje & Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, F.Y.R.O.M, Greqi, Rumani, Serbi and Turqi). Me synim kryesor mbledhjen e të dhënave nga dy burime, për studimin epidemiologjik BECAN u përzgjedhën dy nga Pyetësorët ICAST (ICAST-CH (për fëmijë) dhe ICAST-P (për prindër)) –të përshtatur për qëllimet e këtij projekti. Të dhënat do të dalin nga krahasimi i pyetësorëve të prindërve me ato të fëmijëve. Rezultati i pritshëm i studimit është sigurimi i të dhënave të krahasueshme mbi CAN mes të gjitha vendeve pjesëmarrëse, duke mundësuar kështu ndërmarrjen e hapave të përbashkët në politikëbërje e në punën e ardhshme kërkimore, si dhe duke ndihmuar në të kuptuarit më të qartë të tipareve të CAN. Të dhënat që do të sigurohen pritet të jenë të krahasueshme dhe të përputhshme falë përdorimit të dokumenteve të përbashkëta, si dhe një metodologjie dhe procesi të përbashkët për mbledhjen e të dhënave në të gjitha vendet pjesëmarrëse.

B.1. Metodologjia e Studimit Epidemiologjik

Studimi epidemiologjik mbi bazë popullore është planifikuar të ndjekë një strategji metodologjike të dyfishtë: së pari, studimi do të kryhet me një kampion të rastësishëm nxënësish 11, 13 dhe 16-vjeçarë dhe prindërit e tyre, në 9 vende Ballkanike, me qëllim që të japë informacion mbi përmasat e problemit të CAN (abuzimit dhe neglizhimit të fëmijëve) ndër fëmijët që frekuentojnë shkollën; së dyti, do të kryhet një studim pilot në vendet Ballkanike, për të pasqyruar nivelin e CAN ndër fëmijët e moshave 11, 13 and 16-vjeçare që kanë lënë shkollën në këto vende, ku numri i kësaj kategorie fëmijësh është në nivele të larta.

Metoda e propozuar nga ISPCAN për mbledhjen e të dhënave nga fëmijët është plotësimi i pyetësorit ICAST-CH dhe intervista të strukturuar bazuar në pyetësorin ICAST-P për mbledhjen e të dhënave nga prindërit/kujdestarët.

Metodat e propozuara nga ISPCAN janë përshtatur për qëllimet e sondazhit të BECAN si më poshtë:

- kampionet e fëmijëve dhe të prindërve/kujdestarëve janë kombinuar
- të dhënat nga fëmijët që **frekuentojnë shkollën** dhe prindërve të tyre do të mblidhen nëpërmjet pyetësorëve ICAST-CH dhe ICAST-P **të plotësuar nga vetë fëmijët ose prindërit**² dhe të përshtatur për sondazhin e BECAN; ndërsa të dhënat nga fëmijët që **kanë braktisur** shkollën dhe prindërve të tyre do të mblidhen duke përdorur të njëjtat dokumente por nëpërmjet **intervistave të strukturuar**.

² Përveç prindërve që mund të kërkojnë ndihmë për plotësimin e pyetësorit (kjo klauzolë u krijua me qëllim që të mundësohej pjesëmarrja në sondazh e prindërve analfabetë).

Në të dy kampionet, çdo fëmijë do të kombinohet me prindin/kujdestarin e tij/saj duke përdorur një kod unik kombinimi; konkretisht, me qëllim që çdo fëmijë të kombinohet me prindin e tij pa rrezikuar konfidencialitetin, do të vendoset një Numër unik Subjekti në çdo çift pyetësorësh fëmijë-prind para mbledhjes së të dhënave (për më tepër informacion shih gjithashtu Kreun C. 6).

B.2. Përzgjedhja e Kampioneve

Është përdorur metoda e **përzgjedhjes së kampioneve me grupe të shtresëzuara e me shumë faza** me qëllim që të përzgjidhet kampioni më përfaqësues i fëmijëve që frekuentojnë shkollën, nga tri grup-mosha, nga zona urbane dhe rurale dhe nga të paktën tri zona të ndryshme gjeografike në çdo vend pjesëmarrës. Numri minimal i kampionit të përzgjedhur rastësisht në të gjitha vendet pjesëmarrëse u llogarit të ishte **41.169 nxënës** dhe një numër i njëjtë prindërisht/kujdestarësh të tyre, që përfaqësojnë të paktën 2% të të gjithë numrit të fëmijëve që frekuentojnë shkollën nga të tria grup-moshat, në çdo vend pjesëmarrës³.

Përsa i përket fëmijëve që **kanë lënë** shkollën, është parashikuar **një kampion i volitshëm** fëmijësh bashkë me prindërit e tyre (për shkak të pengesave serioze për identifikimin e këtyre fëmijëve dhe/ose familjeve të tyre).

Kampioni i fëmijëve që u përzgjedhën për Shqipërinë ishte 3005. Kampioni i fëmijëve që kanë braktisur shkollën për Shqipërinë ishte 150. Kampioni i fëmijëve që ndjekin shkollën është shtresëzuar sipas moshës (11-, 13- dhe 16 vjeç). Kampioni është përzgjedhur në nivel kombëtar dhe përfshin Shqipërinë e Veriut, të Mesme dhe të Jugut. Më konkretisht, të dhëna do të mblidhen nga fëmijët në këto zona: Kukës, Dibër, Lezhë, Shkodër, Berat, Fier, Vlorë, Korçë, Lushnjë, Tiranë, Durrës dhe Elbasan. Kampioni përfshin fëmijë nga zona urbane dhe rurale.

B.3. Faza Përgatitore e Studimit Epidemiologjik

Faza përgatitore e organizimit të studimit epidemiologjik në të gjitha vendet përfshin hapat e mëposhtëm:

1. Marrja e lejes nga ISPCAN për përkthimin dhe përdorimin e pyetësorëve dhe manualeve ICAST për sondazhin në 9 vende ballkanike
2. Përshtatja, vlefshmëria nga pikëpamja kulturore e dokumenteve dhe përkthimi i tyre në 10 gjuhë (shqipe, boshnjake, bullgare, kroate, greke, hungareze, maqedonase, rumune, serbe, turke) duke shtuar edhe variantin në gjuhën Angleze.
3. Marrja e lejes zyrtare nga autoritetet kombëtare për të hyrë në shkolla.
 - Shqipëria: Ministria e Arsimit dhe e Shkencave
 - Bosnja & Hercegovina:
 - Bullgaria:
 - Kroacia:
 - F.Y.R.O.M

³ 2% u llogarit si madhësia e kampionit për secilin vend, përveç Rumanisë (1%). Për shumicën e vendeve përqindja fillestare 1% që u përcaktua në Marrëveshjen e Grantit u konsiderua e pamjaftueshme për shtresëzimin e kampionit në të gjitha nivelet në vendet e vogla. Duhet theksuar gjithashtu se kampioni i Turqisë është rajonal e jo kombëtar për shkak të numrit të madh të nxënësve.

- **Greqi: Ministria Greke e Arsimit**, seksioni i Çështjeve Fetare dhe të Mësuarit Gjatë Gjithë Jetës
 - Rumania:
 - Serbia:
 - Turqia:
4. Vlefshmëria në aspektin kulturor e dokumenteve në të gjitha vendet bazuar në intervistimin e kampioneve me prindër dhe fëmijë (të moshës 11, 13 dhe 16-vjeçare që frekuentojnë shkollën, si dhe me fëmijë që kanë lënë shkollën, aty ku është e mundur dhe e nevojshme) e, për pasojë, ndryshimi dhe përshtatja e mëtejshme e dokumenteve bazuar në rezultatin e intervistave të kryera
 5. Hartimi i Manualit të Trajnimit dhe implementimi i Seminarit “Trajno Trajnuesit”
 6. Përkthimi i Manualit nga Anglishtja në 10 gjuhë zyrtare (shqipe, boshnjake, bullgare, kroate, greke, hungareze, maqedonase, rumune, serbe, turke) dhe plotësimi i Manualit me informacion specifik nga secili vend.
 7. Mbledhja dhe trajnimi i ekipeve të studiuesve në terren në vendet pjesëmarrëse me qëllim që sondazhet të jenë uniforme.
 8. Përshtatja kulturore e dokumenteve nëpërmjet studimit pilot dhe ndryshimi i tyre (aty ku është e nevojshme)
 9. Finalizimi i pyetësorëve të përshtatur ICAST që do të përdoren në sondazhet BECAN.

B.3.1. Leja Për Përdorimin e Dokumenteve

Para fillimit të studimit të gjitha vendet pjesëmarrëse ku do të zhvillohet sondazhi kanë marrë leje nga ISPCAN për të përkthyer dhe përdorur dokumentet (ICAST-CH & -P) e për t'i administruar ato në përputhje me specifikat kulturore të secilit vend.

B.3.2. Përshtatja dhe Përkthimi i Dokumenteve

Në vijim përshkruhen hapat që duhen ndjekur me qëllim që të hartohet versioni përfundimtar i dokumenteve të përshtatura ICAST që do të përdoren për sondazhin e BECAN.

Përshtatja e dokumenteve: Pyetësorët ICAST-CH dhe ICAST-P janë përshtatur për qëllimet e studimit BECAN. Arsyeja kryesore që e bëri të nevojshme këtë përshtatje ishte konceptimi në çifte të kombinuara i këtij studimi epidemiologjik; më konkretisht, edhe pse të dy pyetësorët ICAST-P dhe ICAST-CH synojnë të masin të njëjtat tema, ato mund të ndryshojnë në mënyrën se si i shprehin zërat që përfshihen në to dhe në njësinë matëse të përdorur. Të gjitha vendeve pjesëmarrëse u është kërkuar të kontribuojnë me ndryshime të nevojshme të dokumenteve si p.sh.:

- ▶ Të shtojnë ose të ndryshojnë pyetje të cilat fillimisht përfshiheshin vetëm tek një nga pyetësorët (p.sh. shtoni tek pyetësori ICAST-CH pyetje që më parë përfshiheshin vetëm tek pyetësori ICAST-P) me qëllim që të dy dokumentet të bëhen plotësisht të krahasueshëm.
- ▶ Modifikime dhe/ose shtesa në lidhje me njësinë matëse të përdorur (për të njëjtën arsye si më lart)
- ▶ Tek pyetësori i prindërve mund të shtohet informacion demografik

- ▶ Ndryshim i formatit të pyetësorëve me qëllim që të jenë sa më të kuptueshëm për ata që do t'i përdorin dhe të mund të plotësohen lehtë.

Gjatë përshtatjes së dokumenteve u bënë të gjitha përpjekjet për të ruajtur numërtimin fillestar të pyetjeve të dokumenteve ICAST. Për pyetjet shitesë u vendos një numërtim i veçantë, sipas udhëzimeve të ISPCAN. Kjo lejon krahasimin e të dhënave nga vende të ndryshme edhe kur studiuesi që i përdor këto të dhëna nuk e di gjuhën e dokumenteve që kanë përdorur pjesëmarrësit.

Së fundi, të dy pyetësorët përmbajnë një kod kombinimi (Numri i Subjektit), me qëllim që të bëhet e mundur kombinimi i pyetësorit të fëmijës me pyetësorin e prindit/kujdestarit. Kodi i kombinimit përbëhet nga inicialet e vendit, të zonës dhe një numër unik për çdo çift pyetësorësh.

Përkthimi: Sipas ISPCAN, dokumente ndërkombëtare si p.sh. dokumentet ICAST, janë menduar të përdoren në shumë gjuhë dhe të bëjnë të njëjtat pyetje në kultura të ndryshme. “disa gjuhë kanë terma të ngjashme me ato të një vendi tjetër por kanë ngjyrimë të ndryshme, disa gjuhë nuk kanë ekzaktësisht terma ekuivalente”. Megjithatë, janë bërë të gjitha përpjekjet që kuptimi i një termi në një gjuhë të caktuar të mund të shprehet me një term a shprehje të përshtatshme në një gjuhë tjetër. “Aty ku ka mundësi përzgjedhjeje mes termash, duhet zgjedhur termi që përcjell kuptimin më të saktë” (ISPCAN, 2006a, fq. 4). ISPCAN sugjeron që përkthimi të shoqërohet nga një ripërkthim i pavarur në Anglisht nga një person i ndryshëm nga ai që ka bërë përkthimin nga Anglishtja. Çdo vend pjesëmarrës duhet të përkthejë të dy pyetësorët në gjuhën e tij zyrtare me qëllim që të përdoren në hapat pasardhës të projektit.

Përshtatja Kulturore: gjatë përshtatjes së dokumenteve të gjithë Koordinatorët Shkencorë kombëtarë duhet të nxiten të ndryshojnë disa nga pyetjet e pyetësorëve sipas kontekstit të tyre lokal. Për shembull, pyetja 24 e pyetësorit ICAST-CH: “a është munduar njeri t’ju kërcënojë [...] duke thirrur shpirtrat e këqij kundër jush” do të ishte e nevojshme të ndryshohej në varësi të kontekstit kulturor të secilit vend.

B.3.3. Pilotimi i Dokumenteve

Të dy dokumentet kaluan një testim pilot para sondazhit duke përdorur një strategji të dyfishtë: a) **grupe fokusi**, b) **studime pilot**. Objektivi i testimit pilot të të dy dokumenteve është të testojë një numër tiparësh të dallueshme dhe të ndryshme për nga natyra e tyre, konkretisht, saktësinë e përkthimit të pyetësorëve, nevojën e studiuesve në terren për t’u mësuar me situatat e ndërlikuara gjatë shpërndarjes së pyetësorëve në klasa, si dhe gatishmërinë për të menaxhuar të dhënat e mbledhura dhe përputhshmërinë e procedurave dhe rezultateve mes vendeve ku u krye sondazhi.

Grupet e fokusit: Qëllimi i grupeve të fokusit ishte të kryhej një testim paraprak në terren i pyetësorëve të përkthyer ICAST-CH dhe ICAST-P mbi grupet e piketuara për sondazhin me qëllim që : a) të identifikohen pyetje të tjera të rëndësishme që duhet të shtohen në pyetësorë dhe b) të identifikohen problemet që kanë të anketuarit në lidhje me:

- ▶ Të kuptuarit e pyetjeve, qartësinë e tyre
- ▶ Përshtatshmërinë kulturore të pyetjeve (pyetje që mund të shtohen, hiqen dhe/ose përshtaten, nëse është e nevojshme)

- ▶ Opsionet e përgjigjeve: A i kuptojnë ata opsionet e përgjigjeve? *Është e vështirë për të anketuarit t'i plotësojnë ato? A përdorin të anketuarit opsione të ndryshme përgjigjesh nga ato që ofrohen në pyetje?*
- ▶ Mospërfshirjen gabimisht në pyetësor të ndonjë udhëzimi apo/ose pyetjeje, gjë që mund të rezultojë në mungesë të dhënash
- ▶ Identifikimin e ndonjë pike të paqartë që duhet qartësuar, ose ndonjë pyetjeje që mund të ketë nevojë për përgjigje (me qëllim që të jepen përgjigje standarde e të formuluar paraprakisht për të gjitha pyetjet e pyetësorit)
- ▶ Formatin e pyetësorit, dhe
- ▶ Interesin dhe vëmendjen e të anketuarve ndaj pyetësorit.

Përveç kësaj, grupet pilot ishin gjithashtu një mundësi për të përcaktuar kohën që nevojitet për të plotësuar pyetësorët si dhe për të testuar kodimin e pyetësorëve të plotësuar dhe modelit SPSS të përdorur për kodimin e të dhënave.

Në secilin vend pjesëmarrës u organizua të paktën një grup pilot **me nxënës** të moshave të përcaktuara për sondazhin (në vende të tjera u organizuan disa grupe pilot për disa nga grupmoshat e përcaktuara, duke rezultuar në **34 grupe pilot me ## pjesëmarrës, në total**) dhe të paktën një grup pilot **me prindër** në secilin vend pjesëmarrës (disa vende organizuan më shumë se një grup pilot me prindër duke rezultuar në **13 grupe pilot me ## pjesëmarrës në total**). Pjesëmarrësit e grupeve pilot ishin të ngjashëm me ata që u zgjedhën për sondazhin, konkretisht, nxënës 11, 13 dhe 16-vjeçarë që frekuentojnë shkollën, si dhe prindër që kanë të paktën një fëmijë në moshën e përcaktuar për sondazh. Ishte parashikuar të organizohej një grup pilot me fëmijë që kanë lënë shkollën në secilin nga vendet ku do të kryhej sondazhi, duke përzgjedhur një kampion të tillë fëmijësh dhe prindërish; grupe pilot me fëmijë që kanë lënë shkollën u organizuan në Kroaci, Bullgari, Serbi. Në Shqipëri u kryen 3 grupe fokusi me fëmijë: një me 11 vjeçarë (13 pjesëmarrës – 5 meshkuj dhe 8 femra), një me 13 vjeçarë (12 pjesëmarrës -2 meshkuj dhe 10 femra) dhe një me 16 vjeçarë (13 pjesëmarrës – 9 meshkuj dhe 4 femra). Gjithashtu, u zhvilluan dhe dy grupe fokusi me prindër (11 pjesëmarrës – të gjitha nëna).

Të gjitha grupet pilot në secilin vend pjesëmarrës u krijuan mbi bazën e së njëjtës metodologji dhe rezultatet e tyre u përdorën me qëllim që të kryhej rishikimi i dytë i pyetësorëve të përshtatur ICAST. Ndryshimet që iu bënë pyetësorëve, bazuar në rezultatet e grupeve pilot përfshinin:

- ▶ Përshtatjen e shkallës së përgjigjeve
- ▶ Ndryshimet në pyetje
- ▶ Shtimin e pyetjeve të tjera
- ▶ Përshtatjen e udhëzimeve të pyetësorëve

Dokumentet e ndryshuara e të përshtatura pas rezultateve të grupeve pilot përfshihen në Shtojcat 4a dhe 4b.

Studimet Pilot: në secilin vend do të kryhet edhe një studim pilot. Qëllimi i studimeve pilot është administrimi konkret i pyetësorëve të përshtatur në kushtet e klasës nga studiuesit në terren, duke synuar të bëjë testimin pilot të: a) pyetësorit të përshtatur ICAST-CH dhe

procedurave të administrimit të tij, b) pyetësorit të përshtatur ICAST-P gjatë procedimit në kushte reale c) procedurat e menaxhimit të të dhënave duke përfshirë përputhshmërinë e procedurave dhe të rezultateve mes vendeve të ndryshme. Dokumentet duhet të testohen në të paktën katër klasa të ndryshme (11-vjeçarë nga zona rurale/urbane dhe 16-vjeçarë nga zona rurale/urbane); pyetësorët do të plotësohen nga një pjesë e vogël e kampionit të përzgjedhur rastësisht (jo më shumë se 100-120 fëmijë dhe prindërit e tyre për secilin vend) me qëllim që të shmanget reduktimi i ndjeshëm i kampionit të mbetur (në rast se rezultatet e studimit pilot tregojnë se duhen bërë ndryshime tek pyetësorët dhe/ose në procesin e administrimit të tyre). Procesi që do të ndiqet për studimin pilot do të jetë i njëjtë me procesin që sugjerohet të ndiqet edhe për studimin epidemiologjik i cili përshkruhet në krerët e mëposhtëm.

KREU C. ORGANIZIMI I SONDAZHIT

C.1. Kualifikimi i Studiuesve Kërkimorë

Studiuesit kërkimorë janë çelësi i një studimi të suksesshëm. “Ata janë zemra dhe shpirti” i një studimi veçanërisht nëse ai ka të bëjë me çështje të tilla të ndjeshme si abuzimi dhe neglizhimi i fëmijëve, ose çështje që konsiderohen si “çështje familjare”. Fëmijët ashtu si edhe të rriturit “mund të mos ndihen mirë kur marrin pjesë në një studim ose rrëfim të përvojave të tyre personale” (ISPCAN, 2006a, fq. 4). Ata gjithashtu, mund të mos ndihen rehat të flasim me persona të seksit tjetër për çështje specifike. Studiuesit duhet të zgjidhen me kujdes dhe duhet të veprojnë në përputhje me **kualifikimet** specifike të përshkruara në Pjesën e 2-të të këtij Manuali: “Udhërrëfyesi për Studiuesit Kërkimorë” (Kreu A1). Studiuesit duhet të kenë **të paktën njohuritë bazë** a) mbi **kryerjen e punës kërkimore** dhe b) **mbi** çështje të etikës së punës kërkimore kur pjesëmarrësit janë njerëz. Ata duhet të jenë të **dy seksëve** (në çdo çift studiuesish, nëse është e mundur) dhe të jenë **të informuar qartë** para trajnimit në lidhje me natyrën e studimit dhe pritshmëritë e punës që do të kryejnë. Është e rekomandueshme që kontratat me studiuesit kërkimorë të bëhen pasi ata të kenë plotësuar me sukses detyrimet e tyre Pas Seminarit (shih më poshtë Kreun C2).

C.2. Seminari i Trajnimit të Studiuesve Kërkimorë

Trajnimi i **standardizuar i studiuesve kërkimorë** për administrimin e pyetësorëve që plotësohen nga vetë pjesëmarrësit, ose për kryerjen e intervistave të strukturuar është **shumë i rëndësishëm**. Metoda e prezantimit të sondazhit para pjesëmarrësve, mënyra e mbledhjes së të dhënave, si mund të ndihmohen pjesëmarrësit për t’iu përgjigjur pyetjeve, rëndësia e konfidencialitetit dhe e çështjeve etike si edhe çështjet kritike të sigurisë për pjesëmarrësit dhe studiuesit, duhet të jenë pjesë e trajnimit (ISPCAN, 2006b).

Kështu, një nga objektivat e projektit BECAN është trajnimi i një grupi të specializuar shkencëtarësh në të gjitha vendet Ballkanike me qëllim përcjelljen në mënyrë të saktë dhe uniforme të pyetësorëve të përshtatur ICAST-CH dhe ICAST-P. Për këtë qëllim Koordinatori i BECAN organizoi një Seminar të titulluar “Trajno Trajnuesit”, i cili u mbajt në Tiranë, 17-18 Maj 2010. Në Seminar morën pjesë të gjithë Koordinatorët Shkencorë Kombëtarë të projektit BECAN si dhe studiuesit në rolin e trajnuesve dhe/ose studiuesit e terrenit. Pjesëmarrësit e Seminarit “Trajno Trajnuesit” duhet të përdorin të njëjtën metodologji që është përshkruar në këtë Manual për të trajnuar ekipet e studiuesve në vendet e tyre.

Para së gjithash, pas mbledhjes së Ekipeve Kombëtare të studiuesve⁴ dhe para trajnimit të tyre duhet të përcaktohen **nevojat e trajnimit** të tyre në lidhje me **temën e CAN, si dhe çështje të metodologjisë dhe etikës**. Në rast se ka mangësi në njohuritë e tyre, programit të tyre të trajnimit mund t’i shtohen sesione plotësuese.

Kohëzgjatja e kështilluar e Seminarit të Trajnimit të Studiuesve Kombëtarë është **16 orë** dhe duhet të kryhet pothuajse një muaj para fillimit të studimit pilot. Megjithatë, kohëzgjatja varet

⁴Rekomandohet të trajnohen më shumë studiues kërkimorë se sa nevojiten realisht me qëllim që të menaxhohen rastet kur kërkues të veçantë mund të tërhiqen ose të pushohen.

nga nevojat e studiuësve. Tabela 1 paraqet kohëzgjatjen dhe përmbajtjen e sugjeruar të Modullit të Trajnimit të Studiuësve. **Detyrimet e studiuësve** janë:

- Pjesëmarrja gjatë gjithë seminarit
- Pjesëmarrja në sesionet shtesë (sipas nevojave të tyre)
- Plotësimi me sukses i detyrimeve pas seminarit.

Të gjithë studiuësit duhet të familjarizohen me procesin që do të ndiqet për kryerjen e sondazhit si dhe me dokumentet që do të përdoren me qëllim që të jenë në gjendje t'u përgjigjen paqartësive të pjesëmarrësve duke përdorur përgjigjet e standardizuara, të lexojnë pyetjet dhe të regjistrojnë përgjigjet lehtë, shpejt, dhe natyrshëm. Para studimit pilot rekomandohet që studiuësit të kryejnë një provë të administrimit të pyetësorëve nga pjesëmarrësit dhe intervista provë ose intervista pilot me fëmijë dhe prindër me qëllim që të familjarizohen më tepër me dokumentet (detyrimet e studiuësve pas seminarit). Studiuësit duhet gjithashtu të pajisen me përgjigjet e standadizuara ndaj paqartësive të mundshme të pjesëmarrësve (shih Shtojcën 1). Më poshtë paraqitet kohëzgjatja dhe përmbajtja e sugjeruar e trajnimit të studiuësve të terrenit dhe detyrimet e tyre pas seminarit. Të gjithë studiuësve të trajnuar duhet t'u jepet një kopje e "Udhërrëfyesit të Studiuësve Kërkimorë".

Tabela 1. Kohëzgjatja dhe Përmbajtja e Sugjeruar e Modullit të Trajnimit të Studiuësve

	TEMA	koha
1	Përshkrim i shkurtër metodologjik i sondazhit (vetëm informacion i nevojshëm për studiuësit)	30-45 min
2	Si do të organizohet dhe koordinohet sondazhi: <ul style="list-style-type: none"> ○ Me nxënës dhe prindërit e tyre ○ Me fëmijë që kanë lënë shkollën dhe prindërit e tyre 	120 min
3	Përgatitja e studiuësve për sondazhin	90 min
4	ICAST-CH (Pyetësi i Fëmijëve) <ul style="list-style-type: none"> ○ Procesi hap pas papi & udhëzime për administrimin e pyetësorëve ○ Procesi hap pas papi & udhëzime për kryerjen e intervistave të strukturuar ○ Plotësimi provë i pyetësorëve dhe kryerja e intervistave pilot ○ Kontrolli i cilësisë së plotësimit të pyetësorëve 	210 min
5	ICAST-P(Pyetësi i Prindërve) <ul style="list-style-type: none"> ○ Procesi hap pas hapi & udhëzime për intervistat e strukturuar ○ Kryerja e intervistave pilot ○ Kontrolli i cilësisë së plotësimit të pyetësorëve 	210 min
6	Çështje të Etikës dhe Sigurisë <ul style="list-style-type: none"> ○ Reagimi ndaj rasteve të zbuluara të Abuzimit dhe Neglizimit së Fëmijëve dhe rasteve të abuzimit të të rriturve(IPV) ○ Ndërhyrja në rastet kritike dhe mbikëqyrja e studiuësve ○ Siguria e pjesëmarrësve dhe çështje të tjera etike ○ Siguria e studiuësve ○ Siguria e të dhënave: ruajtja & aksesit 	150 min

7	Përshkrim i shkurtër i Udhërrëfyesit për Studiuesit – Diskutim	135 min
8	Sesione shtesë (nëse është e nevojshme) <ul style="list-style-type: none"> ○ Si të kodohen të dhënat nga pyetëtorët ICAST-P dhe ICAST-CH dhe si të kontrollohet cilësia e tyre (nëse është e mundur)⁵ ○ Sesione mbi CAN dhe/ose çështje metodologjike dhe etike (sipas nevojave të studiuesve) 	Kohë shtesë

DETYRIMET PAS-SEMINARIT

1	Administrimi i pyetësorëve ICAST-CH & ICAST-P : <ul style="list-style-type: none"> ○ Plotësimi (nga të paktën 2 fëmijë dhe 2 prindër) ○ Intervistave të strukturuar (me të paktën 2 fëmijë dhe 2 prindër)
2	<ul style="list-style-type: none"> ○ Kodimi i të dhënave të pyetësorëve nga studiuesit pas seminarit (nëse është e mundur) ○ Krahasimi i kontrollit të cilësisë së kodimit (nëse është e mundur)
3	Sesion(e) konsultimi me trajnerin/ët individualisht ose në grupe të vogla (2-3 studiues)

Trajnimi i standardizuar i ekipeve të studiuesve në të gjitha vendet synon të kontrollojë efektin e ndryshores “**studiues/intervistues**” i cili është ndër **elementët më të rëndësishëm** për krahasueshmërinë e rezultateve të studimit. **Të gjithë studiuesit në 9** vendet e studimit duhet të veprojnë **si një organizëm i vetëm** përse i përket mënyrës: :

- Si do ta prezantojnë sondazhin tek të anketuarit dhe tek publiku
- Si do t'i prezantojnë udhëzimet dhe si do t'i kryejnë intervistat
- Si do t'u përgjigjen paqartësive të pjesëmarrësve për t'i sqaruar ata
- Si do ta raportojnë procesin dhe progresin e bërë në takimet ditore
- Si do të ruajnë konfidencialitetin
- Si do të trajtojnë çështje kritike që lidhen me raste konkrete të CAN tashmë të zbuluara
- Si do të mbrojnë sigurinë e të anketuarit dhe të tyre.

Pika e fundit por jo më pak e rëndësishme, është vlerësimi i trajnimeve të Ekipeve Kombëtare të Studiuesve. Vlerësimi duhet të bëhet duke përdorur metodologjinë e Seminarit “Trajnoj Trajnuesit”, ose duke përdorur një metodologji tjetër.

C.3. Koordinimi i Studimit Kërkimor në Terren

Studimi kryesor epidemiologjik do të kryhet gjatë vitit shkollor **2010 – 2011**. Mbledhja e të dhënave në çdo vend mund të organizohet ose a) në të gjitha zonat gjeografike (mbledhja lineare e të dhënave njëra zonë pas tjetrës (shih gjithashtu fig. 1a); konkretisht, një grup studiuesish do të mbledhë të dhëna në zonën e 1-rë gjeografike dhe pasi ta ketë mbaruar atë do të vazhdojë me zonën tjetër, ose b) në zona të veçanta gjeografike (mbledhja e të dhënave njëkohësisht në disa zona (shih gjithashtu fig. 1b); konkretisht, nëngrupe të veçanta studiuesish do të mbledhin të dhëna njëkohësisht në zona të ndryshme gjeografike. Zgjedhja e mbledhjes së të dhënave njëra zonë pas tjetrës ose të gjitha njëkohësisht varet nga madhësia e popullsisë, distanca mes zonave të ndryshme gjeografike dhe numrit të studiuesve në çdo ekip.

⁵ Studiuesit duhet të trajnohen për kodimin e të dhënave vetëm nëse ata janë caktuar të bëjnë kodimin e të dhënave të sondazhit.




Figura 1a. Paraqitje e strukturës së ekipit të studuesve në rast të mbledhjes lineare të të dhënave.




Figura 1b. Paraqitje e strukturës së ekipit të studuesve në rast të mbledhjes së njëkohëshme të të dhënave.

Koordinimi i përgjithshëm i studimit në terren në secilin vend, duhet të ndërmerret nga një ose më shumë persona: **Koordinatori i Studimit në Terren dhe/ose Koordinatori/ët Lokal.**⁶ Koordinatori i Studimit në Terren do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e Koordinatorëve Lokalë. Koordinatori i Studimit në Terren dhe/ose Koordinatori/ët Lokal do të jenë përgjegjës për :

- ▶ Kontaktimin e shkollave që do të marrin pjesë në studim:
 - T'u dërgojnë një Letër Informuese drejtorëve të shkollave, shoqatave të mësuesve dhe prindërve (nëse është e mundur)
 - të dokumentojnë informacion në lidhje me
 - numrin e klasave në çdo shkollë të përzgjedhur
 - numrin e nxënësve për çdo klasë
 - numrin e nxënësve femra dhe meshkuj (për çdo klasë)
 - të organizojnë shpërndarjen e Letrave Informuese dhe Formularët e Miratimit për prindërit/kujdestarët (përmes studuesve –nga nxënësit ose shkollat)
 - të mbyllin takimin për mbledhjen e të dhënave me secilën shkollë dhe të bëjnë një telefonatë kujtese 2-3 ditë para takimit

⁶ Gjatë mbledhjes së të dhënave, një person duhet të jetë i disponueshëm në zyrat e organizatës së secilit vend pjesëmarrës me qëllim që t'u përgjigjet pjesëmarrësve në sondazh që mund t'i telefonojnë organizatës për të pyetur ose për informacion më të detajuar. Ky person duhet të jetë në dijeni të studimit kërkimor BECAN dhe mund të jetë Koordinatori i Studimit në Terren.

- të marin informacion dhe detaje kontakti në lidhje me fëmijët që kanë lënë shkollën vitin e fundit (nëse është e mundur).
- ▶ Të kontaktojnë prindërit/kujdestarët ose fëmijët që kanë lënë shkollën (me telefon dhe/ose me letër) me qëllim që t'i ftojnë ata të marrin pjesë në studim dhe të caktojnë datën, orën dhe vendin e takimeve për intervistat (një telefonatë kujtese mund të bëhet edhe para datës së takimit).
- ▶ Përgatitja e axhendës së punës kërkimore:
 - Të identifikojnë sa studiues dhe sa ditë nevojiten për çdo zonë gjeografike dhe shkollë
 - Të hartojnë një axhendë për tërë punën kërkimore (ose për çdo rajon) në mënyrën **më efektive dhe më ekonomike të mundshme** (sa i përket kohës dhe buxhetit).
 - Të organizojnë çiftet e studiuesve
 - Të përcaktojnë axhendën e çdo çifti studiuesish për mbledhjen e të dhënave.
- ▶ Menaxhimi i çështjeve praktike:
 - Të organizojnë udhëtimet e studiuesve (biletat, akomodimin, makinat me qira, etj.)
 - Të përgatisin të gjitha materialet e nevojshme për çdo zonë (p.sh. harta, pyetësorë, materiale ilustruese, numra të rëndësishëm telefoni, listë të shërbimeve lokale ndihmëse, formularët e raportimit, etj).

Çdo **Koordinator Lokal** duhet të mbikëqyrë dhe koordinojë ekipin e tij të studiuesve (në një rajon gjeografik) dhe ai/ajo duhet të jetë në dijeni të lëvizjeve të çdo çifti studiuesish (për arsye sigurie); ai/ajo duhet të jetë "**pika e referimit**" e studiuesve dhe i disponueshëm në çdo kohë me qëllim që të gjendet një zgjidhje për çdo problem të papritur që mund të dalë e të japë ndihmesën e nevojshme për studiuesit. Koordinatori Lokal është gjithashtu përgjegjës edhe për organizimin çdo ditë pas përfundimit të mbledhjes së të dhënave të një takimi mbikëqyrës me anëtarët e ekipit të tij të studiuesve, për të marrë informacion mbi rastet e abuzimit dhe të neglizhimit të fëmijëve, për të diskutuar e marrë vendime si dhe për të folur për probleme që mund të kenë dalë gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave. Më konkretisht, studiuesit duhet të raportojnë tek Koordinatori i tyre Lokal gjatë takimeve mbikëqyrëse pas mbledhjes së të dhënave (mbi bazë të Formularëve të Raportimit) në lidhje me:

- ▶ procesit të ndjekur dhe problemet që mund të kenë dalë gjatë mbledhjes së të dhënave
- ▶ rezultatet e verifikimit të cilësisë së pyetësorëve të plotësuar
- ▶ zbulimi i ndonjë rasti të CAN ose dyshimi të mundshëm

Pas takimit të çdo dite Koordinatori Lokal duhet:

- ▶ të regjistrojnë shkallën e përgjigjeve, mbi bazën e raporteve të studiuesve
- ▶ të mbledhin të gjithë pyetësorët e plotësuar dhe të paplotësuar
- ▶ të mbledhin të gjithë Formularët e Raportimit të Studiuesve
- ▶ të regjistrojnë rezultatet e punës së çdo studiuesi.

Ciftet e studiuësve: rekomandohet rreptësisht që të 2 studiuësit (një femër dhe një mashkull, nëse është e mundur) duhet të jenë prezent në të njëjtën kohë në një klasë ose familje. Numri real i çifteve të studiuësve që do të vizitojnë çdo zonë (shkolla ose familje) varet nga numri i klasave/nxënësve dhe familjeve dhe kohëzgjatja e dëshiruar e sondazhit.

C.4. Organizimi i Sondazhit në Shkolla

Për kryerjen e sondazhit në mjedisin shkollor, në pjesën më të madhe të vendeve, është e nevojshme të **merret leje nga autoritetet** përkatëse (p.sh. Ministria e Arsimit) për të mundësuar hyrjen në shkolla.

Pas marrjes së lejes zyrtare, një **letër informuese** duhet t'u dërgohet Drejtorëve të shkollave (të cilat janë përzgjedhur të përfshihen në kampionin e sondazhit) dhe/ose Shoqatave të Mësuesve dhe Shoqatave të Prindërve/Kujdestarëve (nëse është e mundur) nga Koordinatori i Studiuësve në Terren, me qëllim që të informohen rreth sondazhit që do të kryhet në shkollat e tyre. Përveç kësaj, një telefonatë konfirmimi do të krijonte mundësinë e kontaktimit të Drejtorëve të shkollave me qëllim që:

- ▶ të merret informacion mbi numrin e klasave pjesëmarrëse në shkollat e përzgjedhura
- ▶ të merret informacion mbi numrin dhe gjininë e nxënësve të secilës klasë në shkollat e përzgjedhura
- ▶ të përcaktohen takimet dhe koha më e përshtatshme për administrimin e pyetësorëve në secilën shkollë
- ▶ të merret informacion dhe detaje kontakti për fëmijët që kanë lënë shkollën (nëse është e mundur).

Gjatë komunikimit me drejtorët e shkollave duhet të përcaktohet **data** dhe **ora** e kryerjes së sondazhit në klasat e shkollës. Megjithatë, para kësaj duhet të bëhet **shpërndarja e Letrave Informuese dhe Formularëve të Miratimit** për prindërit në lidhje me pjesëmarrjen e fëmijëve të tyre në sondazh, të cilat këshillohet t'u shpërndahen prindërve 1-3 ditë para mbledhjes së të dhënave nga studentët. Shpërndarja e letrave dhe formularëve mund të bëhet në dy mënyra:

1. duke vizituar nxënësit në shkollë me qëllim që t'u shpërndajnë atyre letrat informuese dhe formularët e miratimit për prindërit e tyre,
2. të organizojnë shpërndarjen e materialeve për prindërit nëpërmjet shkollës (p.sh. t'ua dorëzojnë ato nxënësve ose t'i dërgojnë me postë).

Edhe pse mënyra e dytë duket më e volitshme, në këtë rast duhet të bëhet marrëveshje me secilën shkollë në lidhje me riprodhimin e materialit (të dërgohet me postë ose të fotokopjohet në shkollë). Në rast se zgjidhet mënyra e dytë, duhet të bëhet një telefonatë në shkollë disa ditë para takimit për mbledhjen e të dhënave nga nxënësit, me qëllim që a) të kujtohet Drejtori i shkollës për takimin, dhe b) të kujtohet shkolla për shpërndarjen e letrave dhe të formularëve të miratimit. Duhet bërë një telefonatë e dytë me qëllim që të merret informacion mbi ndonjë refuzim të mundshëm nga prindërit, numrin e refuzimeve si dhe përcaktimi së bashku i detyrave për nxënësit që nuk do të marrin pëlqimin e prindit/kujdestarit.

Figura 2 më poshtë paraqet hapat e organizimit të sondazhit në shkolla dhe **Figura 3** tregon procesin që rekomandohet të ndiqet për shpërndarjen e letrave informuese tek prindërit (për pjesëmarrjen e nxënësve në sondazh) si dhe shpërndarjen dhe mbledhjen e formularëve të miratimit (për pjesëmarrjen e fëmijës në sondazh).




Figura 2. Hapat e organizimit të sondazhit në shkolla.




Figura 3. Procesi i shpërndarjes së letrave tek prindërit & dhënia e miratimit në heshtje për pjesëmarrjen e fëmijëve në sondazh.

Figura 4 paraqet një shembull të programit të mbledhjes së të dhënave nga studiuesit kërkimorë në një Prefekturë (Hania) të Zonës Gjeografike të Kretës (Greqi).

Në klasë duhet të jenë të pranishëm të paktën dy studiues. Nëse ndonjë nga shkollat e kampionit të përzgjedhur ka më shumë se një klasë pjesëmarrëse në sondazh, aty duhet të jenë të pranishëm sa më shumë studiues të jetë e mundur me qëllim që të dhënat të mblidhen njëkohësisht në të gjitha klasat e sa më shpejt (në mënyrë që fëmijët të mos kenë kohë të diskutojnë pyetjet me njëri-tjetrin).




Figure 4. Shembull i planveprimit të mbledhjes së të dhënave në shkolla nga 8 studiuës në Prefekturën e Hanjasë (Kretë).

Pyetësorët e prindërve mund të mbliidhen në dy mënyra:

- ▶ ose nga nxënësit (siç përshkruhet në Fig. 2): në këtë rast studiuësit duhet të vizitojnë përsëri shkollën ditën tjetër dhe të mbledhin nga studentët zarfet me pyetësorët e prindërve
- ▶ ose nga familjet, nëse prindërit do t'u telefonojnë studiuësve për të mbledhur pyetësorët e tyre

Në fund të çdo dite të mbledhjes së të dhënave të gjithë studiuësit do të takohen me Koordinatorin e tyre Lokal për **Takimin Mbikëqyrës** të ditës.

C.5. Organizimi i Sondazhit me Fëmijët që Kanë Lënë Shkollën

Që të kryhet sondazhi me fëmijët që kanë lënë shkollën dhe prindërit e tyre, gjëja e parë që nevojitet është të **merren të dhëna kontakti** me ta (nga shkollat që ata frekuentonin më parë ose në nga burime të tjera). Informacioni i nevojshëm është: emrat e fëmijëve dhe numri i telefonit dhe/ose adresa.

Pas marrjes së këtyre të dhënave, duhet të kontaktohet prindi/kujdestari me qëllim që të ftohet të marrë pjesë në sondazh së bashku me fëmijën; konkretisht, Koordinatorin në Terren i Studimit dhe/ose Koordinatorin Lokal do të telefonojnë familjet (ose t'u dërgojnë me postë letrat informuese⁷) me qëllim që:

- ▶ të përcaktojnë datën dhe orën e takimit për intervistat (si edhe vendin në rast se prindi nuk dëshiron të intervistohet në shtëpi)
- ▶ të regjistrojnë ndonjë mospranim të mundshëm për të marrë pjesë në sondazh⁸
- ▶ të përcaktojnë për çdo familje një çift studiuesish për mbledhjen e të dhënave.

Figura 5 pasqyron hapat që duhen ndjekur për organizimin e sondazhit.




Figura 5. Hapat e organizimit të sondazhit për fëmijët që kanë lënë shkollën.

C.6. Përgatitja e Materialeve të Studiuesve

Çdo çift studiuesish, para se të shkojë në terren për mbledhjen e të dhënave, duhet të pajiset me materialet e nevojshme për ditën e punës (shih gjithashtu Kreun A3 në “Udhërrëfyesi për Studiuesit Kërkimorë”); Koordinatorët Lokalë duhet t’i kenë përgatitur materialet e nevojshme për çdo ditë të mbledhjes së të dhënave dhe t’ua japin ato çifteve të studiuesve kërkimorë një ditë para mbledhjes së të dhënave. Përgatitja e materialeve përfshin:

Mbledhjen e të dhënave në mjedisin shkollor (pyetësorët që plotësohen nga pjesëmarrësit)

- ▶ Printimi ose fotokopjimi sa herë të jetë e nevojshme e:
 - pyetësorëve të fëmijëve **ICAST-CH** së bashku me **formularin e miratimit** të fëmijës që do t’i bashkëngjitet pyetësorit në faqen e parë
 - pyetësorëve të prindërve **ICAST-P**
 - **Letrave informuese** dhe **Formularëve të Miratimit** për pjesëmarrjen e fëmijës dhe të prindit në sondazh
 - **Letrave Falënderuese** për prindërit dhe fëmijët
- ▶ Vendosja e **kodeve të njëjta të kombinimit** (Numra Subjekti) në secilin çift pyetësorësh fëmijë-prind (shih Tabelën 1)

⁷ Letrat informuese dhe miratimi për pjesëmarrje duhet të përshtaten për t'u dërguar në një adresë të re (që do të përdoret për t'u dërguar letrat informuese dhe miratimi për pjesëmarrje) nëse prindërit e fëmijëve kanë ndryshuar adresën e tyre (shih Tabelën 1).

⁸ Kjo është shumë e rëndësishme se do të ndihmojë në llogaritjen e numrit të familjeve të plotësuara.

► **Përgatitja e zarfeve për prindërit** të cilat duhet të përfshijnë:

- letrën informuese për prindin,
- formularin e miratimit për pjesëmarrjen e prindit në sondazh,
- pyetëtorin për prindin ICAST-P dhe
- letrën falënderuese për prindin

si dhe kombinimin e çdo zarfi të vulosur me pyetëtorin e fëmijës ICAST-CH që do të mbajë të njëjtin kod kombinimi (këshillohet që kodi i kombinimit të shkruhet mbi zarf; në këtë mënyrë ju do të keni mundësi t'i rikombinoni kodet nëse ngatërrohen gabimisht).

► **Regjistrimi në një listë** (shih shembullin në Tabelën 2) i kodeve që i korrespondojnë çdo shkolle, klase dhe çdo çifti studiuesish, së bashku me datën dhe orën e takimit.

Codes	School (Name)	Class room	N	Boys	Girls	Researchers	Date	Time	
GR/ATH	1-22	School 1	A1	22		Pair A	Monday, 25.10	8:00	
GR/ATH	23-41	School 1	A2	19	10	9	Pair B	Monday, 25.10	8:00
GR/ATH	42-61	School 2	A	20	12	8	Pair C	Monday, 25.10	8:00
...	
GR/HER	1-18	School 52	A	18			Pair D	Monday, 25.10	8:00
	19-24	School 53	A	6			Pair E	Monday, 25.10	8:00
	25-44	School 54	A1	20			Pair F	Monday, 25.10	8:00

Tabela 2. Shembull i regjistrimit të kodit

► **Koordinatori Lokal duhet të pajisë çdo çift studiuesish (dhe studiuesit duhet të kontrollojnë që të jenë të pajisur me këto materiale) si më poshtë:**

- axhendën e tyre në lidhje me shkollat që do të vizitojnë, datën dhe orën e takimeve, dhe detaje për kampionin që do të anketohet (cili vit, cila klasë, etj.)
- një **hartë** të zonës që ata do të vizitojnë
- kopjet e nevojshme të **pyetësorëve** për fëmijët dhe zarfet për prindërit e tyre
- “Materiali ilustrues” me shkallën e përgjigjeve (shih Tabelën 3) dhe një model me zarfin e prindit) me qëllim që t’u shpjegojnë nxënësve: a) si duhet t’i plotësojnë tabelat në pyetësorët e tyre dhe b) çfarë përmbajnë zarfet e prindërve dhe si duhet t’i përdorin ata këto materiale
- Aparat incizimi
- dy stilolapsa për secilin studiues
- dy zarfe të mëdhenj për çdo çift studiuesish për të mbledhur pyetësorët e nxënësve në klasë
- kopje të **letrave falënderuese** për fëmijët
- një **skedë me shërbimet lokale** (burime ndihme) të disponueshme në atë zonë në rast se do të nevojitej ndihma e tyre për të anketuarit.
- **distinktiv sondazhi** individual për çdo studiues
- nëse gjykohet e nevojshme, çdo çift studiuesish mund të pajiset me një **letër zyrtare** që tregon qëllimin e studimit, Institucionin përgjegjës për të, si edhe të dhëna kontakti me supervisorët.
- **telefon celular** (i aktivizuar por në opsionin pa zile)
- një **listë me telefona të nevojshëm** (p.sh. numrat e telefonit të Koordinatorit Lokal, të pjesëtarëve të tjerë të grupit të studiuesve, etj.)




Tabela 33. Materiali ilustrues i shkallës së përgjigjeve

- **Formularët e Raportimit** (shih Shtojcën 2a).
- Lista e plotë e materialeve të nevojshme.

Mbledhjen e të dhënave në mjedisin familjar (intervistat e strukturuar)

- ▶ Printimi ose fotokopjimi sa herë të jetë e nevojshme i:
 - **Pyetësorëve ICAST-CH (formulari i aprovimit të fëmijës do t'i bashkëngjitet pyetësorit si faqja e 1^{re} e tij)**
 - **Pyetësorëve të prindërve ICAST-P**
 - **Letrave informuese dhe falënderuese për prindërit**
 - **Formularëve të Miratimit për pjesëmarrjen e fëmijëve dhe prindërve në sondazh.**
 - **Letër Falënderuese për fëmijët**

- ▶ vendosja e kodeve të njëjta të kombinimit për çdo çift pyetësorësh prind-fëmijë.

Codes	Household (Name)	Address Phone	Child's Age	Researchers	Date	Time
GR/ATH 1	Family 1	XXX	16	Pair A	Monday, 25.10	8:00
GR/ATH 2	Family 1	XXX	16	Pair B	Monday, 25.10	8:00
GR/ATH 3	Family 2	XXX	16	Pair C	Monday, 25.10	8:00
...
42	Family 52	XXX	16	Pair D	Monday, 25.10	8:00
GR/HER 43	Family 53	XXX	13	Pair E	Monday, 25.10	8:00
44	Family 54	XXX	12	Pair F	Monday, 25.10	8:00

- ▶ Regjistrimi i kodit që i korrespondon çdo familjeje dhe çdo çifti studiuesish së bashku me datën dhe orën e takimit (shih Tabelën 4)

Tabela 4. Shembull i regjistrimit të kodit për interv.

- ▶ Printimi/fotokopjimi dhe ndarja e dy grupeve të Skedave të Intervistës (shih Shtojcat 3a dhe 3b), sipas udhëzimeve në Shtojcën 3.

- ▶ **Koordinatori duhet t'i pajisë intervistuesit (dhe intervistuesit duhet të kontrollojnë që të jenë të pajisur me këto materiale) si më poshtë:**

- axhendën tyre në lidhje me familjet që do të vizitojnë, datën dhe orën e takimeve
- një **hartë** të zonës që ata do të vizitojnë
- kopjet e nevojshme të **pyetësorëve** për fëmijët dhe prindërit e tyre
- **Skedat e Intervistës** për fëmijë dhe prindër (shih Shtojca 3a dhe 3b)
- dy stilolapsa për çdo person
- kopje të **letrave falënderuese** për fëmijët dhe prindërit e tyre
- një **listë me shërbimet lokale** (burime ndihme) të disponueshme në atë zonë në rast se do të kërkohej ndihmë e mëtejshme për ndonjë nga të anketuarit
- **distinktiv i sondazhit** individual për secilin studiues
- Nëse është e nevojshme, çdo çift studiuesish mund të pajiset me një **letër zyrtare** që tregon qëllimin e studimit, Institucionin përgjegjës për të, si dhe të dhëna kontakti me supervisorët.
- **telefon celular** (i aktivizuar por në opsionin pa zile)




Figura 3. Material demonstrativ: përgjigjet në flipchart

- **një listë me telefona të nevojshëm** (p.sh, numrat e telefonit të Koordinatorit Lokal, të pjesëtarëve të tjerë të grupit të studiuësve, etj.)
- **Formularët e Raportimit** (shih Shtojcën 2a).
- listat e plota të materialeve të nevojshme

Kryesisht për arsye sigurie, Koordinatori Lokal duhet të ketë një kopje të axhendës së të gjithë studiuësve (orën dhe vendndodhjen) me qëllim që të jetë në dijeni të vendit ku ata janë, si dhe numrat e tyre të celularëve.

C.7. Formularët e Raportimit të Studiuësve

Kur përdoren **pyetësorë çdo çift** studiuësish duhet të ketë një formular raportimi në lidhje me pyetësorët që ata duhet të administrojnë në çdo klasë (shih Shtojcën 2a). Në çdo çift njëri nga studiuësit është përgjegjës për plotësimin e formularit të raportimit në bashkëpunim me kolegun e tij dhe duhet të shënojë në Formularin e Raportimit për çdo “ditë të mbledhjes së të dhënave”:

- a) emrat e studiuësve që ishin përgjegjës për administrimin e një numri të caktuar pyetësorësh për klasë
- b) datën dhe orën e mbledhjes së të dhënave
- c) emrin dhe adresën e shkollës
- d) numrin e klasës (p.sh. A1), numrin e të gjithë nxënësve, si dhe numrin sipas gjinisë të nxënësve të pranishëm në klasë gjatë shpërndarjes së pyetësorëve (p.sh. 22 nxënës, 12 djem + 10 vajza)
- e) kodet e pyetësorëve që ata shpërndanë për çdo klasë (p.sh. **GR/ATH/1 - 22**).

Pjesa kryesore e Formularit Raportues përbëhet nga dy kolona, ajo e pyetësorit ICAST-CH dhe e pyetësorit ICAST-P. Në kolonën e parë studiuësit duhet të plotësojnë:

- f) numrin e fëmijëve që refuzojnë të plotësojnë pyetësorin, kodet e pyetësorëve të tyre dhe arsyet e refuzimit, nëse ato përmenden nga nxënësit
- g) numrin e përgjigjeve refuzuese që ata kanë marrë nga prindërit e tyre dhe numrin e përgjigjeve pozitive që nuk janë dorëzuar nga prindërit
- h) vërejtjet mbi pyetësorët e nxënësve pas **kontrollit të cilësisë** (vërejtjet mund të përfshijnë Numrin e Subjektit të Pyetësorit dhe, p.sh. pyetjet pa përgjigje –duke specifikuar numrin e pyetjeve – dhe/ose përgjigjet e pavlefshme, verifikimi i dyfishtë i disa pyetjeve, etj.)
- i) shënime për rastet e zbulimit ose dyshimit për CAN (p.sh. abuzim seksual i denoncuar; fëmija kërkoi ndihmë, ose edhe ndonjë informacion tjetër, si p.sh. detaje kontakti, etj.)

Në kolonën e pyetësorit ICAST-P studiuësit duhet të shënojnë:

- j) sa përgjigje negative kanë marrë nga prindërit në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në sondazh dhe arsyet (nëse përmenden)
- k) metoda e mbledhjes së të dhënave nga prindërit (duke shënuar Numrat e Subjektit)

- l) cilët pyetësorë mungojnë (duke shënuar Numrat e Subjektit të pyetësorëve që mungojnë) dhe ndonjë vërejtje.

Kur përdoren **intervistat e strukturuara** çdo studiuës duhet të ketë Formularin e vet të Raportimit në lidhje me pyetësorët që ai duhej të administronte (shih Shtojcën 2b). Në Formularin e Raportimit për intervistat e strukturuara studiuësi duhet të shënojë :

- a) emrin e tij/saj dhe emrin e intervistuesit që ka punuar me të
- b) datën, orën dhe kohëzgjatjen e çdo interviste
- c) cilin person intervistoi (p.sh. prindërit e ose fëmijët)
- d) Numrin e Subjektit të çdo pyetësori
- e) raste të refuzimit nga prindërit për pjesëmarrjen e tyre ose të fëmijëve të tyre në sondazh dhe arsytet (nëse përmenden)
- f) raste të refuzimit nga fëmijët për të marrë pjesë në studim dhe arsytet (nëse përmenden)
- g) vërejtje në lidhje me pyetësorin (p.sh. refuzim për t'iu përgjigjur pyetjeve të caktuara) ose vërejtje të tjera (p.sh. abuzim seksual i zbuluar; fëmija kërkoi ndihmë, ose edhe ndonjë informacion tjetër, si p.sh. detaje kontakti, etj.).

Këto formularë duhet të plotësohen çdo ditë, pas mbledhjes së të dhënave. Përveçse ndihmon në sistemimin e pyetësorëve të mbledhur, formulari u vjen në ndihmë edhe studiuësve të identifikojnë ndonjë problem të mundshëm që duhet diskutuar gjatë Takimeve Mbikëqyrëse me Koordinatorin Lokal pas çdo dite të mbledhjes së të dhënave; formularët do të mblidhen nga Koordinatori Lokal çdo ditë.

KREU D. KRYERJA E SONDAZHIT

D.1. Shpërndarja e Pyetësorëve ICAST-CH dhe ICAST-P

Pyetësorët e përshtatur e të përkthyer ICAST-CH dhe ICAST-P do të administrohen duke përdorur dy metoda, në varësi të grupit të subjekteve (nxënës dhe prindërit e tyre ose fëmijë që kanë lënë shkollën dhe prindërit e tyre; shih gjithashtu Tabelën 2).

Tabela 2. Metoda e administrimit të pyetësorëve sipas grupit të subjekteve

Grupi	Metoda	
	Nxënës	Prindër
që frekuentojnë shkollën	Pyetësor	Pyetësor (intervistë e strukturuar, vetëm nëse kërkohet)
që kanë lënë shkollën	Intervistë e Strukturuar	Intervistë e Strukturuar

D.1.1. Pyetësori që Plotësohet nga vetë Pjesëmarrësit

Ky seksion përshkruan procesin që duhet të ndiqet kur përdoret metoda e pyetësorëve që plotësohen nga vetë fëmijët dhe prindërit (shih gjithashtu Figurën 6). Dokumentet duhet të administrohen në grupet e fëmijëve njëkohësisht në të gjitha klasat në mënyrë të tillë që përgjigjet e fëmijëve të jenë anonime.

Gjëja e parë që duhet bërë (pas përfundimit të afatit të përcaktuar për dorëzimin në shkollë të Formularëve të Miratimit të plotësuar, nga prindërit) është identifikimi i rasteve refuzuese nga prindërit (konkretisht, nëse ndonjë prind/kujdestar ka kthyer përgjigje negative). Meqenëse u vendos të kërkohej një miratim në heshtje nga prindërit, nëse formularët nuk dorëzohen brenda afatit të caktuar, konsiderohet që prindi nuk është kundër pjesëmarrjes së fëmijës së tij në sondazh. Si rezultat hapat që duhen ndjekur pas përcaktimit të takimit me shkollat, janë si më poshtë:

- ▶ **Hapi i 1^{rë}:** Informimi i nxënësve për sondazhin dhe shpërndarja e Letrave Informuese për Prindërit dhe Formulari i Miratimit (për pjesëmarrjen e fëmijës në studim); kjo duhet të bëhet ose nga shkolla ose nga studiuesit.
- ▶ **Hapi i 2^{të}** (pas një afati të përcaktuar, p.sh. 1-3 ditë): Mbledhja e Formularëve të Miratimit → identifikimi i refuzimeve → shpërndarja e pyetësorëve tek nxënësit që kanë marrë miratimin nga prindërit (hapur ose në heshtje)⁹ → mbledhja e të dhënave → shpërndarja e zarfeve me pyetësorët për prindërit e tyre (të cilat duhet të kenë të njëjtin kod me atë të pyetësorit të fëmijëve), së bashku me letrën informuese përkatëse dhe formularin e miratimit të shprehur.
- ▶ **Hapi i 3^{të}** (ditën tjetër): Mbledhja e pyetësorëve të prindërve. Kjo do të bëhet në dy mënyra:

⁹ Në rast se ka refuzime nga prindërit, secili partner duhet të diskutojë me shkollat dhe të përpqet të gjejë zgjidhjen më të mirë të mundshme në lidhje me atë se çfarë do të bëjnë këta fëmijë gjatë kohës që shokët e tyre të klasës do të plotësojnë pyetësorin; zgjidhja më e mirë do të ishte t'u jepej atyre diçka tjetër për ta bërë në klasë; nuk rekomandohet që ata të nxirren nga klasa me qëllim që të shmangët sa më shumë stigmatizimi i tyre.

- Studiuesit (nëse është e mundur, të njëjtët studiues që mbledhën të dhënat në çdo klasë) duhet të shkojnë përsëri në shkollë ditën tjetër me qëllim që të mbledhin zarfet me pyetësorët e prindërve nga nxënësit (duhet të planifikohet edhe një takim tjetër në rast se disa nga fëmijët –ose prindërit – kanë harruar t'i sjellin pyetësorët ICAST-P; gjithmonë duhet të gjendet një mënyrë alternative për të bërë të mundur dorëzimin e të gjithë pyetësorëve të prindërve).
- Studiuesit duhet të mbledhin pyetësorët e prindërve në familjet e tyre, në rast se do të telefonohen për këtë.




Figura 6. Hapat që duhen ndjekur për mbledhjen e të dhënave në klasë.

Të gjitha **udhëzimet që studiuesit duhet të ndjekin gjatë mbledhjes së të dhënave në shkollë** përshkruhen hollësisht në Kreun B. 1. të “Udhërrëfyesit për studiuesit kërkimorë”.

D.1.2. Intervistat e Strukturuara

Në këtë nënndarje përshkruhen hapat e mbledhjes së të dhënave nëpërmjet intervistave të strukturuar me fëmijë që kanë lënë shkollat dhe prindërit e tyre. Pas marrjes së të dhënave të kontaktit nga shkolla (ose burim tjetër), Koordinator i Studimit në Terren duhet të kontaktojë prindërit e këtyre fëmijëve për t'i ftuar ata të marrin pjesë në sondazh (ose me telefon ose duke iu dërguar atyre **letrën informuese** për pjesëmarrjen e tyre dhe të fëmijëve të tyre në sondazh).

Hapat që duhen ndjekur janë si më poshtë:

- ▶ **Hapi i 1^{rë}:** kontaktimi i prindërve (me telefon ose postë) për t'i informuar dhe ftuar ata në sondazh
- ▶ **Hapi i 2^{të}:** mbyllja e takimeve për intervistat; mbajtja shënim e rasteve refuzuese (me qëllim që të llogaritet përqindja e përgjigjeve)
- ▶ **Hapi i 3^{të}:** grupe prej 2 studiuesish vizitojnë familjet: njëri studiues interviston prindin e fëmijës ndërsa, në të njëjtën kohë, intervistuesi tjetër interviston fëmijën. Para fillimit të intervistës studiuesit duhet të marrin nga prindi formularin e miratimit të firmosur dhe nga

fëmija the formularin e verifikuar të miratimit. Në fund të intervistës çdo studiues u shpërndan të intervistuarve letrat falënderuese përkatëse.

D.1.2.1. Përgatitja e Intervistës

Nëse prindërit kontaktohen përmes një letre informuese të dërguar me postë, duhet bërë edhe një telefonatë për t'i ftuar prindin/kujdestarin dhe fëmijën e tij të marrin pjesë në sondazh, duke identifikuar kështu ndonjë refuzim të mundshëm dhe të mbylljen e takimeve për intervistat. Në rast se prindërit kontaktohen vetëm përmes telefonit, qëllimi i sondazhit duhet t'u bëhet gjithashtu i ditur në telefon. Rasti i mëposhtëm mund të shërbejë si shembull (ISPCAN, 2006b, p. 6):

*“Mirëmbërma! Quhem _____ dhe flas nga <emri i organizatës>. [a e keni marrë letrën që ju kemi dërguar?] [...] ne **po kryejmë një sondazh për shëndetin dhe përvojat jetësore të prindërve dhe fëmijëve** dhe do të dëshironim shumë të bënim një intervistë me ju dhe fëmijën tuaj që aktualisht është <mosha> vjeç, e cila zgjat rreth 30-45 minuta.*

*Kjo është një çështje shumë e rëndësishme dhe shpresojmë t'i ndihmojmë prindërit dhe fëmijët të jetojnë më mirë. Nëse ju pranoni të merrni pjesë, ne **mund të mbyllim një takim me ju** dhe dy studiues do të vinë t'ju vizitojnë në familjen tuaj”, ose “ju dhe fëmija juaj mund të na vizitoni në <emri i zyrës ose i një vendi asnjanes, p.sh. shkollë, zyrë bashkie>. Dëshironi të merrni pjesë? [...] Cila është koha më e përshtatshme për ju? [...] Është <**data dhe ora**> e përshtatshme për ju dhe fëmijën tuaj? [...] do të donit t'ju vizitojmë ne apo do të preferonit të linim një takim në <**emri i vendtakimit**>. Studiuesit që do t'ju vizitojnë janë: <emri i intervistuesit të 1rë > dhe <emri i intervistuesit të 2të>.*

Meqenëse intervista është konfidenciale dhe private, do të ishte e nevojshme të kishit dy dhoma të veçanta për të qëndruar rreth 45 minuta pa ju dëgjuar apo ndërprerë askush.”

Theksoni rëndësinë e 2 dhomave në dispozicion.

“A jeni i sigurt që në këtë datë dhe orë që kemi caktuar do të kemi në dispozicion dy dhoma, një për ju dhe një për fëmijën tuaj, ku askush s'do të na dëgjojë apo ndërpresë gjatë intervistës?”

Refuzimi për të marrë pjesë: Nëse prindi i përzgjedhur refuzon të marrë pjesë, përpiquni, pa i bërë presion atij/asaj, të investigoni arsyet e mospranimit ose pyeteni nëse ai/ajo do të preferonte t'i telefononin një herë tjetër. Nëse prindi përsëri refuzon, pyeteni nëse ai/ajo ka ndonjë shqetësim në lidhje me intervistën që ju ndoshta mund ta adresoni.

Këshilla për të inkurajuar pjesëmarrjen (ISPCAN, 2006b, p. 7):

- tregoni gjithmonë respekt për familjarët, duke iu drejtuar atyre formalisht.
- theksoni që informacioni i dhënë prej tyre do të ndihmojë që të kuptojmë më shumë rreth një çështjeje shumë të rëndësishme të komunitetit tonë, konkretisht marrëdhëniet në familje.
- theksoni se intervista është tërësisht konfidenciale dhe private.
- theksoni që intervista kryhet nga studiuues plotësisht të kualifikuar.

Dhomat Private: Prindi/kujdestari duhet të kenë në dispozicion dy dhoma private për intervistat. Për këtë arsye:

- ▶ Letra informuese që do t’iu dërgohet –ose biseda telefonike- me prindërit/kujdestarët e fëmijëve duhet të theksojë nevojën e vënies në dispozicion të intervistës së dy dhomave private të ndara në shtëpinë e prindërve, pa u ndërprerë dhe pa praninë e ndonjë personi të tretë.
- ▶ Personi që do të telefonojë për të caktuar takimin për intervistën, duhet të theksojë përsëri kërkesën për privatësi dhe rëndësinë e disponueshmërisë së dhomave private:

“Jeni i sigurt që në këtë datë dhe orë që ju keni zgjedhur ne do të kemi në dispozicion dy dhoma, një për ju dhe një për fëmijën tuaj, ku asnjeri nuk do të na ndërpresë gjatë intervistës? Po e theksoj këtë sepse, me qëllim që rezultatet e intervistës të jenë të vlefshme për sondazhin, studiuuesit udhëzohen ta ndërpresin intervistën nëse persona të tjerë janë të pranishëm gjatë intervistës.”

Nëse shprehen dyshime nga prindërit ose vendtakimi privat nuk mund të jetë në shtëpi, përpiquni të përcaktoni një takim tjetër për intervistën në një kohë më të përshtatshme ose merrni masa për ta zhvilluar intervistën në një vend tjetër [kjo do të thotë që personi që do të telefonojë prindërit duhet të jetë në dijeni të axhendës së studiuësve që do të vizitojnë familjen].

“Udhërrëfyesi për Studiuësit Kërkimorë” përfshin **“Këshilla të Dobishme për Intervistuesit gjatë Intervistës”** (Kreu B. 2.1), **“Udhëzuesi i Intervistës së Prindërve”** për studiuësit (Kreu B. 2.2) dhe **“Udhëzuesi i Intervistës së Fëmijës”** (Kreu B. 2.3).

KREU E. PAS MBLEDHJES SË TË DHËNAVE

E.1. Verifikimi i të Dhënave

Pas administrimit të pyetësorëve (nëse është intervistë ose veçanërisht kur është pyetësor) studiuesit duhet të verifikojnë dhe të jenë të kujdesshëm për sa vijon:

- të sigurohen që çdo pyetësor ka një **Kod unik** (Numër Subjekti)
- të rishikojnë pyetësorët e plotësuar që ata kanë mbledhur dhe të kontrollojnë **plotësimin** e të dhënave (mungesë të dhënash, korrigjime të paqarta dhe fjali kontradiktore).

Studiuesit duhet të verifikojnë cilësinë e të gjithë pyetësorëve të plotësuar çdo ditë. Nëse ka mungesë të dhënash, nevojë për sqarime ose probleme të tjera, duhet të raportohet tek Koordinatori Lokal në Takimet Mbikëqyrëse të çdo dite me qëllim që të vendoset nëse ka nevojë për ndryshime në procesin e administrimit të pyetësorëve/intervistat e strukturuar dhe veçanërisht në udhëzimet/shpjegimet që jepen nga studiuesit me qëllim që të shmangen këto probleme në vazhdim të procesit. Duhet të theksohet se shpjegimet/udhëzimet plotësuese **duhet të miratohen më parë nga i tërë konsorciumi** me qëllim që t'u jepen në mënyrë uniforme të gjitha vendeve të tjera.

Të gjitha vëzhgimet e studiuesve duhet të regjistrohen në Formularët e Raportimit (për çdo klasë ku mblidhen të dhënat ose për çdo intervistë), dhe t'i dorëzohen Koordinatorit Lokal, i cili duhet gjithashtu të verifikojë pyetësorët nga ana e tij.

E.2. Siguria e të Dhënave

Studiuesit duhet t'i dorëzojnë Koordinatorit Lokal a) Pyetësorët e plotësuar (dhe ndonjë bosh), dhe b) Formularët e Raportimit për pyetësorët që ata kanë administruar. Studiuesit dhe Koordinatori Lokal duhet të kujdesen për ruajtjen në vend të sigurt të pyetësorëve të plotësuar kur janë në terren si dhe gjatë transferimit të tyre.

E.3. Hedhja e të Dhënave dhe Kodimi i tyre

Hedhja e të dhënave do të bëhet duke përdorur një model të përbashkët SPSS (një për pyetësorin e fëmijëve ICAST-CH dhe një për atë të prindërve ICAST-P). Modelet SPSS shoqërohen me lista kodesh (shih tabelën 5) duke përfshirë shpjegime se si mund të kodohen të dhënat.

Informacioni i mbledhur nga të gjitha vendet duhet të unifikohet, dhe Koordinatori duhet të informohet për ndryshoret e reja që mund t'u shtohen pyetësorëve (të cilat duhet të kodohen veçmas) dhe për ndonjë ndryshim në vlerat e ndryshoreve të dokumenteve të përbashkëta ICAST. Më konkretisht, çdo partner duhet t'i raportojë koordinatorit për:

Row	Label	Measurement	Value
588			q_18_pr
589			Value
590	Standard Attributes	Label	Shouted, yelled, or screamed at you very loud and aggressively? (prevalence)
591		Measurement	Nominal
592	Valid Values		never
593			yes ("always" or "usually" or "few times" or "not in the past year but it was happened before")
594	Missing Values		missing value
595			I don't want to answer
596			
597			
598			q_18_in
599			Value
600	Standard Attributes	Label	Shouted, yelled, or screamed at you very loud and aggressively? (incidence)
601		Measurement	Ordinal
602	Valid Values		1-2 times
603			3-5 times
604			6-10 times
605			more than 10 times
606	Missing Values		NA, "never", "past year", "don't want to answer"
607			missing value
608			
609			
610			q_18_a_1
611			Value
612	Standard Attributes	Label	Shouted, yelled, or screamed at you very loud and aggressively? _if this happened, was it by adult male
613		Measurement	Nominal
614	Valid Values		no
615			yes
616	Missing Values		not applicable ("0" or "999" in q_18_pr)
617			missing value

Tabela 5. Excel Codebook

- të gjitha ndryshimet (nëse ka) që i janë bërë pyetësorëve
- përcaktimin e kodeve për çdo vlerë të re (nëse ka) ose për çdo variabël të ndryshuar

Cilësia e të dhënave të koduara duhet të verifikohet a) nga partneri që ka bërë kodimin duke verifikuar një kampion rastësor të dhënash për korrektësinë e kodimit të tyre dhe b) nga partneri dhe Koordinatori duke kontrolluar për vlera të pamundura. Një opsion tjetër është caktimi i dy personave për të kryer kodimin e të gjitha të dhënave dhe krahasimi i dy kodimeve me qëllim që të dalin në pah mospërputhjet.

KREU F. ÇËSHTJE TË ETIKËS DHE SIGURISË

F.1. Çështjet Etike

Tema e studimit, konkretisht CAN (abuzimi dhe neglizhimi i fëmijëve), është delikate dhe duhen marrë në konsideratë çështje të veçanta etike. Siguria dhe mirëqenia e pjesëmarrësve në studim është shumë e rëndësishme.

“Ligjet e Raportimit në disa vende kërkojnë që dyshimet për abuzim apo neglizhim të fëmijëve duhet t’u raportohen autoriteteve të drejtësisë ose atyre të shërbimeve sociale. Megjithatë, këto raportime mund të çojnë vetëm në ndjekje penale të prindërve të fëmijës ose heqjen e fëmijës nga shtëpia e tij/saj. **Kujdes i veçantë duhet treguar në lidhje me respektimin e informacionit të çmuar që merret nga pjesëmarrësit në studim dhe marrjen e pëlqimit prej tyre.** Përfshirja e fëmijëve në sondazh në të cilin fëmijët japin informacion që mund të rezultojë i rrezikshëm për të tjerët kërkon kujdes të veçantë në lidhje me atë nëse fëmijët janë të aftë të kuptojnë rreziqet e një sondazhi të tillë dhe të jenë dakord për të marrë pjesë në të. Është e rëndësishme të theksohet se shumë projekte studimore bazuar në pyetje drejtuar fëmijëve mbi dhunën në familje e shkolla, janë kryer në mënyrë etike. Zakonisht ato kanë përdorur metodën e plotësimit anonim të pyetësorëve”. (ISPCAN, 2006a, fq. 2).

Pyetësori për fëmijë ICAST-CH “mund të mos jetë i përshtatshëm nga pikëpamja e sigurisë dhe etikës në disa vende ku ka ligje dhe politika që mund të kompromentojnë konfidencialitetin ose të kufizojnë autonominë e fëmijës që jep informacion” (ISPCAN, 2006a, fq. 2-3). Qëllimi i ISPCAN është të ofrojë një dokument standard që mund të përdoret për të investiguar në mënyrë etike dhe të sigurt mbi përvojat e fëmijëve (ISPCAN, 2006a).

“Megenëse ligjet e raportimit të abuzimit të fëmijëve, dhe vetë ekzistenca e agjencive që mund të ndërhyjnë, ndryshojnë nga njeri vend në tjetrin,” dokumentet ICAST duhet të përdoren me kusht që “të sigurohet autonomia dhe konfidencialiteti i fëmijës” (ISPCAN, 2006a, fq.3). Të gjithë Koordinatorët Shkencorë Lokalë të projektit BECAN u angazhuan të kryejnë sondazhe që zbatojnë rreptësisht Parimet e Kodit të Etikës për studime që kanë në fokus njeriun, në lidhje me rekrutimin, pjesëmarrjen, pëlqimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në kontekstin e sistemeve ligjore, sociale dhe mjekësore ku do të kryhet studimi. Edhe pse **çdo studiues është gjithashtu përgjegjës për anën etike të sondazhit** që ai po kryen, në çdo vend **Koordinatori Shkencor** së bashku me **Koordinatorin/ët Lokal/ë** janë gjithashtu përgjegjës për aspektin etik të studimit.

Për qëllimet e Projektit BECAN janë ngritur një **Bord Qendror Këshillimor i Pavarur (CIAB)** dhe **9 Borde Këshillimore Kombëtare (NAB)** për Çështje Etike, një në çdo vend pjesëmarrës. Çdo **Bord Këshillimor Kombëtar (NAB)** përbëhet nga një përfaqësues nga Instituti partner, i cili është përgjegjës për projektin, dhe dy ekspertë të pavarur të çështjeve të CAN. Çdo NAB është përgjegjës ndër të tjera për rishikimin e projektit dhe proceseve që i paraprijnë studimit, monitorimin e çështjeve të etikës gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimit dhe këshillimin për ndërhyrje korigjuese, nëse është e nevojshme. **Bordi Qendror Këshillimor i Pavarur (CIAB)** për çështje etike është përgjegjës ndër të tjera për mbikëqyrjen e plotë të planit të studimit dhe implementimit të tij duke respektuar aspektin etik. CIAB përbëhet nga pesë anëtarë: **Prof. Kevin Browne** (Profesor i Psikologjisë Familjare dhe asaj për çështje të

Mjekësisë Ligjore & Kryetar i Qendrës WHO për Kujdesin dhe Mbrojtjen e Fëmijëve), **Donata Bianchi** (Institute Degli Innocenti), **John Fluke** (Drejtor i Qendrës Kërkimore të Mbrojtjes së Fëmijëve, American Humane Association, Kolorado), **Paul Durning** (Profesor i Shkencave të Edukimit në Universitetin e Paris X Nanterre & Drejtor i “Observatoire National de l’Enfance en Danger”), dhe **Prof. Hans Grietens** (Universiteti i Groningen, Hollandë). Metodologjia e studimit BECAN iu është dorëzuar për rishikim në aspektin etik **Bordeve Këshillimore Kombëtare (NAB)** për çështje etike që janë ngritur në çdo vend pjesëmarrës si dhe **Bordit Qendror Këshillimor të Pavarur**.

Përveç masave të mësipërme, çdo partner duhet t'i dorëzojë Komisionit përkatës të Etikës të Organizatave pjesëmarrëse (nëse ekziston) dhe/ose një Komisioni ekuivalent Etike në vendin e tij protokollin e studimit për rishikimin e aspektit etik. Së fundi, çdo Organizatë partnere duhet të ndjekë rregullat Kombëtare për të hyrë në shkolla (p.sh. duke aplikuar pranë Ministrisë së Arsimit).

“për shkak të kërkesave komplekse të konkurrencës të imponuara nga parimet etike të moscenimit të ligjit (“Mos dëmto”), mirëqenies dhe autonomisë së fëmijës ose respektimit të vullnetit të pjesëmarrësve, ekipi i studiuesve duhet të jetë i përgatitur mirë për të adresuar çështjet etike” (ISPCAN, 2006a, fq. 3). **Të gjithë studiuesit duhet të kenë njohuritë e duhura në lidhje me etikën e punës kërkimore** si dhe të marrin pjesë në Seminarin Trajnues të studiuesve të projektit BECAN që do të organizohet në secilin vend.

Më poshtë (Kreu F. 1.1 - 7 dhe F. 2.1 - 3) përshkruhen çështjet etike që janë përfshirë në studim si dhe masat që duhen marrë në secilin vend me qëllim që aspekti etik i studimit si dhe siguria e pjesëmarrësve dhe e studiuesve të mbrohen, mbi bazën e Kodit të Etikës së Shoqatës Psikologjike Amerikane (2002) dhe Amendamenteve të vitit 2010¹⁰.

Këshillohet që secili partner t'i modifikojë krerët përkatës të “Udhërrëfyesit për Studiuesit” sipas Kodit Kombëtar të Etikës; dhe, edhe pse studiuesit që do të caktohen të kryejnë sondazhin duhet të kenë të paktën trajnimin bazë mbi etikën e punës kërkimore, rekomandohet që një sesion i veçantë i Seminarit Trajnues t'u dedikohet këtyre çështjeve.

F.1.1. Privatësia dhe Konfidencialiteti

Janë marrë masa me qëllim që të ruhet karakteri privat i intervistës dhe i pyetësorëve si edhe të ruhet konfidencialiteti i të dhënave dhe informacionit të marrë nga pjesëmarrësit gjatë mbledhjes së të dhënave dhe pas saj (p.sh. pyetësorët anonimë, moslejimi i nxënësve që të diskutojnë ose të shohin përgjigjet e njëri-tjetrit, mbledhja e të gjithë pyetësorëve të një klase në zarfe/kuti të mëdha, intervista private – pa praninë e personave të tretë). Më tepër informacion përfshihet në “Udhërrëfyesin për Studiuesit Kërkimorë” për secilën nga metodat e mbledhjes së të dhënave (Kreu D1).

Me qëllim që të mos shkelen të drejtat e pjesëmarrësve, është shumë e rëndësishme të informohen ata në lidhje me **kufijtë e konfidencialitetit** që karakterizojnë studimin tonë (veçanërisht kur mbledhja e të dhënave bëhet përmes intervistës); edhe pse ky informacion përfshihet në letrën informuese të prindit, është e rëndësishme që studiuesi t'i informojë edhe

¹⁰ Mund të vizitoni: <http://www.apa.org/ethics/code/index.aspx>, më 30 Korrik, 2010.

gojarisht të anketuarit para mbledhjes së të dhënave se konfidencialiteti i premtuar mund të cenohet në rast se "... jeta e dikujt është në rrezik ose nëse ju doni të flisni me dikë tjetër për një çështje që ka të bëjë me ju".

F.1.2. Fshehja e Pjesshme e Qëllimit

Fshehja e pjesshme e qëllimit në kontekstin e projektit BECAN në lidhje me temën e studimit, u vendos të adoptohet sepse u konsiderua si e justifikueshme dhe e nevojshme; më konkretisht, fshehja e pjesshme e qëllimit të vërtetë të studimit nga pjesëmarrësit u vendos me qëllim që të shmangej a) marrja e një pozicioni mbrojtës nga pjesëmarrësit (prindër dhe fëmijë), i cili mund të rezultojë në përgjigje jo të sinqerta (të pavlefshme), dhe b) hezitimi për të marrë pjesë i fajtorëve të abuzimit dhe neglizhimit të fëmijëve (ose moslejimi i fëmijëve të tyre të marrin pjesë), në një sondazh që studion abuzimin dhe neglizhimin e fëmijëve.

Megjithatë, kjo fshehje e pjesshme e qëllimit, e bën edhe më të rëndësishëm detyrimin e studiuesve:

- për të theksuar në mënyrë të veçantë të drejtën e pjesëmarrësit për të refuzuar pjesëmarrjen e tij ose për t'u tërhequr (shih Kreun F. 1.3 dhe F. 1.4)
- për t'ua bërë të qartë të gjithë pjesëmarrësve se, në rrethana specifike, studiuesi mund të cenoje konfidencialitetin që u ka premtuar atyre (është e rëndësishme që studiuesit të trajnohen me qëllim që ta bëjnë këtë duke mos i frikësuar të anketuarit gjë që mund t'i bëjë ata të refuzojnë pjesëmarrjen në studim).

Fshehja e pjesshme e qëllimit rrit gjithashtu rëndësinë e raportimit nga pjesëmarrësit dhe dispozitat ligjore që duhen zbatuar në çdo vend me qëllim që të shmangen raste dëshpërimi (afatshkurtër ose afatgjatë) ose pasoja të tjera të padëshiruara, nga pjesëmarrja në studim (shih gjithashtu Kreun F. 1.5).

F.1.3. E Drejta për të Refuzuar Pjesëmarrjen ose për t'u Tërhequr

Studiuesit duhet të kujtohen të informojnë pjesëmarrësit - në fillim të intervistës dhe/ose të administrimit të pyetësorëve – se ata kanë të drejtë të mos pranojnë të marrin pjesë në studim, të refuzojnë t'u përgjigjen pyetjeve të caktuara dhe të drejtën për të mos e vazhduar intervistën/plotësimin e pyetësorit në çdo kohë që ata dëshirojnë, dhe pa u dashur të shpjegojnë arsyet për këtë. Pjesëmarrësit duhet të informohen se kanë të drejtë "të mos pranojnë të marrin pjesë pa asnjë pasojë. Nuk duhet të ketë asnjë pasojë negative në rast se zgjidhet mospjesëmarrja" (ISPCAN, 2006a, fq. 6).

Megjithatë, në rast tërheqjeje ose refuzimi për të marrë pjesë, studiuesit duhet të përpiqen të gjejnë, nëse është e mundur, arsyet pse personi ka vendosur të tërhiqet, sepse a) arsyeja e tërheqjes mund të jetë një faktor/pengesë që mund(duhet) të zgjidhet aty për aty ose që kërkon kohë (p.sh. ndjenja e turpit, frika se mos abuzuesi hakmerret, vuajtje emocionale shkaktuar nga pyetjet e bëra, etj.) dhe b) mbledhja e këtij informacioni është shumë e dobishme për studimet e ardhshme të kësaj natyre. Është e rëndësishme gjithashtu që studiuesit të trajnohen në mënyrë që ta bëjnë këtë pa ushtruar presion mbi pjesëmarrësin që dëshiron të tërhiqet.

F.1.4. Miratimi për Pjesëmarrjen në Sondazh

Çështjet etike të një rëndësie të veçantë janë me interes sepse, a) subjektet e sondazheve janë fëmijë kështu që miratimi për pjesëmarrjen e tyre në studim duhet të merret nga dikush tjetër (prind ose kujdestar), dhe b) në shumicën e vendeve, nëse dikush është i vetëdijshëm ose dyshon se një fëmijë është viktimë e abuzimit/neglizhimit, ai/ajo duhet të raportojë tek autoritetet kompetente. Raportimi i abuzimit të fëmijës mund të rezultojë në ndjekje penale të prindit/ërve të fëmijës (ose një personi të tretë) dhe/ose zhvendosjen e fëmijës nga familja. Për këtë arsye, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet Parimit Etik të **Dhënies së Miratimit**. Me qëllim që pëlqimi i marrë nga prindërit të konsiderohet i vlefshëm, atyre duhet t'u jepet të paktën informacioni i mëposhtëm (përmes letrës informuese dhe Formularit të Miratimit, **por edhe gojarisht**)

- 1) qëllimi i studimit (me minimumin e fshehjes që konsiderohet e justifikuar), kohëzgjatja e pritshme, dhe përshkrimi i procedurave
- 2) anonimiteti i të dhënave të marra (përmes pyetësorit apo intervistës)
- 3) e drejta për të refuzuar pjesëmarrjen ose për t'u tërhequr nga studimi
 - a. në çdo kohë
 - b. dhe pa asnjë pasojë
- 4) kufijtë e konfidencialitetit
- 5) kë të kontaktojnë për pyetje rreth studimit, duke iu dhënë mundësinë pjesëmarrësve të bëjnë pyetje dhe të marrin përgjigje

F.1.5. Takimet Informuese

Takimet informuese bëhen më të rëndësishme për shkak të fshehjes së pjesshme të qëllimit të studimit. Në fund të mbledhjes së të dhënave, studiuesit duhet t'u japin pjesëmarrësve mundësinë të marrin të gjithë informacionin që ata dëshirojnë për studimin dhe të ndërmarrin hapa të arsyeshëm për të korigjuar ndonjë koncept të gabuar që mund të kenë pjesëmarrësit. Organizata e Studimit Kërkimor gjithashtu, ka detyrimin të vetëriparojë ndonjë efekt të kundërt/negativ që mund t'u ketë shkaktuar të anketuarve pjesëmarrja në studim.

Përveç kësaj, “ndërsa rastet kur një fëmijë ndihet i lënduar nga pyetjet që përfshihen në këtë lloj studimi janë të rralla,” – sipas përvojës së ISPCAN- “dokumentet në fjalë përmbajnë pyetje rreth përvojave që mund të kenë qenë të dhimbshme ose shqetësuese për fëmijën”. Fëmija “mund të dojë të flasë ose të kërkojë ndihmë në lidhje me eksperiencën të caktuar që përfshihen në pyetjet e dokumenteve të studimit”. Studiuesit “duhet të jenë të përgatitur t'u ofrojnë këshillim ose takime informuese të gjithë subjekteve për mënyrën se si ata mund të marrin ndihmën e duhur ose të flasin me dikë për çështje që përfshihen në pyetësor” (ISPCAN, 2006a, fq. 6). E njëjta gjë vlen edhe për pjesëmarrësit e rritur. Për këtë arsye, letra falënderuese përmban një fjali standarde: pyetësori mund të mbulojë tema që janë stresuese ose shqetësuese dhe çdo pjesëmarrës që ka pyetje mund të kontaktojë organizatat/agjencitë komunitare të rekomanduara nëse dëshiron të flasë me dikë ose të kërkojë ndihmë (kjo organizatë mund të jetë Organizata që kryen studimin ose një tjetër –në varësi të shërbimeve që ofron organizata partnere dhe zonën që ajo mbulon). Përveç kësaj, çdo studiues duhet të

ketë në dispozicion një listë të detajuar me të gjitha shërbimet e disponueshme lokale në rast se ai/ajo duhet t'u referohet atyre.

Në çdo rast, pjesëmarrësve duhet t'u jepen të dhënat e kontaktit të Organizatës që kryen studimin.

F.1.6. Ruajtja dhe Aksesi i të Dhënave

Edhe pse pyetësorët e plotësuar do të jenë tërësisht anonimë, çdo Koordinator Shkencor Lokal duhet të jetë përgjegjës për t'i ruajtur të dhënat (si pyetësorët e plotësuar ashtu edhe databesin e të dhënave të koduara) të sigurta, në një vend të sigurt dhe të kufizojë aksesin e tyre vetëm për personelin e autorizuar me qëllim që të mundësohet konfidencialiteti i të dhënave. Ata duhet të sigurohen që pyetësorët dhe të dhënat e koduara nuk lidhen me identitetin e të anketuarve dhe se vetëm një ose pak persona kanë akses në regjistrin e kodeve (ku duhen përfshirë edhe disa të dhëna personale për arsye praktike).

Dokumentet e plotësuara duhet të transferohen rregullisht, me shumë kujdes nga mjediset shkollore ose familjare pra, nga terreni, në zyrën e hedhjes së të dhënave, nga Studiuesit dhe Koordinatori Lokal (shih gjithashtu përshkrimin në Kreun A. 3 të "Udhërrëfyesit për Studiuesit Kërkimorë"); Koordinatori Lokal do të jetë përgjegjës për mbledhjen e të gjithë pyetësorëve të plotësuar (dhe të paplotësuar) në fund të çdo "dite të mbledhjes së të dhënave" dhe transferimin e sigurt të tyre në zyrat e Organizatës, ku ato do të ruhen të sigurta. Në çdo vend përgjegjësia për planifikimin e transferimit dhe të ruajtjes së sigurt të pyetësorëve të plotësuar i takon Koordinatorit Shkencor Kombëtar.

F.1.7. Përshkrimi i Sondazhit në Publik

Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet mënyrës se si brendia e sondazhit përcillet në shkolla dhe komunitet si dhe në individë të veçantë (p.sh. mësues/Drejtorë shkollash, personi që hap derën e shtëpisë ose ai që përgjigjet në telefon). Sondazhi duhet përshkruar si: "një sondazh që synon të investigojë çështje që kanë të bëjnë me shëndetin e fëmijëve si dhe çështje që kanë të bëjnë me rritjen e fëmijëve dhe marrëdhëniet midis fëmijëve dhe prindërve si edhe midis fëmijëve". Sa herë që studiuesit përshkruajnë sondazhin (për anëtarët e komunitetit dhe anëtarët e institucioneve publike ose private të komunitetit) së pari duhet të kenë në mendje **sigurinë e pjesëmarrësve**. Aty ku çështjet e sigurisë janë shqetësuese, studiuesit mund ta këshillojnë të intervistuarin (fëmijë ose i rritur) të diskutojë për sondazhin me shqetësim e interes.

F.2. Çështje të Sigurisë

F.2.1. Mbikëqyrja e Rasteve Kritike dhe Ndërhyrja në to

Studiuesit në terren duhet të organizohen në skuadra dhe gjithmonë të shoqërohen nga një Koordinator Lokal (studiuesi me më shumë përvojë). Gjatë çdo dite kërkimi në terren Koordinatori Lokal duhet të jetë i kapshëm për komunikim dhe udhëzime të tjera (d.m.th. përmes celularit). Duhet të sigurohen mjetet e transportit në rast se Koordinatori Lokal duhet të ndërhyjë në raste kritike.

Në përfundim të ditës së mbledhjes së të dhënave (p.sh. në mbrëmje) duhet të mbahet një “Takim Mbikëqyrës” i të gjithë studiuesve nën mbikëqyrjen e Koordinatorit Lokal; synimi i këtij takimi është i dyfishtë, njëri lidhet me çështjet metodologjike dhe tjetri me ato etike, konkretisht:

- a) identifikimi dhe diskutimi i vështirësive ose problemeve teknike dhe administrative të paparashikuara që studiuesit mund të kenë hasur gjatë mbledhjes së të dhënave. Koordinatori Lokal duhet të bëjë monitorimin e përditshëm të mbarëvajtjes së studimit (këshillohet që koordinatori të regjistrojë çdo ditë numrin dhe gjininë e subjekteve të anketuar nga çdo çift studiuesish çdo ditë, në çdo klasë; kështu do të jetë e mundur të identifikohen –dhe të korrigojnë – ngatërresat në kode (nëse ka) ose mospërputhjet që mund të vëzhgohen në pyetësorët prind-fëmijë)
- b) raportimi dhe diskutimi i rasteve të dyshuara ose të zbuluara të abuzimit dhe të neglizhimit; për secilin rast duhet të merret një vendim për hapat e mëtejshëm që duhen ndjekur (shih gjithashtu nënndarjet F. 1.8 dhe D5, rreth *reagimit në rastet e CAN*).

Ndërhyrja në rastet kritike: duhet të përcaktohet një plan me qëllim që të zgjidhen krizat në terren (në rastet e rralla që mund të hasen), si p.sh.:

- ▶ **shqetësimi emocional i të anketuarit gjatë intervistës ose plotësimi të pyetësorit:** aftësia për të përballuar këtë situatë varet nga individualiteti i çdo studiuesi dhe sa ekspert është ai në çështjet e abuzimit dhe neglizhimit(CAN), gjithashtu, çdo partner është i lirë të hartojë strategjinë që ai e konsideron më efektive për vendin e vet. Si strategji e përgjithshme, sugjerohet që (nëse në një klasë) njëri nga studiuesit duhet ta nxjerrë jashtë klasës fëmijën dhe të diskutojë me të se çfarë e shqetëson atë kaq shumë, studiuesi tjetër duhet të qëndrojë me fëmijën derisa ai të qetësohet dhe nëse nevojitet, ai duhet të telefonojë për ndihmë (p.sh. Koordinatorin Lokal ose një Psikolog Klinik për Fëmijë nëse është e mundur, ose psikologun e shkollës). Në rast interviste, intervistuesi duhet ta ndërpresë intervistën dhe të ndjekë të njëjtat hapa si më lart; intervista mund të vazhdojë ose jo në varësi të dëshirës së fëmijës.

Në të dyja rastet, studiuesit nuk duhet ta lënë fëmijën vetëm pa u siguruar që ai është jashtë rrezikut dhe i qetë; përveç kësaj, ata duhet të kujdesen që fëmijës t'i ofrohen detajet e kontaktit të organizatës që kryen studimin nëse ai/ajo dëshiron të kontaktojë me të në të ardhmen. Në rast se një fëmijë zbulon se abuzohet ose është abuzuar në të shkuarën, duhet të ndiqet procesi që përshkruhet në paragrafin tjetër.

- ▶ **sjellja agresive e prindit ose e një personi tjetër:** studiuesit duhet ta dinë se ç'hapa specifike duhet të ndjekin në rastet fatkeqe dhe të rralla kur ata mendojnë se ndodhen në rrezik ose kur mendojnë se një fëmijë është në rrezik serioz (p.sh. të telefonojnë policinë ose ndonjë Agjenci tjetër). Ky proces duhet të planifikohet në secilin vend në bazë të rrethanave konkrete, në nivel Kombëtar ose Rajonal (shih gjithashtu Kreun F. 3). Masat për mbrojtjen e përgjithshme që janë marrë për të garantuar sigurinë e studiuesve (p.sh. telefona celulare edhe pse në opsionin pa zile të studiuesve gjatë mbledhjes së të dhënave, listë me telefona të nevojshëm, Koordinatori Lokal është gjithmonë në dijeni të vendndodhjes së çdo studiuesi, etj.)

përshkruhen në krerët përkatës të Manualit. Si strategji e përgjithshme, sugjerohet që çdo partner duhet të përpiqet ta prezantojë këtë temë tek studiuesit pa i frikësuar ata sepse nuk parashikohet që ndonjëri prej tyre të përballet me rreziqe serioze gjatë mbledhjes së të dhënave. Ata duhet të udhëzohen që të mos i përgjigjen me agresivitet askujt që tregohet agresiv ndaj tyre dhe se duhet ta përcaktojnë saktë nëse janë në rrezik apo jo me qëllim që të ndjekin procesin e para caktuar.

F.2.2. Reagimi në Rastet e CAN

Çështje që duhen marrë në konsideratë janë edhe: si duhet të reagojë studiuesi kur, gjatë mbledhjes së të dhënave, zbulohet një rast serioz i abuzimit dhe neglizimit (CAN) si dhe çfarë duhet të ndodhë kur, pas ose gjatë studimit, një subjekt do të kërkojë ndihmë. Detyrimi i studiuesve dhe i Organizatës që kryen Studimin të raportojnë rastet e dyshuara ose të pikasura të CAN mbi bazën e legjislacionit kombëtar ndryshon nga njëri vend në tjetrin. Si rregull i përgjithshëm, secila Organizatë partnere, Koordinatori Shkencor i projektit BECAN, Koordinatori Lokal dhe çdo studiues i BECAN duhet të zbatojnë me rigorozitet Ligjet Kombëtare dhe Parimet e Kodit të tyre të Etikës. Disa parime dhe masa –të përbashkëta për të gjitha vendet janë:

- ▶ Letra falënderuese që përmban një referencë me shkrim për shërbimet lokale dhe/ose organizatën që kryen sondazhin; duhet të kushtohet vëmendje e veçantë me qëllim që të mos përfshihet në letrat falënderuese informacion i tillë që mund të rrezikojë më tej sigurinë e një viktime të mundshme të abuzimit.
- ▶ **Përgjigjet e standardizuara** (shih Kreun D. 8 të “Udhërrëfyesit për Studiuesit”) dhe **reagimet** (për çdo rajon) **e studiuesve në terren** duhet të hartohen në secilin vend, në rast se një fëmijë iu kërkon ndihmë.
- ▶ Studiuesit e rinj duhet të shoqërohen nga një studiues me përvojë nëse është e mundur, një psikolog/e klinike me eksperiencë duhet të jetë gjithmonë në dispozicion nëse kërkohet ndihma e tij/saj.
- ▶ Në fillim të sondazhit (ose edhe para tij) vendosni (p.sh. përmes një vizite të Koordinatorit të Studimit në Terren/Koordinatorit Lokal) lidhje të mira me autoritetet dhe/ose shërbimet kompetente lokale; informoni profesionistët për studimin dhe kërkoni asistencën e tyre me qëllim që të keni pranë një “task force” (edhe virtualisht) nëse është e nevojshme (kjo përpjekje do të krijojë dhe/ose përmirësojë bashkëveprimin e suksesshëm mes ËP3 dhe ËP4)
- ▶ Nëse raportohet ndonjë rast i CAN, para se të telefononi autoritetet ose agjencitë lokale mundohuni në mënyrë jozyrtare të grumbulloni informacion paraprak nga mësues të përgjegjshëm të shkollës ose drejtori i shkollës. Në më të shumtën e rasteve, personeli i shkollës mund të sjellë në vëmendjen e studiuesve informacion të rëndësishëm por tregoni kujdes për të mos shkelur konfidencialitetin.
- ▶ Të jeni mjaft të kujdesshëm për çështje të konfidencialitetit, veçanërisht në procesin e lartpërmendur: shmangni publikimin në agjentë ose subjekte brenda shkollës ose Komunitetit Lokal. Që nuk kanë të bëjnë me çështjen. Studiuesit në terren duhet të paralajmërohen dhe të trajnohen mbi ruajtjen e sekretit dhe të konfidencialitetit të

raportimeve të mundshme dhe të informacionit të marrë ndaj çdo përfaqësuesi të paautorizuar.

- ▶ Përpiquni ta ruani në nivelin më minimal të mundshëm rolin e personelit të BECAN në procesin e menaxhimit të çdo raportimi të CAN, duke mundësuar kështu, përfshirjen e agjencive dhe organizatave kompetente lokale në adresimin e rasteve të tilla.
- ▶ Në rastet e CAN që janë zbuluar më parë BECAN, përpiquni të tregoni një interesim të vazhdueshëm (edhe pse nga larg) mbi ecurinë e menaxhimit dhe të trajtimit të tyre (p.sh. duke kontaktuar profesionistët përgjegjës të agjencive dhe organizatave lokale me qëllim që të pyesni për rezultatet e raportit – mbajtja e kontaktit direkt me familjet ose viktimën duhet vlerësuar me kujdes dhe mundësisht duhet shmangur – veçanërisht në vendet ku Organizata Studimore nuk është e specializuar të trajtojë raste të abuzimit të fëmijëve.)
- ▶ Shmangni nënkuptimin e ndonjë premtimi joreal nga fëmija ose familja e tij për vazhdimësinë e kujdesit dhe mbështetjes në rast se kjo është e përzemërsueshme.
- ▶ Respektoni legjislacionin kombëtar mbi raportimin dhe Kodin Kombëtar të Etikës që janë të detyrueshme si për studiuesit dhe/ose për profesionistët (p.sh. psikologë, psikiatër, punonjës socialë); trajtoni studiuesit tuaj që të bëjnë të njëjtën gjë, por mos harroni se personi që mbikëqyr studiuesit është njëlloj përgjegjës si ata për sjelljen etike të tyre në të gjithë ecurinë e sondazhit.
 - Nëse nuk është përcaktuar me ligj, bëni kujdes të veçantë që të përcaktohet qartë se detyra e kujt është të vendoset nëse një raportim i CAN duhet dorëzuar, detyra e kujt është dorëzimi i raportimit, si dhe cilës agjenci duhet t'i dorëzohet dhe përmes cilit proces duhet të kalojë.
- ▶ Përgjigja ndaj raportimeve të CAN duhet të përshtatet sipas a) legjislacionit kombëtar mbi raportimin e CAN b) disponueshmërisë së burimeve kompetente lokale dhe c) kapacitetit dhe burimeve të partnerëve për trajtimin e rasteve individuale të CAN
- ▶ Studiuesit duhet të plotësojnë vendin e përcaktuar në Formularët e Raportimit në lidhje me rastet e CAN (të dyshuara ose të zbuluara)
 - Të verifikojnë përqindjet e raportimeve të CAN të studiuesve në terren.

Si të reagohet në rast të zbulimit të CAN

Rastet e zbulimit të Can duhet të trajtohen me kujdesin më të madh, duke pasur parasysh mungesën e legjislacionit dhe të raportimit të detyrueshëm të këtyre rasteve. Mosfunksionimi i sistemit të mbrojtjes së fëmijëve gjithashtu përforcon nevojën për të trajtuar me shumë kujdes këto raste – duke vënë në plan të parë sigurinë e fëmijëve dhe të prindërve të tyre si dhe minimizimin e ndonjë dëmtimi të mundshëm që mund të vijë si rrjedhojë e zbulimit të rasteve të CaN gjatë kryerjes së studimit.

Në rast të zbulimit të CAN, kërkuesit duhet të mbledhin sa më shumë informacion që të jetë e mundur pa vënë në rrezik fëmijën dhe duke u siguruar për mbrojtjen e konfidencialitetit. Kërkuesit duhet të përpilojnë një raport të rastit dhe t'ja dorëzojnë Koordinatorit lokal i cili/e cila do ja paraqesë këto raste Koordinatorit të studimit. Kërkuesit, gjithashtu, do i japin fëmijës ose prindit informacion dhe numrat e kontaktit të burimeve lokale që punojnë në fushën e

mbrojtjes së fëmijëve (lista e detajuar e këtyre burimeve ndodhet në udhërrëfyesin e kërkuesve).

Koordinatori i BECAN duhet të mbledhë të gjithë raportet mbi rastet CAN dhe të veprojë sipas rastit. Koordinatori duhet t'ja paraqesë këto raste Bordit Këshillimor të Shqipërisë i cili do vendosë për hapat e mëtejshëm që duhen ndërmarrë në çdo rast.

Është e nevojshme të raportohen rastet e dyshuara për abuzim tek autoritetet?

Për momentin, raportimi i rasteve të CAN nuk është i detyrueshëm në Shqipëri. Pra, kërkuesit e BECAN nuk kanë detyrim ligjor të raportojnë këto raste në autoritetet vendore. Megjithatë, Bordi Këshillimor i Shqipërisë mund të vendosë që në raste të abuzimit të rëndë dhe kur jeta e fëmijës është në rrezik duhet të raportohet tek organet e ruajtjes së rendit. Këto vendime do merren sipas rastit duke synuar që fëmija të mos vihet në rrezik si pasojë e këtyre veprimeve.

Siguria e Pjesëmarrësve dhe e Studiuesve

Siguria e pjesëmarrësve (por edhe e ekipit të studiuesve) është e një rëndësie të veçantë në studime që investigojnë çështje delikate si abuzimi.

Ju duhet të merrni çdo masë paraprake (plani i sigurisë), dhe duhet të bëni shumë përpjekje që ekipi juaj i studiuesve të jenë sa më të përgatitur që të mos i rrezikojnë të anketuarit (ose veten), por gjithashtu, të jenë në gjendje t'i përgjigjen si duhet çdo rreziku me të cilin mund të përballen gjatë sondazhit; në të njëjtën kohë, ju duhet të jeni tepër të kujdesshëm me qëllim që të mos frikësoni studiuesit tuaj duke i bërë ata të besojnë se me siguri do të përballen me rrezik (serioz).

Disa **masa të përgjithshme** që të gjitha vendet duhet të marrin ose të adoptojnë janë si më poshtë: Në secilin vend duhet të hartohet një plan sigurie (e preferueshme **për çdo zonë gjeografike**) para fillimit të sondazhit, duke synuar parashikimin e çdo rreziku ose krize të mundshme me qëllim që studiuesit të jenë gati –dhe të aftë – t'i menaxhojnë ato, nëse do të ndodhnin. Përveç trajnimit të ekipit të studiuesve se si duhet ta zbatojnë planin e sigurisë, në bazë të tij, do të përgatiten **dy skeda** (për çdo rajon gjeografik) dhe do t'u jepen studiuesve, të cilët do t'i mbajnë ato gjithmonë me vete kur janë në këto zona.

- skeda e parë do të përmbajë të gjithë "numrat e nevojshëm të telefonit" që duhen përdorur në rast emergjence (p.sh. të policisë, ambulancës, koordinatorit lokal, psikologut klinik në dispozicion, të kolegëve studiues) ndërsa,
- skeda e dytë do të përmbajë "burimet e ndihmës" ku viktimat e abuzimit mund të kërkojnë ndihmë (konkretisht shërbimet lokale që mund të ofrojnë mbështetje për viktimat e abuzimit dhe/ose neglizhimit qofshin këta fëmijë ose të rritur, viktimat të dhunës nga partneri/ja ose forma të tjera të dhunës në familje; kujtohet që Koordinatori Lokal duhet të ketë kontaktuar me të gjithë profesionistët e këtyre Organizatave në fillim të sondazhit –ose edhe më parë).

Jo vetëm për arsye praktike, metodologjike dhe etike, por edhe për arsye sigurie, **studiuesit duhet t'i vizitojnë mjediset e mbledhjeve të dhënave çift**; ata udhëzohen që të punojnë me celularë të aktivizuar (në opsionin pa zile) në rast se u duhet t'i përdorin; dhe e fundit, është e rëndësishme që Koordinatori Lokal të jetë vazhdimisht **në dijeni të vendndodhjes së çdo studiuesi** (më shumë informacion gjendet në Krerët A. 3 dhe D. 9 të "Udhërrëfyesit për Studiuesit").

Takimet mbikëqyrëse, që mbahen çdo ditë, mund të konsiderohen si një masë që synon të rrisë sigurinë e pjesëmarrësve në studim dhe të studiuesve se çdo rast i identifikuar ose i dyshuar abuzimi dhe/ose çdo rrezik i mundshëm do të diskutohet dhe të merren vendime për t'i menaxhuar ato

F.3. Çfarë duhet bërë nëse....

Çfarë duhet bërë nëse një studiues:	
nuk ndihet mirë kur i bëjnë/bën këto pyetje?	Një studiues/intervistues që ndihet jo mirë të diskutojë çështje të tilla si abuzimi, do të ketë vështirësi të mëdha në mënyrën se si do t'i formulojnë pyetjet gjatë intervistave, ose kur përpiqet të qartësojë pyetjet për fëmijët në klasë, gjë që mund të çorientonte përgjigjet e fëmijëve; gjithashtu, ai/ajo mund të mos reflektojë sjelljen e duhur kur të anketuarit t'i drejtohen për t'i zbuluar rastin e tyre të abuzimit dhe t'i kërkojnë ndihmë. Studiuesit duhet të ndihen mirë me temën e sondazhit dhe të mos tronditen lehtë. Në rast të kundërt, mund të nevojitet trajnim i mëtejshëm dhe ky studiues duhet të kryej më shumë se dy intervista prove me fëmijë dhe prindër. Studiuesi duhet të jetë i sigurt pas proceseve të mësipërme e t'i raportojë Koordinatorit Lokal nëse është gati të marrë pjesë në sondazh. Ai/ajo duhet të mbikëqyren nga afër gjatë fazës së provës së sondazhit dhe nëse ai /ajo nuk ndihet mirë duhet të zëvendësohet me një tjetër.
nuk është me shumë (ose aspak) përvojë në çështje të CAN?	Studiuesit duhet të frekuentojnë një kurs trajnimi shtesë për çështje të CAN.
Nuk ndjek procesin hap pas hapi ose ndërmerr "iniciativa"?	Në raste të tilla studiuesi duhet të përjashtohet nga stafi i studiuesve dhe të zëvendësohet me një tjetër, nëse është e mundur.

Studiuesve duhet t'u jepen Udhëzime Specifike me qëllim që të dinë si të reagojnë kur përballen me secilën nga situatat e mëposhtme (Kreu D. 10 i "Udhërrëfyesit për Studiuesit Kërkimorë"):

Çfarë duhet bërë nëse një fëmijë:

- refuzon të plotësojë pyetësin (zgjedh "Jo" formularin e miratimit të fëmijës)?
- kërkon të plotësojë pyetësin në klasë por prindi nuk ka dhënë pëlqimin?
- zbulon një përvojë abuzimi(CAN) në pyetësin anonim ose personalisht?
- zbulon abuzim serioz por kërkon nga studiuesi të mos i tregojë askujt?

Çfarë duhet bërë nëse një mësues:

- insiston të jetë prezent në klasë gjatë plotësimit të pyetësorëve?
- i kërkon studiuesve një pyetësor për ta lexuar ose për ta mbajtur?
- shfaq qëndrim negativ ndaj temës së studimit ose studiuesve?
- ankohet se nuk është njoftuar për studimin?
- zbulon një rast abuzimi (të dyshuar) në shkollë ose familje?
- zbulon një rast të CAN por do të ruajë anonimitetin e tij/saj?

Çfarë duhet bërë nëse një prind:

- telefonon një studiues që të ankohet për përmbajtjen e disa pyetjeve?

REFERENCA

- American Psychological Association. (2002). Ethical Principles of Psychologists and Code of Conduct. Washington, DC: American Psychological Association
- International Society for the Prevention of Child Abuse and Neglect. (2006a). ICAST-C - The ISPCAN Child Abuse Screening Tool-Child Version: Manual and Proposed Guidelines for Pilot Administration.
- International Society for the Prevention of Child Abuse and Neglect. (2006b). ICAST Parent Interview: Procedures Manual and Field Test Guide for Investigators & Project Managers.



STUDIMI BALLKANIK EPIDEMIOLOGJIK MBI ABUZIMIN & NEGLIZHIMIN E FËMIJËVE (BECAN)

DG-RESEARCH [Nr i Kontratës: FP7-HEALTH-F2-2009-223478]

UDHËRRËFYES PËR KËRKUESIT SHKENCORË



*Puna për përgatitjen e këtij dokumenti është financuar nga Programi
7th Framework i Komunitetit European (FP7/2007-2013)
Nën marrëveshjen e grantit nr HEALTH-F2-2009-223478*

KAPITULLI A. DETYRIMET DHE PËRGATITJA PARAPRAKE E

KËRKUESVE

Kualifikimet e Kërkuesve

Kërkuesit konsiderohen si zemra e studimit dhe sidomos në rastet kur në studim trajtohen çështje shumë sensitive siç është abuzimi apo “familja” siç janë marrdhëniet familjare. Fëmijët ashtu si dhe të rriturit mund të mos ndjehen rehat për faktin që po marrin pjesë në një studim, apo që mund t'i duhet të flasin hapur për eksperiencat personale të tyre me kërkuesit që ndjekin studimin. Gjithashtu, ata mund të mos ndjehen komfortë sa duhet për të folur për çështje specifike me një person të një gjinie të caktuar (zakonisht me personat e gjinisë së kundërt).

Ju lutem vlerësoni çështjet e mëposhtme sa përshtaten me ju me qëllim që të shikoni sa kërkues i mirë jeni: Një kërkues i mirë për studimin e BECAN duhet të (sipas ISPCAN, 2006a, faqe 4-5):

- 1) **besojë në rëndësinë** e studimit
- 2) **njuhë mirë** natyrën e çështjes që trajtohet në studim dhe të mos **tronditet lehtë**
- 3) **jetë familjar me zakonet lokale** të pjesëmarrësve që do të përgjigjen në studim
- 4) jetë në gjendje që të **ndërtojë lehtësisht raporte** me tipe të ndryshëm personash (përsa i përket nivelit arsimor, statusit socio- ekonomik, apo personalitetit)
- 5) jetë **plotësisht familjar** me instrumentet dhe procedurat që do të përdoren në studim
- 6) jetë **shumë i përpiktë në ndjekjen** hap pas hapi të procedurave të ngritura për realizimin e studimit si (administrimi i pyetësorëve, prezantimi i standardeve të paracaktuar për përgjigjet e pyetjeve që do të zhvillohen, regjistrimi i përgjigjeve, ofrimi i asistencës për çdo të intervistuar etj.)
- 7) Jetë në gjendje të qëndrojë **neutral dhe jo- paragjykes**; nuk vepron si mik ose këshillues për pjesëmarrësit në studim (sidomos gjatë intervistave por edhe pas përfundimit të tyre)
- 8) jetë i **besueshëm**; i aftë apo me vullnet për :
 - a. të ndjekur të gjithë procesin ekzaktesisht siç është instruktuar
 - b. të sigurojë raporte të sakta dhe të besueshme gjatë procesit të punës
 - c. të ruajë në mënyrë strikte konfidencialitetin
- 9) jetë i **mirë informuar** rreth legjislacionit, rreth detyrimit të çdokujt për të raportuar rastet e abuzimit dhe rreth shërbimeve ndihmëse me qëllim që të mund a) të ofrojë informacion apo premtime të vlefshme në rast se del nevoja, b) të mos rrezikojë akoma më shumë sigurinë e viktimës që mund të kërkojë asistencën/ndihmën tuaj
- 10) jetë i/e kujdesshme në mënyrë që të mos rrezikojë sigurinë personale të të anketuarve/pjesëmarrësve në studim.

A.1. Familjarizimi me instrumentet

Të gjithë hulumtuesit duhet të njihen me procesin që duhet ndjekur për kryerjen e studimit, si dhe me instrumentet, - në rastin e intervistave ju duhet të njiheni me instrumentat për një

arsye më shumë: në mënyrë që të jeni në gjendje të lexoni pyetjet dhe të regjistroni përgjigjet me efikasitet, duke i regjistruar ato lehtësisht, shpejt dhe natyrshëm.

Pas trainimit tuaj dhe para fillimit të studimit në terren, ju duhet të përmbushni detyrimet e parashikuara gjatë trainimit për praktimin e njohurive tuaja, të cilat përfshijnë zhvillimin e mbledhjes së të dhënave pilot me dy nga metodat, domethënë plotësimin dhe intervistimin me fëmijë dhe prindër të vërtetë në mënyrë që të bëheni më familjarë me instrumentet dhe proceset që duhen ndjekur në studim.

Më konkretisht, ju duhet të administroni pyetsorët e ICAST-CH dhe ICAST-P dhe procesin a) për fëmijët dhe prindërit që e plotësojnë vetë pyetsorin deri në fund (nga të paktën 2 fëmijë dhe 2 prindër) dhe b) një intervistë të strukturuar (me të paktën 2 fëmijë dhe 2 prindër).

Pas të kontrolloni cilësinë e pyetsorit të plotësuar, ju duhet të plotësoni formatin Raportiv sipas (Shtojcave 2a dhe 2b) dhe të merrni pjesë në një seancë konsulence me trajnerin tuaj (s), ku ju do të raportoni dhe mund të diskutoni ndonjë vështirësi që mund të keni hasur gjatë mbledhjes së të dhënave.

Unë duhet të kem parasysh faktin se gjatë hulumtimit **të gjithë hulumtuesit duhet TË VEPROJNË SI NJË TRUP I VETËM** në lidhje me:

- o Si po e paraqes studimin për të anketuarit (dhe për publikun)
- o Si po i paraqes udhëzimet dhe si po e zhvilloj procesin e intervistimit
- o Si po i përgjigjem pyetjeve të të intervistuarve për sqarimet që ata mund të kërkojnë
- o Si po e raportoj procesin dhe progresin në takimet e përditshme
- o Si po e respektoj ruajtjen e konfidencialitetit
- o Si po i menaxhoj rastet e vështira kur dikush zbulon se ka pasur një rast abuzimi s
- o Si po e ruaj sigurinë e të intervistuarit dhe sigurinë time

A.2. Hap pas hapi përshkrimi i një "dite tipike në fushën e hulumtimit"

Një "ditë tipike hulumtimi në terren " zgjat shumë më tepër se një ditë 24-orëshe, që do të thotë që çdo studiues ka edhe detyrime të tjera para dhe pas mbledhjes së të dhënave, të cilat nuk mund të përmbushen në një ditë. Njësia e mëposhtme është një përpyetje për të përshkruar-hap pas hapi të gjitha detyrimet tuaja në një mënyrë kronologjike si do të mblidhen të dhënat nga nxënësit dhe prindërit e tyre nëpërmjet pyetësorëve që do të plotësohen nga ata vetë, si dhe një përpyetje për të kuptuar si do të kontrolloni cilësinë e plotësimit të pyetësorëve, të raportimit dhe pjesmarrjes në Takimet Supervizuese. Si të kontrolloni cilësinë pas përfundimit, si të raportoni dhe të përfshiheni në Takimet Supervizuese.

1. Dita para mbledhjes së të dhënave

- 1.1. Ju merrni nga Koordinatori lokal studimin dhe materialet e nevojshme mbështetëse për ditën e nesërme
- 1.2. në bazë të listës tuaj, ju kontrolloni nëse ju i keni të gjitha materialet që ju do ju duhen

- 1.3. Lokalizoni në hartë pikat e destinacionit që do të shkoni dhe organizoni detajet e udhëtimit (kjo është një pikë me rëndësi të veçantë, sidomos në rast se do të udhëtoni edhe me një grup tjetër të studimit në të njëjtën makinë, i cili është një opsion i mundshëm për arsye ekonomike). Nga ana tjetër, ky hap mund të ndërmerret dhe nga individë që mund të jenë dhe shoferë në makinën e udhëtimit dhe pjestarë të studimit apo koordinatorë lokalë njëkohësisht).
- 1.4. merrni masat e duhura për kohën dhe vendin që do të shkoni me ekipin të nesërmen në mënyrë që të keni mundësi të arrini më herët se orari i parashikuar në axhendë në shkollën që është paracaktuar

2. Dita e mbledhjes së të dhënave në shkollë

- 2.1. duhet të arrini në kohë, në mënyrë që të mos shkaktoni vonesë për të gjithë grupin kërkimor në studim
- 2.2. ndiqni në mënyrë precise dhe pa devijuar në asnjë hap, të gjithë procesin sipas trainimit që keni marrë
- 2.3. Përpiqui të mbani shënim me shpejtësi të gjitha vërejtjet tuaja që do i përdorni si kontribut në studim (p.sh. pyetjet që ju janë pyetur dhe ju nuk mund të përgjigjeni, sepse nuk keni në dispozicion përgjigje të parashikuara më parë, në qoftë se ka ndonjë gjë që gjatë procesit që ju ka vënë në situatë të vështirë apo " të veçantë " sjelljet që ju mund të keni vërejtur nga një nxënës ose një mësues apo nga drejtuesi i shkollës), dhe të gjitha këto vërejtje ti bëni duke qenë pjesmarrës në mjedisin e shkollës, por duke ruajtur konfidencialitetin e shënimeve që po mbani
- 2.4. ndërsa ju jeni duke lëvizur nga shkolla në shkollë, kini gjithmonë në mendje që transporti i pyetsorëve duhet të jetë shumë i sigurt (qofshin bosh apo të plotësuar). Nëse është e mundur, merrni me vete vetëm pyetsorët që duhen për secilën shkollë dhe nëse keni të tjerë me vete, lërnini në makinë pjesën tjetër që nuk duhet për shkollën që po vizitoni. Para largimit nga çdo klasë / shkollë, kontrolloni dhe verifikoninëse:
 - ju nuk keni harruar asgjë (mund të jetë i dobishëm përdorimi i një check list, derisa ky të tkohet në një proces automatik)
 - nëse ju e dini se kush nga dy anëtarët ekipit ka pyetsorët (ose nëse çdo person ka një pjesë prej tyre, por sigurohuni që ti keni të gjithë pyetsorët me vete)
 - nëse i keni marrë nga prindërit Format e Pëlqimit (në rast se janë mbledhur nga shkolla)
- 2.5. Mos diskutoni asnjëherë çështje që lidhen me kërkimin apo për të dhënat e mbledhura ndërkohë që, mund të jeni në një ambient publik ose gjatë udhëtimit me transport publik apo taksi.
- 2.6. Pas mbarimit të mbledhjes së të dhënave në të gjitha shkollat, duhet sa më shpejt të ktheni të gjithë pyetsorët tuaj në një vend të sigurt (në hotelin ku po rrini nëse jeni larg zyrës tuaj ose në zyrë) ku ju duhet, së bashku me bashkëpunëtorët tuaj, të kontrolloni dhe klasifikoni pyetsorët sipas klasave, si dhe të plotësoni një formular

të Raportimit (Aneksi 2a) për çdo klasë prej të cilave ju keni mbledhur të dhëna. Më konkretisht, ju duhet të: kontrolloni plotësimin e pyetsorëve në mënyrë që të mund të identifikoni ndonjë çështje problematike gjatë kohës që jeni në vendin ku u zhvillua procesi, Shënime nga Pyetosorët e Formës së Raportimit (Aneksi 2a) (duke u siguruar që po raportoni numrin e subjektit atë ku duhet) me qëllim që ti diskutoni dhe raportoni ato të dhëna më vonë, në takimin me Koordinatorin Lokal.

- Në rast se ju identifikoni pyetsorë që duken haptas që janë të pavlefshëm (P.sh. një fëmijë duket qartë që e ka plotësuar atë duke u tallur, për shaka) ju duhet të regjistroni Numrin e tyre Të Subjektit.
- plotëso pjesët e mbetura të formularit të raportimit (Aneksi 2a) që janë të lidhura me ICAST-CH. Vëmendje e veçantë duhet në përfundimin e pjesës së fundit, ku ju duhet të nxirrni në pah rastet që është zbuluar abuzimi (s) (bëhet ose nëpërmjet pyetësorëve ose personalisht)
- klasifiko pyetsorët siaps shkollës dhe klasës dhe ruaji ato në një vend të sigurt derisa të mbliidhni dhe pyetsorët e prindërve të këtyre fëmijëve.
- mbliidhni çdo pyetsor bosh - ICAST CH në mënyrë që t'ia jepni ato Koordinatorit Lokal (ju duhet të raportoni për çdo klasë, për arsyen pse ato pyetsorë mbeten bosh, p.sh. refuzimin apo tërheqjen e fëmijës/ve, fëmijët që munguan atë ditë të veçantë ose fëmijët që kanë braktisur shkollën)
- merrni pjesë aktive në Takimin e Supervizimit me Koordinatorin Lokal

2.7. Takimi i parë supervizues. Prezenca juaj në të gjitha takimet është E DETYRUESHME, ku ju duhet të:

2.8. raportoni kursin e procesit ose ndonjë problem që mund të keni ndeshur gjatë mbledhjes së të dhënave të pyetsorit

2.9. raportoni ndonjë koefidencë që ju është bërë apo ndonjë rast të dyshimtë të abuzimit të fëmijës, i cili do të diskutohet dhe më pas po aty do të merret vendimi se si do të procedohet me rastin

2.10. dorëzoni ndonjë pyetsor bosh që mund të keni dhe raportoni arsyen përse ka mbetur pa plotësuar në mënyrë që të regjistrohet

- merrni studimin dhe materialet mbështetëse që ju duhen për ditën pasardhëse që do të organizoni mbledhjen e të dhënave në shkollë (Hapi 1.1 – 1.4) por edhe mënyrën e mbledhjes së të dhënave të prindërve nga dita e mëparshme gjithashtu
- në rast se mbledhja e të dhënave të ICAST-P është marrë përsipër nga një tjetër kërkues jashtë ekipit të atyre që ishin në klasë, ai/ajo duhet të pajiset me një listë që përfshin Numrat e Subjekteve që ai/ajo duhet të mbledhë nga çdo klasë; kjo do ta lehtësonte atë për të organizuar një plan alternativ të shpërndarjes së pyetsorëve të atyre prindërve, që për ndonjë arsye nuk e kanë dërguar pyetsorin

e plotësuar në ditën e caktuar por që dëshirojnë ta dërgojnë atë (p.sh. ai/ajo mund krijojë mundësinë e dërgimit me postë ose të marrë kontaktin e prindërve për qëllime të studimit dhe të komunikojë direkt me to)

2.11. Ditën e mëpasme të mbledhjes së pyetsorëve ju duhet:

2.12. Merrni pyetsorët e plotësuar të prindërve (si nëpërmjet fëmijëve në shkollë apo prej bashkëpunëtorit të caktuar për këtë qëllim – në varësi të përcaktimeve të bëra për hapin 3.4)

2.13. Kontakti (nëse keni marrë detaje kontakti) prindërit pyetsorët e të cilëve nuk janë kthyer në kohë për të zbuluar qëllimin e tyre për ta përfunduar atë dhe për të bërë marrëveshje të reja për shpërndarjen e pyetsorit, ju mund të keni nevojë për të organizuar një vizitë në shtëpi ose diku tjetër (me qëllim që të kryeni një intervistë me një prind ose thjesht për të marrë pyetësorin e tij / saj të përfunduar).

2.14. bashkoni pyetsorin (ICAST-CH) e çdo fëmije që e keni klasifikuar sipas klasës dhe shkollës me pyetsorin e prindit të tij/saj (ICAST-P).

2.15. kontrollini pyetësorët e përfunduar ICAST-P, në mënyrë që të identifikoni ndonjë pikë problematike të cilat ju duhet ti regjistroni në formularin përkatës të Raportimit (Aneksi 2a). Ju duhet të regjistroni gjithashtu edhe Numrin e Subjektit të ndonjë pyetësori që duket të jetë i pavlefshëm (p.sh. shumë pak pyetje kanë marrë përgjigje).

2.16. regjistroni Numrin e Subjektit të ICAST-P që nuk është kthyer dhe ndonjë koment që mund të keni për atë rast (p.sh. nëse e dini arsyen e refuzimit ose nëse keni pasur komunikim me prindërit dhe rezultatet).

2.17. ruajini pyetsorët në një vend të sigurt nëse për ndonjë klasë po prisni më shumë pyetsorë prindërisht që do t'ju dorëzohen (nëse e konsideroni se është përfunduar ky proces, çojini ato tek Koordinatori Lokal në takimin e radhës).

2.18. mbledhni pyetsorët e paplotësuar ICAST-P me qëllim që t'ia jepni ato Koordinatorit Lokal (ju gjithashtu duhet të raportoni nëse në dijeninë tuaj ka pasur ndonjë arsye pse ato kanë mbetur të paplotësuar (p.sh. të refuzuara apo ndonjë arsye që ju është raportuar dhe juve).

2.19. plotësoni vendet e mbetura pa plotësuar të Formës së Raportimit (Aneks 2a) që i korrespondojnë ICAST-P.

3. Takimi Supervizimit: Në takimin e 2-të dhe në çdo takim të ardhshëm:

- 3.1. hapat 3.1-3.4 përsëriten për pyetsorin e ri ICAST-CH por edhe për pyetsorin ICAST-P që është plotësuar nga prindërit e fëmijëve të një rradhe më parë
- 3.2. për çdo klasë që shpërndarja e pyetsorit ICAST-P është përfunduar, pyetsorët e plotësuar të fëmijëve dhe të prindërve i dorëzohen Koordinatorit së bashku me raportin korrespondues; sigurohuni që të shpërndani një paketë për klasë, përfshirë të gjithë pyetsorët ICAST-CH dhe –P dhe raportin për atë klasë dhe që është përdorur etiketimi i duhur për çdo klasë, pra të mos përzihen paketat e klasave me njëra-tjetrën.

Zgjatja e një “dite tipike kërkimi” është goxha më e shkurtër se sa kur mbledhja e të dhënave realizohet **me intervista të strukturuara**, meqënëse të dhënat duhet të plotësohen nga fëmijët dhe prindërit dhe të mblidhen në të njëjtën kohë; kjo do të thotë se kontrolli i cilësisë, raportimi dhe shpërndarja e pyetsorëve mund të bëhet në takimin e Supervizimit që do të mbahet në të njëjtën ditë me mbledhjen e të dhënave. Të gjitha të dhënat e mëparshme dhe mëpasme, detyrimet dhe hapat që duhet të ndiqen janë të njëjta me ato që janë përshkruar më lart.

A.3. Materialet e nevojshme gjatë Mbledhjet së të Dhënave

Para se të shkoni në terren për të mbledhur të dhënat, çdo çift kërkuesish duhet të ketë me vete materialet e nevojshme që i duhen për atë ditë; ju lutem kontrolloni dhe sigurohuni që ju jeni pajisur me të gjitha materialet që listohen më poshtë në Tabelën 1a dhe 1b.

Tabela 1a. Lista e materialeve për kërkuesit

RREGULLIMI I MBLEDHJES SË TË DHËNAVE NË SHKOLLË (PYETSORËT VETËPLOTËSUES)	
1	Axhenda e takimeve të mia në shkollë (data dhe koha), adresa e shkollës dhe të dhënat për kampinonin
2	Një hartë e zonës që do të vizitohet dhe detajet e kontakteve për çdo shkollë
3	Letër zyrtare verifikimi /Marrëveshja zyrtare
4	Stilolapsa (të paktën dy copë)
5	Një pako materiale sh për klasë përmban:
6	Kopje të ICAST-CH të çiftuara me
7	Zarfet e prindërve
8	Letër falenderuese për nxënësit
9	Zarf të madh/kuti
“Materialet demonstruese”	
10	Flipchart me mbajtësen përkatëse
11	Shirit Ngjites
12	Zarfin ilustrues të prindërve
13	Një kartë me shërbimet lokale (burimet e ndihmës në zonën specifike që vizitohet)
14	Një kartë me numrat e nevojshëm të telefonit
15	Telefonin celular (të aktivizuar por në opsionin “pa zë”)
16	Format e mia të Raportimit (Aneks 2a)
17	Kopja ime “Udhëzimet për Kerkuesit”

Table 1b. Lista e materialeve për Intervistuesit

MBLEDHJA E TË DHËNAVE NË MJEDISIN E TË ANKETUARVE (INTERVISTAT E STRUKTURUARA)		
1	Axhenda me takimet e mia (kontaktet, detaje për intervistën)	
2	Një hartë e zonës që do të vizitohet	
3	Marrëveshja zyrtare	
4	Striolapsa (te paktën dy)	
	1st Kërkuesi (prind)	2nd Kërkuesi (Fëmijë)
5	Informacion dhe letra e falenderimit	Letra informuese + forma e pëlqimit
6	Forma e pranimit me informacionin	të fëmijës
7	përkatës	ICAST-CH
8	ICAST-P	Letra falenderuese
	Karta intervistuese për prindërit	Kartat intervistuese për fëmijën
9	Një kartë me shërbimet lokale (burimet e ndihmës në zonën specifike që vizitohet)	
10	Një kartë me numra telefoni të nevojshëm	
11	Telefonin celular (I aktivizuar por në opsionin “pa zë”)	
12	Forma e Raportimit (Aneks 2b)	
13	Kopja e “Udhëzimeve për Kërkuesit”	

KAPITULLI B. ZHVILLIMI I STUDIMIT

Para se të shkohet në terren për të mbledhur të dhënat, duhet kontrolluar me shumë kujdes **plotësimi i saktë i Kodit të Numrit të Subjektit** (kod identik për çdo çift të pyetësorëve të fëmijëve dhe prindërve). Nëse pyetësorët që përdoren për një fëmijë dhe prindin e tij/saj nuk kanë të njëjtin kod, atëherë do jetë e pamundur që të identifikohen dhe të dy pyetësorët (dhe ai i fëmijës dhe ai i prindit) nuk do përdoren në analizimin e të dhënave. Për këtë arsye plotësimi i pyetësorëve me kodet përkatëse duhet të kryhet para se të zhvillohet mbledhja e të dhënave. Gjithashtu duhet pasur shumë kujdes që studentëve t'ju jepet pyetësori për prindin që ka kodin e duhur.

Gjithashtu ju duhet thënë pjesëmarrësve të studimit në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të përsëritur që **të japin përgjigje të sinqerta në pyetësor**. Mbledhja e informacionit të pavërtetë është humbje kohe dhe energjish njerëzore dhe për më tepër shtrembëron rezultatet e studimit. Pjesëmarrësve ju duhet theksuar gjithashtu dhe fakti që janë të lirë të mos u përgjigjen pyetjeve që nuk duan t'ju përgjigjen, si dhe fakti që nuk ka përgjigje të pasakta dh çfarë na intereson të dimë është eksperiencia apo opinioni i tyre personal. Në këtë mënyrë, ne i inkurajojmë pjesëmarrësit të përgjigjen në mënyrë të sinqertë.

B.1. Pyetësorët që do të plotësohen nga vetë pjesëmarrësit

Pyetësorët do t'ju administrohen fëmijëve në grupe në të njëjtën kohë në të njëjtën klasë. Duhet bërë kujdes që pyetësorët dhe përgjigjet e fëmijëve të mbeten anonime. Hapat që duhet të ndiqni janë:

- ▶ **Hapi 1:** Informoni fëmijët mbi studimin dhe jepuni Fletën e Informacionit për Prindin dhe Fletën e Pëlqimit për pjesëmarrjen e fëmijës në studim. Ky hap mund të kryhet nga shkolla ose nga ju personalisht.
- ▶ **Hapi 2** (mbas një kohe të parapërcaktuar, p.sh. 1-3 ditë): Mbledhja e formave të pëlqimit¹¹ → identifikimi i numrit të refuzimeve → shpërndarja e pyetësorëve tek fëmijët që kanë marrë pëlqim nga prindërit (pëlqim aktiv ose pasiv)¹² si dhe zarfet me pyetësorët e prindërve (të cilët duhet të jenë të pajisur me të njëjtin kod të pyetësorit të fëmijës), së bashku me fletën e informacionit përkatës dhe fletën e pëlqimi → mbledhja e të dhënave.
- ▶ **Hapi 3** (të nesërmen): Mbledhja e pyetësorëve të prindërve. Kjo mund të bëhet në dy mënyra:
 - ju (nëse është e mundur, të njëjtën studiues që mbledhën të dhënat me fëmijët në klasë) do të shkoni përsëri në shkollë të nesërmen për të mbledhur zarfin me pyetësorët që kanë plotësuar prindërit dhe që jua kanë dhënë fëmijëve për t'i sjellë në shkollë. Është e mundur që të nevojitet dhe një vizitë e dytë pasi disa fëmijë ose prindër mund ta kenë harruar pyetësorin në shtëpi.

¹¹ Duke qënë se do përdorim Pëlqim Pasiv, nëse prindërit nuk na kthejnë përgjigje brenda kohës së përcaktuar, ne do e konsiderojmë mungesën e përgjigjes sikur prindërit nuk kanë kundërshtim që fëmijët e tyre të marrin pjesë në studim.

¹² Në rast se ka refuzime nga prindërit, ju duhet të identifikoni cilët janë fëmijët përkatës të cilëve nuk do ju jepet pyetësori por një aktivitet tjetër i parapërcaktuar.

- Ju mund të shkoni dhe në shtëpitë e fëmijëve për të mbledhur pyetësorët nëse prindrit duan që të veprohet kështu.

B.1.1. Udhëzime mbi Plotësimin e Pyetësorëve

Personat e vetëm që duhet të jenë present në klasë gjatë mbledhjes së të dhënave janë dy studiuesit dhe askush tjetër, as mësuesit dhe as drejtori i shkollës. Duhet të jeni shumë të vendosur që mësuesit të mos jenë present në klasë gjatë këtij procesi, gjë që duhet bërë sigurisht me shumë edukatë..

Ditën e përcaktuar për mbledhjen e të dhënave you duhet të arrini në shkollë, a) para orarit të përcaktuar, b) me gjithë materialet që nevojiten. Fillimisht **duhet të shkoni tek zyra e drejtorit** që të bini dakort për çështjet e ditës dhe më pas do shoqëroheni tek klasat ku do mbliidhni të dhënat.

Hapi 1: Do prezantoni studimin dhe do ftoni nxënësit të marrin pjesë në të a) pa i shtyrë me forë, b) por gjithashtu dhe pa e theksuar shumë mundësinë që mund të mos marrin pjesë. Para se t'ju shpërndani pyetësorët nxënësve duhet të këni mësuar përmendsh paragrafin e mëposhtëm, të cilin duhet ta thoni fjalë për fjalë por jot a lexoni:

Mirëmëngjes; emri im është _____ dhe ky/kjo është kolegu/ja im/e _____; ne vijmë nga organizata CRCRA me qendër në Tiranë. Ne kemi ardhur sot tek ju pasi po zhvillojmë një studim me nxënës të moshës tuaj mbi faktorët që ndikojnë në jetën e fëmijëve dhe në mirëqënien e tyre fizike dhe emocionale. Ky studim po kryhet me nxënës nga gjithë Shqipëria si dhe nga 8 vende të tjera të Ballkanit. Prandaj, ne jemi këtu sot që t'ju bëjmë disa pyetje mbi gjëra të ndryshme që njerëzit nganjëherë ju bëjnë fëmijëve dhe adoleshentëve. gjëra të cilat mund t'i mërzisin ose lëndojnë fëmijët dhe adoleshentët.

Hapi 2: shpjegoni se çfarë ka në zarfin që fëmijët do ju çojnë prindërve dhe se çfarë duhet të bëjnë prindërit (gjithashtu do përdorni një zarf për të demonstruar përmbajtjen e tij).

Pas pak ne do ju japim pyetësorin tuaj si dhe një zarf të mbyllur që duhet t'ja jepni sot njërit nga prindërve tuaj ose një personi që kujdeset për ju në familje. Zarfi ka brenda një letër me informacion mbi studimin, një letër tjetër që duhet ta plotësojë prindi dhe një pyetësor që duhet ta plotësojë prindi. Mbasi prindi të ketë plotësuar letrën dhe pyetësorin do jua japë prapë juve që ta merrni me vete në shkollë ku do vimë ne ta marrim.

** Pyetësori nuk duhet shpërndarë derisa të keni mbaruar së dhëni udhëzimet pasi nxënësit mund të fillojnë ta plotësojnë dhe të shpërqëndrohen dhe nuk i dëgjojnë udhëzimet.*

Hapi 3: shpjegoni sesi nxënësit duhet të plotësojnë pyetësorët duke përdorur flipchartin për ilustrim. Shpjegimi i plotësimin të pyetësorëve është mirë të bëhet nëpërmjet ilustrim me një flipchart të përgatitur më parë, i cili mund të vendoset në tabelën e zez ose të ngjitet në mur. Flipcharti do përmbajë strukturën e mënyrës së përgjigjes dhe një shembull të një pyetjeje të plotësuar. (shikoni Figurën 1).

Ky pyetësor që duhet të plotësoni **nuk është provim**. Nuk ka **përgjigje të sakta apo të pasakta**.

Përpiquni t'ju përgjigjeni pyetjeve sa më mirë që të keni mundësi.

Tani do ju shpjegoj sesi ta plotësoni pyetësorin: shumë nga pyetjet pyesin nëse dikush nga familja që jeton me ju ka bërë diçka; psh nëse dikush ju ka shpjeguar pse një sjellje e caktuar është gabim. Nëse kjo gjë nuk ju ka ndodhur **asnjëherë**, atëherë vendosni një kryq në këtë kuti. Nëse ju ka ndodhur, atëherë vendosni një kryq në një nga kutitë blu. Nëse ju ka ndodhur **gjatë vitit të fundit (dmth gjatë 12 muajve të fundit)** vendosni një kryq **në një nga këto kutitë** ku tregohet sa herë ju ka ndodhur kjo gjë.

Kjo kuti nëse ka ndodhur një ~~ose dy~~ herë në vit

- Kjo kuti nëse ka ndodhur 3-5 herë, domethënë disa herë në vit
- Kjo kuti nëse ka ndodhur 6-12 herë, domethënë një ose dy herë në muaj
- Kjo kuti nëse ka ndodhur 13-50 herë, domethënë disa herë në muaj
- Kjo kuti nëse ka ndodhur më shumë se 50 herë, domethënë një herë më vonë ose më shpesh.

Nëse një gjë e tillë ju ka ndodhur **para vitit të kaluar** atëherë shënoni **këtë kuti**. Nëse nuk doni t'i përgjigjeni ndonjë pyetjeje, atëherë shënoni këtë kuti.

Gjatë vitit të fundit (12 muajt e fundit)					Jo gjatë vitit të fundit po ka ndodhur më parë	Asnjëherë	Nuk dëshiroj të përgjigjem
1-2	3-5	6-12	13-50	më shumë se 50			
Një ose dy herë në vit	Disa herë në vit	Një ose dy herë në muaj	Disa herë në muaj	Një herë ose më shumë në javë			
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Dëshiron të thuash diçka më tepër?

Në këtë hapësirë këti mund të shkruani diçka në lidhje me epksperiencën tuaj. Ju lutemi te keni shumë kujdes që të shënoni që tek **tabela blu** të shënoni **vetëm nga një kutitë** për çdo pyetje. Nëse bëni një gabim, ju lutem fshijeni ose shkarraviteni dhe shënoni përgjigjen e saktë. Po të doni mund dhe të rrethoni përgjigjen tuaj të saktë që ne ta marrim vesh se cila është.

Nëse nuk shënoni asnjë nga kutitë te tabela blu atëherë vazhdoni tek pyetja tjetër me tabelë blu. Por nëse shënoni një nga kutitë blu, domethënë që tregoni që diçka ju ka ndodhur, atëherë duhet të plotësoni dhe tabelën portokalli. Kjo tabelë tregon se kush ju a ka bërë këtë gjë:

- Një i rritur mashkull
- Një e rritur femër
- Një fëmijë/adoleshent mashkull
- Një fëmijë/adoleshente femër?

Këtu po të doni mund të shënoni më shumë se një kuti, psh nëse kjo gjë të është bërë dhe nga një i rritur mashkull dhe nga një fëmijë femër. Dhe këtu ka një hapësirë në fund ku mund të shkruani më shumë për çfarë ju ka ndodhur.

Nëse PO, ka qënë një		(shëno të gjitha rastet e mundshme)	
I rritur mashkull	E rritur femër	Fëmijë/adoleshent mashkull	Fëmijë/adoleshente femër
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

Dëshiron të thuash diçka më tepër?

Këtu ka dhe disa pyetje, që nëse diçka të ka ndodhur, mund të shënoni cila është lidhja e tyre me ty, domethënë sa mirë e njeh këtë person (**është i/e panjohur, i njohur apo i afërm i juaji?**).

Gjatë vitit të fundit (12 muajve të fundit)					Jo gjatë vitit të fundit por më ka ndodhur më parë	Asnjëherë	Nuk dëshiroj të përgjigjem
1-2	3-5	6-12	13-50	Më shumë se 50			
Një ose dy herë në vit	Disa herë në vit	Një ose dy herë në muaj	Disa herë në muaj	Një ose më shumë herë në javë			
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Nëse PO, ka qënë një:

(shëno të gjitha rastet e mundshme)

I rritur mashkull		E rritur femër			Fëmijë/adoleshent mashkull			Fëmijë/adoleshent femër			
<input type="radio"/>		<input type="radio"/>			<input type="radio"/>			<input type="radio"/>			
Cila është lidhja e tij me ty?		Cila është lidhja e saj me ty?			Cila është lidhja e tij me ty?			Cila është lidhja e saj me ty?			
Person i panjohur	Person i njohur	I afërm	Person i panjohur	Person i njohur	E afërme	Person i panjohur	Person i njohur	I afërm	Person i panjohur	Person i njohur	E afërme
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

Dëshiron të thuash diçka më tepër?

Kini parasysh që të shënoni përgjigjet që tregojnë më mirë eksperiencat apo opinionet tuaja. Ju lutemi të lexoni me kujdes udhëzimet për çdo pyetje **dhe të mos lini asnjë pyetje pa plotësuar**. Mbasi keni mbaruar një faqe kaloni tek faqja tjetër dhe kështu me rradhë deri në fund të pyetësorit.

Përgjigjet tuaja janë anonime që do të thotë se emri juaj nuk duhet shkruar në asnjë vend në pyetësor. Pra ju lutemi të **mos e shkruani emrin tuaj në asnjë vend në pyetësor**. Përgjigjet tuaja nuk do t'i marrë vesh askush – as mësuesit, prindërit, shokët apo dikush tjetër. E vetmja mënyrë që mund t'i marrim vesh përgjigjet tuaja është nëse ju doni ta na i tregoni. Askush, as ne vetë, nuk kemi nga ta dimë sesi do përgjigjeni pasi mbasi të keni mbaruar do vendosni pyetësorin në këtë zarf (kuti) të madhe, bashkë me pyetësorët e nxënësve të tjerë. Dua t'ju kujtoj që nuk ka përgjigje të sakta apo të pasakta. Ne jemi shumë të interesuar që të mësojmë opinionet dhe eksperiencat tuaja personale, kështu që mos flisni me njëri-tjetrin dhe përgjigjuni pyetjeve me sinqeritet.

Hapi 4: shpërndajuni nxënësve që kanë pëlqim nga prindërit, a) pyetësorin e tyre së bashku me formën e pëlqimit për fëmijët (bashkangjitur faqes së parë të pyetësorit) dhe b) zarfin e mbyllir për prindërit) **(duke ushtruar kujdes maksimal që kodet e pyetësorëve të mos ngatërrohen)**¹³. Në klasat që kanë pak nxënës mund t'ja jepni zarfet në fund kur të dorëzojnë pyetësorin e plotësuar *së bashku me letrën e falenderimit për fëmijët). Në këtë rast, udhëzimet e mëposhtme duhen modifikuar siç duhet.

Tani do ju shpërndajmë pyetësorin tuaj së bashku me zarfin e mbyllur që duhet t'ja jepni sot një nga prindërve tuaj, ose një personi tjetër të rritur që kujdeset për ju. Mos harroni t'ja jepni zarfin prindit sa të shkoni në shtëpi pasi prindi duhet ta plotësojë dhe t'ju japë që ta merrni me vete në shkollë nesër. Nesër ne do vimë në shkollë që t'i mbledhim zarfet.

Tek pyetësori juaj, lexoni me vëmendje faqen e parë, e cila ju jep informacion mbi studimin dhe shënimi me kryq kutinë e duhur në fund të faqes. Nëse nuk doni t'ju përgjigjeni pyetjeve të pyetësorit, jeni të lirë të mos i plotësoni, por ne urojmë shumë që ju t'i plotësoni. Nëse keni pyetje, ngrini dorën dhe një nga ne do vijë t'ju ndihmojë. Kur të mbaroni, ngrini dorën dhe ne do vimë të marrim pyetësorin.

Ju lutemi mos i diskutoni përgjigjet tuaja me nxënësit e tjerë! Ne duam shumë të dimë mendimet dhe eksperiencat tuaja personale, kështu që ju lutem përgjigjuni VETË pyetjeve në pyetësor.

Hapi 5: Udhëzimet gjatë mbledhjes së të dhënave

- Jini të gatshëm që gjatë kohës që nxënësit plotësojnë pyetësorin **të jepni shpjegime**.
 - Afrohuni tek çdo fëmijë që do t'ju thërrasë po bëjeni të dukshme që nuk po shikoni përgjigjet e tyre.
 - Përgjigjuni vetëm me përgjigjet që janë shkruar në këtë manual. Për pyetjet që nuk janë në këtë manual, përgjigjuni vetëm me përgjigjet standarte **“përgjigju ashtu siç e kupton ti”** ose **“përgjigju siç e mendon ti që është më mirë”**
- **Mos i lejoni nxënësit të flasin me njëri-tjetrin.** Bëjeni këtë gjë me edukatë.
- **Mblidhni** pyetësorët e plotësuar në një zarf të madh ose kuti.
- **Jepjuni** nxënësve **letrën falenderuese** dhe ftojini (nëse kanë pyetje ose kërkesa) që a) t'ju telefonojnë në numrin që është tek fleta e falenderimit, ose b) të flasin me ju mbas përfundimit të punës në klasë (por kjo gjë duhet bërë vetëm nëse planifikoni të jeni aty për ca kohë pas përfundimit).

Hapi 6: mbasi të keni mbledhur pyetësorët e plotësuar jepuni nxënësve letrën falenderuese.

¹³ **KUJDES:** duhet pasur parasysh që dhe pyetësori i fëmijës dhe i prindit duhet të jenë të pajisur me **të njëjtin kod** (mund ta shkruani kodin mbi zarfin ku do futet pyetësori për prindërit). Shpërndajuni nxënësve pyetësorët e tyre së bashku me zarfet përkatës në të njëjtën kohë.

*Shumë faleminderit për ndihmën që na dhatë <jepuni letrën falenderuese >. Kjo letër ka informacion mbi kë të kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje mbi studimin ose nëse doni të flisni më tej për diçka që ju ka ndodhur ju ose dikujt që ju njihni. Ju lutemi të **mos harroni t'i jepni zarfin prindit dhe mbasi prindi ta ketë plotësuar ta sillni me vete në shkollë nesër. Shumë faleminderit!***

Mbledhja e të dhënave nga prindërit: ju duhet te mblidhni gjithashtu pyetësorët që do plotësojnë prindërit. Pra, ju duhet të shkoni në shkollë të nesërmen dhe të mblidhni zarfat që kanë sjellë nxënësit (më e mira është të shkojnë të njëjtët studiues të një dite më parë). Mund të jetë e nevojshme që të shkohet prapë në shkollë apo të kontaktohet prindi në një mënyrë tjetër që të mbledhim dhe pyetësorët që nxënësit mund të kenë harruar t'i marrin me vete. Një mënyrë tjetër është që nëse prindërit kërkojnë t;ju takojnë, atëherë mund të lini një takim me ta. Në këtë rast mund të shikoni (nëse është e mundur) nëse e kanë plotësuar pyetësorin siç duhet. Nëse prindërit duan, atëherë mund ta plotësoni pyetësorin me ta nëpërmjet intervistës.

B.2. Intervistat e strukturuar

B.2.1. Udhëzime praktike për studiuesit

Të gjithë studiuesit duhet të ndjekin të njëjtën procedurë dhe të zbatojnë udhëzimet e mëposhtme (sipas ISPCAN, 2006b, faqe 9-10):

Si intervistues **DUHET** që të:

- **Lexoni** udhëzimet dhe pyetjet:
 - **Ekzaktësisht siç janë shkruar** në pyetësor
 - **Ndiqni sekuencën e pyetjeve në pyetësor** (duke pasur parasysh pyetjet filtër)
 - **Mos lini pa lexuar asnjë pyetje** (përveç pyetjeve filtër që nuk duhen)
- **Flisni ngadalë dhe qartë**
- **Përsërisni** të njëjtën pyetje sa herë të jetë e nevojshme apo sa herë t'ju kërkojë i intervistuari
- Ndërtoni marrëdhënie personale me të intervistuarin
 - Uluni **përballë** me të, nëse është e mundur
 - Vendosni kontaktin e duhur me sy
 - Shikojeni atë në sy shpesh (por jo aq shpesh sa ta bëni të ndihet në siklet)
 - Përdorni emrin e të intervistuarit sa herë që të mundeni
 - Përdorni ermene fëmijës gjatë intervistës me prindin, pasi kështu jo vetëm vendosni raport por gjithashtu i kujtoni një prindi me disa fëmijë që për cilin nga ata po përgjigjet.
- Ndiqni procedurën e vendosur më lart për të marrë formën e pëlqimit nga prindi (për vetne dhe fëmijën) si dhe formën e pëlqimit që e plotëson vetë fëmija.
- Regjistroni në formë të shkruar një përgjigje për çdo pyetje (përveç pyetjeve që nuk i bëhen të intervistuarit)
- Në fund të intervistës sigurohuni që nuk keni anashkaluar asnjë pyetje; çdo pyetje duhet të ketë një përgjigje,
- Nëse i intervistuari ankohet që pyetjet janë të ngjashme me njëra-tjetrën, atëherë mund të thoni: *“ke të drjetë, duket sikur pyetjet janë të ngjashme me njëra-tjetrën, por, në fakt, nuk janë identike”*. Nëse i intervistuari këmbëngul që pyetjet janë identike, thoni: *“ ndoshta duken sikur janë identike, por mua më duhet që të ti bëj të gjitha pyetjet, kështu të lutem m'u përgjigj përsëri”*.
- Nëse i intervistuari jep te njëjtën përgjigje për disa pyetje njëra pas tjetrës, ndaloni dhe thoni: *“ a je i sigurtë që do të japësh të njëjtën përgjigje për këto <numri i pyetjeve> pyetje?”*
- Shënoni opsionin **“Nuk dëshiroj të përgjigjem”** vetëm kur i intervistuari jua thotë qartë që nuk dëshiron të përgjigjet.
- Kur nuk ka mundësi për të shënuar opsionin **“Nuk e di”**, **përpiquni të shmangni** një përgjigje të tipit *Nuk e di* duke i thënë të intervistuarit *“të lutem më thuaj si e mendon ti ose Më jep përgjigjen që e mendon ti se është më e saktë”*

Si intervistues **NUK DUHET** që të:

- **Nuk duhet që të** përpiqeni të shpjegoni apo perifrasoni një pyetje apo fjalë
 - Vetëm në manual ka një shpjegim apo perifrachim për pyetjen/fjalën, mund t'i përdorni ato
 - Nëse manuali nuk i ka këto të fundit, thojini të intervistuarit: *“Më vjen keq po nuk e ndryshoj dot formulimin e pyetjes. Përgjigju ashtu siç e kupton ti”*
 - Mbani shënim të gjitha pyetjet dhe komentet e të intervistuarit (mbasi të keni mbaruar intervistën)
- **Nuk duhet që të lexoni:**
 - **Pyetjet** në ngjyrë portokalli kur i intervistuari i është përgjigjur me JO pyetjes së mëparshme (psh nëse një prind i përgjigjet “JO” pyetjes 6, atëherë kalojeni pyetjen 7 dhe mos e pyesni për të)
 - Pyetjet që mund t'i vendosni vetë nëpërmjet **një kodi të heshtur**, pra pyetjet për të cilat përgjigja është e qartë (psh gjinia e prindit apo fëmijës që po intervistoni).
- **Nuk duhet që të plotësoni asnjë nga pyetjet vetë duke menduar që e dini përgjigjen**, pavarësisht se sa të sigurtë jeni për këtë gjë (përfashtim bëjnë vetëm pyetjet me “kod të heshtur”). Nëse, për shembull, një i intervistuar gjatë përgjigjes së një pyetjeje ka dhënë përgjigje dhe për një pyetje pasardhëse, ju përsëri do e bëni këtë pyetje pasardhëse dhe do prisni për të intervistuarin që të përgjigjet. Ju mund të përdorni këtë fjali si një hyrje për pyetjen dhe që të tregoni se ju po kushtoni vëmendje përgjigjeve të të intervistuarit: *“Ne folëm pak më parë për këtë gjë/ju përmëndët diçka më parë në lidhje me këtë çështje dhe tani kam një pyetje në lidhje me të”*. Lexojeni pyetjen fjalë për fjalë, në mënyrë që t'i jepni mundësinë të intercistuarit të japë përgjigjen e tij – mos supozoni se e dini se cila do jetë përgjigja që do japë.
- **Nuk duhet që të shprehni** nëse jeni dakort ose jo (ose aprovim apo kundërshtim) qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të nënkuptuar, me përgjigjen e të intervistuarit, dhe nëse i intervistuari jua kërkon këtë gjë.
- **Nuk duhet që të humbisni** vetë-kontrollin, neutralitetin dhe qëndrimin tuaj mos-gjykues (pavarësisht nga çfarë po dëgjoni). Reagimi juaj emocional mundet që të ndikojë mbi mënyrën sesi do përgjigjet i intervistuari.
- **Nuk duhet që të zhvillonit intervistën nëse:**
 - Nuk siguronit dot një dhomë private për çdo të intervistuar
 - Një person i tretë këmbëngul që të jetë i pranishëm
 - Kur dy kushtet e mësipërme nuk plotësohen, atëherë mund ta anuloni ose ta ndërprisni intervistën dhe thoni: *“Nëse tani është një kohë e papërshtatshme për ju, na thoni se kur mund të vijmë përsëri. Nëse është e vështirë që të jemi vetëm në shtëpinë tuaj, atëherë, po të doni, ne mund të gjejmë një vend tjetër ku mund të takohemi.”*

B.2.2. Udhëzuesi mbi intervistat me prindërit

Kur të shkoni në shtëpinë e dikujt, një studiues bën intervistën me prindin ndërsa studiuesi tjetër, në të njëjtën kohë, bën intervistën me fëmijën. Para se të fillojë intervista theksoni nevojën që intervistat duhen bërë në dy dhoma të veçanta dhe pa praninë e personave të tretë.

Vajtja në shtëpi [prezantimi juaj dhe i organizatës]

Mirëmëngjes/Mirëdita!

Emri im është <emri> dhe **unë punoj tek Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve me qendër në Tiranë**. Sot do zhvillojmë bashkë një intervistë. Ky është kolegu im <emri>, që do intervistojë <Emrin e fëmijës >.

Ku mund të rrimë që të bisedojmë vetëm pa u shqetësuar nga personat e tjerë të shtëpisë?

Hapi 1. Fillimi i intervistës [prezantimi i temës së studimit, informacion mbi konfidencialitetin dhe mundësinë për t'u tërhequr nga studimi]

Siç mund ta dini, ne po zhvillojmë një studim mbi marrëdhëniet prind fëmijë. I gjithë informacioni që do ndani me ne është konfidencial, që do të thotë që askush tjetër nuk do e marrë vesh se çfarë flasim sot, përveç rastit kur ju doni që ne t'i tregojmë dikujt tjetër në lidhje me të apo nëse ju na tregoni që jeta e dikujt është në rrezik.

Nuk ka përgjigje të sakta apo të gabuara për pyetjet që do ju bëjmë. Ne duam të dijmë vetëm mendimet, opinionet dhe eksperiencat tuaja në lidhje me çështjet që do flasim, kështu që ju lutemi të jeni sa më të sinqertë me ne.

Pjesëmarrja juaj në studim është plotësisht në dorën tuaj, pra po të doni mund të mos ju përgjigjeni pyetjeve ose mund të ndaloni intervistën në çdo moment që doni. Por uroj që ju të na ndihmoni dhe të përgjigjeni.

Hapi 2. Marrja e Pëlqimit [jepini prindit formën e pëlqimit]

*“Para se të fillojmë, ju lutemi **të lexoni dhe firmosni** këtë letër që tregon se ju na jepni leje që të bëjmë intervistën me ju dhe fëmijën tuaj”.*

Nëse prindi heziton të firmosë, atëherë mund t'i thoni:

“Siç ju thashë përgjigjet tuaja nuk do t'i marrë vesh askush;po të doni të mos firmosni atëherë jeni të lirë të mos firmosni, vetëm shënoni kutinë këtu që tregon se ju jepni pëlqimin tuaj për intervistën

Gjithashtu, dhe mbasi firmosni apo shënoni kutinë përsëri jeni të lirë që të s ju përgjigjeni pyetjeve që nuk doni apo të ndërprisni intervistën në çdo moment.”.

Nëse prindi **këmbëngul që të mos firmosë apo të shënojë kutinë** por është i gatshëm të japë intervistën, atëherë **mund ta shtyni procesin e marrjes së firmës apo shënimint të kutisë deri në fund të intervistës.**

Hapi 3. Mbledhja e të dhënave

Gjatë mbledhjes së të dhënave

1. **Mbajeni pyetësoarin** në dorë dhe **“lexojini pa i lexuar”** TË GJITHA pyetjet (sipas rradhës) [mos ja jepni pyetësoarin të intervistuarit]

2. Kur të jetë moment i duhur, jepini të intervistuarit **Kartën e duhur të Intervistës** (për ata të intervistuar që dinë të lexojnë) e cila i ndihmon prindërit të shohin mundësitë që kanë për t'u përgjigjur.
3. **Mos lexoni**
 - Pyetjet me **“kod të heshtur”** si “gjinia e prindit apo e fëmijës”
 - Pyetjet për të cilat i intervistuari nuk ka nevojë të përgjigjet (pyetjet me ngjyrë portokalli për të cilat i intervistuari ka thënë në pyetjen e mëparshme “Jo” ose “Nuk dëshiroj të përgjigjem”)
 - Pyetjet për të cilat një filtër (→ shkon tek pyetja X”) ju tregon ju që duhet ta kapërceni
4. **prisni përgjigjen me durim** [por “jo për gjithmonë”!]
5. **shënoni përgjigjen në formën më të plotë të mundshme** por shpejt (që të mos humbisni vëmendjen e të intervistuarit); në rastin e përgjigjeve të gjata bëni një shënim të vogël dhe pastaj plotësojeni menjëherë mbas intervistës.

Hapi 4. Mbyllja e Intervistës

Para se të mbyllni intervistën kontrolloni shpejt mos keni lënë ndonjë pyetje pa bërë. Asnjë pyetje nuk duhet lënë pa bërë, përveç atyre që sipas udhëzimeve nuk duhet t'i bëni. Falenderojeni prindin dhe thojini që po të dojë mund t'ju bëjë pyetje ose komente.

*“Shumë faleminderit për koëhn që na dhatë dhe për gatishmërinë që të ndanit me me ne mendimet dhe eksperiencat tuaja personale; ky informacion ka një vlerë të jashtëzakonshme për ne dhe do na ndihmojë që të zhvillojmë mënyra/strategji për të ndihmuar prindër dhe fëmijë të përmirësojnë marrëdhëniet e tyre.
A keni ndonjë pyetje apo koment për të bërë në lidhje me studimin apo çështje të tjera?”*

Mbasi t'i përgjigjeni pyetjeve që mund të ketë i intervistuari, jepini letrën falenderuese ku shpejgohet qartë sesi mund t'ju kontaktojë nëse ka nevojë për informacion apo ndihmë e mëtejshme.

Jini jashtëzakonisht të kujdesshëm që të mos jepni informacion të shkruar që mund të vërë në rrezik viktimën nëse ky informacion zbulohet nga abuzuesi.

Në rastet kur i intervistuari ju kërkon ndihmë të mëtejshme, duhet të ndiqni me rigorozitet procesin e përshkruar në kapitujt D8 dhe D9.

B.2.3. Udhëzuesi i intervistës me fëmijët

Mbasi jeni takuar me fëmijën, prezantoni studimin duke përdorur fjalitë e mëposhtme si guidë.

Hapi 1. Fillimi i intervistës [prezantimi i temës së studimit, informacion mbi konfidencialitetin dhe mundësinë për t'u tërhequr nga studimi]

Siç mund ta dish, ne duam shumë që të na ndihmosh me një studim që ne po bëjmë mbi marrëdhëniet e prind-fëmijë.

Askush nuk do e marrë vesh se për çfarë do diskutojmë ne sot; çdo gjë do mbetet mes nesh; përveçse në rastin kur ti vetë do që ne t'i themi diçka dikujt tjetër.

Je i lirë që po të duash mos t'u përgjigjesh pyetjeve dhe mund ta ndalosh intervistën në çdo moment që do dhe pa pasur nevojë të më thuash pse. Po unë shpresoj shumë që ti t'i përgjigjesh pyetjeve dhe të na ndihmosh me studimin!

Hapi 2. Marrja e pëlqimit nga fëmija [jepini fëmijës formën e pëlqimit të fëmijës]

<Emri i fëmijës> para se të fillojmë, të lutem lexoje këtë lëturë e cila ka të shkruar të njëjtat gjëra që të thashë me gojë. Pasi ta kesh lexuar shëno me kryq kutinë që do në fund të faqes.

Mbasi të këni marrë pëlqimin e fëmijës theksoni që:

Ki parasysh që nuk ka përgjigje të sakta apo të gabuara për pyetjet që unë do të të bëj.

Çka është e rëndësishme është të përgjigjesh sa më sinqerisht; sepse ne duam vetëm të dimë se çfarë mendon ti në lidhje me këto çështje si dhe çfarë të ka ndodhur ty vetë në jetë.

Hapi 3. Mbledhja e të dhënave

Gjatë mbledhjes së të dhënave

1. **Mbajeni pyetësonin** në dorë dhe "**lexojini pa i lexuar**" TË GJITHA pyetjet (sipas rradhës) [mos ja jepni fëmijës pyetësonin]
6. Kur të jetë moment i duhur, jepini fëmijës **Kartën e duhur të Intervistës** (për ata fëmijë që dinë të lexojnë) e cila i ndihmon fëmijët të shohin mundësitë që kanë për t'u përgjigjur.
7. **Mos lexoni**
 - Pyetjet me "**kod të heshtur**" si "gjinia e fëmijës"
 - Pyetjet për të cilat fëmija nuk ka nevojë të përgjigjet (pyetjet me ngjyrë portokalli për të cilat fëmijaka thënë në pyetjen e mëparshme "Jo" ose "Nuk dëshiroj të përgjigjem")
 - Pyetjet për të cilat një filtër (→ shkon tek pyetja X") ju tregon ju që duhet ta kapërceni

8. prisni përgjigjen me durim [por “jo për gjithmonë”!]
9. shënoni përgjigjen në formën më të plotë të mundshme por shpejt (që të mos humbisni vëmendjen e të intervistuarit); në rastin e përgjigjeve të gjata bëni një shënim të vogël dhe pastaj plotësojeni menjëherë mbas intervistës.

Hapi 4. Mbyllja e intervistës

Para se të mbyllni intervistën kontrolloni shpejt mos keni lënë ndonjë pyetje pa bërë. Asnjë pyetje nuk duhet lënë pa bërë, përveç atyre që sipas udhëzimeve nuk duhet t'i bëni. Falenderojeni fëmijën dhe thojini që po të dojë mund t'ju bëjë pyetje ose komente.

*“Shumë faleminderit për koëhn dhe ndihmën që na dhe mbi studimin. Ky informacion ka një vlerë të jashtëzakonshme për ne dhe do na ndihmojë që të zhvillojmë mënyra për të ndihmuar prindër dhe fëmijë të përmirësojnë marrëdhëniet e tyre.
A keni ndonjë pyetje apo koment për të bërë në lidhje me studimin apo çështje të tjera?”*

Mbasi t'i përgjigjeni pyetjeve që mund të ketë i intervistuari, jepini letrën falenderuese ku shpejgohet qartë sesi mund t'ju kontaktojë nëse ka nevojë për informacion apo ndihmë e mëtejshme.

Jini jashtëzakonisht të kujdesshëm që të mos jepni informacion të shkruar që mund të vërë në rrezik viktimën nëse ky informacion zbulohet nga abuzuesi.

Në rastet kur i intervistuari ju kërkon ndihmë të mëtejshme, duhet të ndiqni me rigorozitet procesin e përshkruar në kapitujt D8 dhe D9.

KAPITULLI C. MBAS PËRFUNDIMIT TË MBLEDHJES SË TË DHËNAVE

C.1. Kontrolli i cilësisë

Çdo studiues duhet të sigurohet mbas mbledhjes së të dhënave që çod pyetësor ICAST ka një kod unik që përkon me pyetësorin e prindit/fëmijës përkatës. Ju duhet të rishikoni pyetësorët dhe të siguroheni që nuk keni lënë të dhëna të paplotësuara apo të paqarta. Duhet gjithashtu t'i jepni Koordinatorit të gjithë pyetësorët e paplotësuar dhe ata bosh gjatë "mbledhjeve ditore". Koordinatorin do t'i kontrollojë dhe njëherë për të dhëna të paplotësuara apo të paqarta.

Ju duhet të shënoni të gjitha vëzhgimet tuaja për procesin e mbledhjes së të dhënave në Format e Raportimit Duhet të plotësoni nga një Formë Raportimi për çod klasë (Forma në Aneksin 2a) ose për çdo intervistë (Forma në Aneksin 2b). Këto forma janë shumë të rëndësishme për diskutime të tjera me Koordinatorin gjatë mbledhjeve ditore të supervizimit (për më tepër shikoni Kapitullin A3).

Pjesëmarrja në mbledhjet e supervizimit është e detyrueshme dhe gjithashtu duhet të raportoni gojarisht tek Koordinatorin:

- Të dhëna që mungojnë ose problem që mund të keni hasur gjatë mbledhjes së të dhënave
- Sqarime që mund t'ju keni kërkuar fëmijët dhe prindërit (si ato për të cilat keni pasur përgjigje të caktuara nga manuali dhe ato që nuk keni pasur)
- Raportoni raste të qarta ose të dyshuara abuzimi (në mënyrë që të diskutohet zgjidhja më e mirë për këto raste).

KAPITULLI D. ÇËSHTJE TË ETIKËS DHE TË SIGURISË

D.1. Privacy dhe Konfidencialiteti

Është shumë e rëndësishme të merren masa për ruajtjen e karakterit privat të intervistave dhe pyetësorëve si dhe për të siguruar konfidencialitetin e informacionit dhe të dhënave të marra nga pjesëmarrësit e studimit si gjatë mbledhjes së të dhënave dhe mbas saj.

Jini shumë të kujdesshëm që të mos diskutoni me kolegët tuaj në publik (psh gjatë rrugës nga shkolla në shkollë, në kafe apo restorant) asnjë lloj informacioni të marrë gjatë intervistave apo plotësimit të pyetësorëve.

Pyetësorët që do të plotësohen nga vetë fëmijët: duhet të siguroni që fëmijët të mos shikojnë përgjigjet e njëri-tjetrit

- ▶ Fëmijët që plotësojnë pyetësin në klasë nuk duhet të lejohen që të pyesin fëmijët e tjerë për përgjigjet e tyre apo të shikojnë përgjigjet e të tjerëve. Për të arritur këtë qëllim duhet ndaluar e folura mes fëmijëve dhe mundësisht fëmijët të ulen sa më larg njëri-tjetrit gjatë plotësimit të pyetësorit.
- ▶ Sigurohuni që gjatë kohës që fëmijët ju dorëzojnë pyetësin, të tjerët nuk mund të shikojnë përgjigjet e tyre. Për këtë arsye, pyetësorët e plotësuar duhet të mblidhen në zarfe të mëdha ose në kuti.

Gjithashtu, të gjitha përgjigjet në pyetësorë duhet të mbeten konfidenciale dhe duhet të siguroheni që pjesëmarrësit nuk e vendosin emrin e tyre në asnjë vend në pyetësor (anonimiteti).

Intervistat e Strukturuara: Në asnjë mënyrë nuk duhet që intervistat të zhvillohen në praninë e një personi të tretë; vetëm ju dhe pjesëmarrësi duhet të jeni të pranishëm gjatë intervistës (kjo për të rritur sinqeritetin e përgjigjeve si dhe për arsye sigurie); i vetmi përjashtim është rasti i një fëmije shumë të vogël që prindi nuk ka me kë e lë.

- ▶ **Nëse nuk e garantoni dot konfidencialitetin,** është më mirë të anuloni intervistën dhe ta vendosni një takim për një herë tjetër sesa të sakrifikoni privacinë.
- ▶ Në rastin kur **një person i tretë hyn** në dhomë gjatë kohës së intervistës, **ndërpriteni intervistën derisa ai/ajo të largohet nga dhoma.**
- ▶ Në rastin kur një person i tretë këmbëngul që të jëtë i pranishëm gjatë intervistës, ju duhet të refuzoni me edukatë duke thënë: ***“Na falni, por nuk lejohet që ju të qëndroni gjatë intervistës. Po nëse dhe ju dëshironi që ti përgjigjeni këtij pyetësori, ne mund të lëmë një takim tjetër me ju.”***

Megjithëse është e shkruar në letrën e informacionit për prindërit, është e rëndësishme që ju të informoni gojarisht të intervistuarin – fëmijë ose prind – para mbledhjes së të dhënave për **kufizimet e konfidencialitetit:** ***“... vetëm nëse jeta e dikujt është në rrezik ose nëse JU kërkoni që të flisni me dikë për një çështje që ju shqetëson.”*** Ky fakt i bën të qartë pjesëmarrësve që ju mund ta thyni konfidencialitetin e premtuar në këto raste të caktuara; jini shumë të kujdesshëm që t’ju përcillni këtë informacion në mënyrë të tillë që të mos tremben dhe mos të refuzojnë pjesëmarrjen në studim.

D.2. Fshehja e pjeshme e informacionit

Është vendosur që fshehja e pjeshme e informacionit mund të përdoret në kontekstin e studimit BECAN, sepse konsiderohet e justifikueshme dhe e nevojshme. Më konkretisht, është vendosur të lejohet fshehja e pjeshme e qëllimit të vërtetë të informacionit për të shmangur a) rastet kur pjesëmarrësit (si fëmijët dhe prindërit) mund të adoptojnë një qëndrim skeptik që mund të rezultojë në përgjigje jo të sinqerta (dhe jo të vlefshme), dhe b) rastet kur ushtruesit e dhunës mund të mos lelojnë fëmijët e tyre të marrin pjesë në një studim mbi abuzimin dhe keqtrajtimin.

Fshehja e pjeshme e informacionit, sidoqoftë **bën më të rëndësishëm detyrimin tonë** që:

- t'ju themi qartë pjesëmarrësve që kanë të drejtë të zgjedhin nëse duan të marrin pjesë në studim ose jo (shikoni kapitujt D.3 dhe D.4)
- t'ju bëjmë të qartë të gjithë pjesëmarrësve që në situata të veçanta mund të na duhet që të thyejmë rregullën e premtuar të konfidencialitetit (duhet të jeni jashtëzakonisht të kujdesshëm që këtë informacion ta jepni në një mënyrë sa më neutral që të mos trembim fëmijët dhe prindërit që të mos duan të marrin pjesë në studim).

Kjo fshehje e pjeshme e informacionit shton rëndësinë e **debriefing** të pjesëmarrësve, me qëllim largimin e ndonjë shqetësimi të mundshëm afatshkurtër apo afatgjatë që vjen si rrjedhojë e pjesëmarrjes në studim, ose dhe të pasojave të tjera negative (psh rrezik mbi sigurinë e tyre) si rezultat i pjesëmarrjes në studim (shikoni kapitullin D.5).

D.3. E drejta për të refuzuar pjesëmarrjen ose për t'u tërhequr nga studimi

Duhet të keni parasysh se pjesëmarrësit kanë të drejtën të refuzojnë pjesëmarrjen në studim, të refuzojnë që t'ju përgjigjen pyetjeve si dhe të drejtën të ndalojnë pjesëmarrjen në çdo moment që duan. Në fillim të intervistës apo të administrimit të pyetësorëve, duhet që gjithmonë t'i informoni pjesëmarrësit mbi këto të drejta.:

- ▶ të drejtën të refuzojë pjesëmarrjen në studim
- ▶ të drejtën të refuzojë që t'ju përgjigjet pyetjeve që nuk do t'ju përgjigjet; si dhe
- ▶ të drejtën të ndalojë së plotësuari pyetësori ose së dhëni intervistën në çdo moment që mund të dëshirojë, pa pasur pasoja dhe pa pasur nevojë t'i japë shpjegime dikujt.

Sidoqoftë në rastet kur një pjesëmarrës refuzon ose ndëpret pjesëmarrjen në studim përpikuni që, pa bërë presion mbi personin, të mësoni arsyet që e shtynë në këtë vendim:

- ▶ shkaku i mospjesëmarrjes/tërheqjes mund të vijë si rezultat i një faktori që mund ta diskutoni (si psh ndjenja turpi, frike, apo brerje ndërgjegje në rastin e një abuzuesi) ose që duhet ta diskutoni (psh shqetësim emocional i shkaktuar nga pyetjet e pyetësorit)
- ▶ mbledhja e këtij informacioni është shumë e rëndësishme për studime të ardhshme të kësaj natyre.

Pëlqimi i informuar

Çështjet etike janë shumë të rëndësishme për studimin tonë, për disa arsye:

- a) pjesëmarrësit janë fëmijë dhe prandaj duhet që pëlqimi për pjesëmarrjen e tyre të jepet nga prindërit ose kujdestarët e tyre
- b) në rastin kur informoheni (ose dyshoni) që një fëmijë (identitetin e të cilit ju e njihni) është viktimë e abuzimit apo neglizhimit, ju keni obligimin etik (dhe në disa raste ligjor) që ta raportoni këtë rast tek autoritetet përkatëse. Përkrah se raportimi mund të çojë në ndjekjen penale të prindërve të fëmijës ose/dhe në largimin e fëmijës nga familja, duhet t'i kushtoni vëmendje të veçantë Parimit Etik të Pëlqimit të Informuar.

Që pëlqimi që do merrni nga prindërit të konsiderohet “pëlqim i informuar -informed consent”, duhet t’ju jepni pjesëmarrësve të paktën informacionin e mëposhtëm:

- 1) qëllimin e studimit (me minimumin e mundshëm të fshehjes së informacionit), kohëzgjatjen dhe procedurat që do të përdoren
- 2) anonimitetin e të dhënave (si ato të marra nga pyetëtori dhe ato nga intervista)
- 3) të drejtën për të refuzuar pjesëmarrjen apo për t’u tërhequr
 - a. në çdo kohë
 - b. dhe pa pasoja
- 4) kufizimet e ruajtjes së konfidencialitetit
- 5) kë të kontaktojnë për pyetje mbi studimin, duke ju dhënë mundësinë pjesëmarrësve të bëjnë pyetje mbi studimin dhe të marrin përgjigje.

Megjithëse ky informacion ndodhet në fletat e pëlqimit për prindërit dhe fëmijët, është e rëndësishme t’jua përcillni gojarisht fëmijëve në klasa dhe prindërve që do të intervistoni ose që mund t’ju kontaktojnë për më tepër informacion mbi studimin.

D.4. Debriefing

Debriefing është shumë i rëndësishëm sidomos për faktin që pjesërisht po fshehim informacion nga pjesëmarrësit në lidhje me qëllimin e vërtetë të studimit. Gjatë plotësimit të pyetësorit/intervistës bëhet menjëherë e qartë që studimi përqëndrohet mbi dhunën ndaj fëmijëve. Duke qënë se nuk e kemi thënë këtë gjë që në fillim, duhet që në përfundim të mbledhjes së të dhënave t’ju japim pjesëmarrësve mundësinë të marrin informacion mbi studimin (gojarisht dhe nëpërmjet letrave falenderuese) dhe të korrigojmë ndonjë gjë që e kanë kuptuar gabim.

Për më tepër, një fëmijë ose një prind mund të dojë të flasë në lidhje me ndonjë eksperiencë të ngjashme me ato të përmendura në pyetësor. Duhet të jeni të përgatitur që ti ofroni pjesëmarrësve mundësinë që të flasin me ju në lidhje me këto çështje si dhe t’i këshilloni ku të kërkojnë ndihmë.(ISPCAN, 2006a). Për këtë arsye. letra e falenderimit ka një paragraf standard: pyetësori mund të flasë për çështje që mund të të mërzhisin ose të shqetësojnë dhe çdo pjesëmarrës në studim që ka pyetje mund të kontaktojë organizatën tonë.Gjithashtu, ju do keni me vete dhe një letër me numrat e të gjitha organizatave/institucioneve të zonës që mund të shërbejnë si pika referimi.

D.5. Siguria e të Dhënave

Duhet të jeni jashtëzakonisht të kujdesshëm kur të transferoni pyetësorët (ata bosh po sidomos ata që janë të plotësuar nga klasa në klasë ose nga shkolla në shkollë në mënyrë që të mos i humbni ose t'i ngatëroni dhe që të mos të lejoni njeri tjetër që të shohë të dhënat. Mbylleni zarfin ku do të vendosni pyetësorët e plotësuar në një klasë dhe mos e hapni derisa të arrini në një vend të sigurtë.

Mbrojeni me të gjitha mënyrat e mundshme konfidencialitetin e informacionit të marrë gjatë mbledhjes së të dhënave (shikoni dhe instruksionet mbi këtë gjë në kapitullin A.3) .

Nuk duhet t'i jepni pyetësor askujt (qoftë bosh qoftë të plotësuar) në cfarëdolloj rrethane, dhe siur persni që t'jua kërkojë të jetë një prind/mësues/drejtor shkolle/doktor. Mund të thoni: **“Më vjen keq, por nuk kam pyetësor bosh/ekstra”**. Nëse personi vazhdon të insistojë, referojini tek Koordinatori i projektit dhe thojini: **“Më vjen keq por nuk më lejohet që t'ju jap pyetësor. Mund të kontaktoni Z./Znj.Altin/Enila <në numrin e tel> për ta diskutuar me të”**.

D.6. Përshkrimi i Studimit në Publik

Kushtojini vëmendje të veçantë mënyrës sesi e përshkruani qëllimin në publik, domethënë në shkolla, në komunitet, ose dhe në nivel individual (p.sh. tek mësuesit, drejtorët e shkollave, personit që ju hap derën e shtëpisë ose që i përgjigjet telefonit, ose kujt do tjetër që ju pyet).

Përshkruajeni studimin duke përdorur gjithmonë të njëjtën mënyrë: “një studim që ka për qëllim studimin e çështjeve të lidhura me shëndetin e fëmijëve si dhe çështjeve të rritjes së fëmijëve dhe të marrëdhënieve të fëmijës me prindërit apo me fëmijë të tjerë”.

Sa herë që përshkruani studimin (anëtarëve të komunitetit apo të institucioneve private ose publike të vendit tuaj) kini parasysh që duhet të mbronni sigurinë e pjesëmarrësve në studim. Në çdo rast që mund të keni shqetësime mbi sigurinë e një fëmijë apo të rrituri (ose dhe në rast kur një pjesëmarrës ju shpreh shqetësim për sigurinë e tij/saj) mund ta këshilloni pjesëmarrësin që të përgjigjet në të njëjtën mënyrë, kur dikush tjetër i pyet në lidhje me studimin.

D.7. Si të veproni kur dikush ju raporton eksperiencë abuzimi

Kur një fëmijë ju kërkon ndihmë

Mënyra sesi ju reagoni ndaj kësaj kërkesë është shumë e rëndësishme. Inkurajojeni fëmijën që të flasë hapur dhe mos bëni komente gjykuese. Tregojini që **e kuptoni** dhe që po **e merrni seriozisht** atë që po ju thotë. Mos tregoni shenja mosbesimi.

Mbështeteni fëmijën dhe thojini:

- *bërë mirë që më fole për këtë gjë*
- *më vjen keq që të ka ndodhur një gjë e tillë.*
- *askush nuk meriton të trajtohet në këtë mënyrë*
- *çfarë të ka ndodhur ty nuk është për fajin tënd.*

Thojini fëmijës që ka persona që mund ta ndihmojnë dhe jepini numrin e ALO 116 ose të organizatave të tjera të zonës ku mund të telefonojë për ndihmë. Në asnjë mënyrë mos ja jepni informacionin të shkruar sepse po t'ja gjejë abuzuesi mund t'i bëjë më shumë keq. Sigurohuni që fëmija e mëson përmendësh numrin.

Përpiquni të **mbliidhni sa më shumë informacion** mbi:

- si mund të kontaktohet fëmija
 - identitetin e abuzuesit
 - llojin dhe nivelin e abuzimit
 - ndihmën e kërkuar më parë (persona ose institucione) dhe çfarë ka ndodhur më pas
- Veçanërisht në rastet me fëmijë më të rritur (dhe për raste jo të rënda dhune) investigoni me fëmijën cilat janë zgjidhjet që fëmija i konsideron si më të përshtatshme.

Në rastet e dhunës së rëndë (kur gjykoni se jeta e fëmijës është në rrezik), duhet ta informoni fëmijën që do e diskutoni rastin me supervisorin tuaj. Sigurisht që të gjitha rastet do ti diskutoni me koordinatorin tuaj.

Asnjëherë mos bëni (ose lini të nënkuptohen) premtime që nuk mund t'i mbani.

Lista e burimeve lokale (sipas zonës gjeografike)

Zona: Vlorë			
Instituti/Organizata	Kontakti	Adresa	Tel.
Drejtoria e Policisë	Ylli Metko	Vlorë	(033)223900/223910 / 0694102355
Spitali Vlorë		Lagjja "Partizani"	(033) 22657
Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve		Sheshi " 4 Heronjtë"	(033)222 985
Qendra Psiko-sociale "Vatra"	Vjola Metaj Brikena Puka Vera Lasko	Lagjia``Isa Boletini``,Rr.``Sadik Zotaj``,Pall.i Bankës Italo-Shqiptare	(033)224078/ 0692083349
Qendra e Zhvillimit Komunitar/Pak.	Edlira Gjonaj.	Lagjia``Pavarësia``,Rr. Vlorë-Shesh.	
Organizata "Fëmijët në fokus"	Luljeta Gusha	Lagjia``Pavarësia``,Rr.``Naim Frasheri``,Nr.13.	(033)224572
Shoqata "PRI-FEM"	Mira Osmani	Lagjia``28 Nentori``,Rr.``K.Nego"	(033)225336
Gjykata e Rrethit	Alma Dautaj	Vlorë	(033)222981
Shtëpia e Foshnjës 0-6 vjeç Vlorë	Olta Ganaj	Uji i Ftohtë/ Vlorë	0682096407
Psikiatria Vlorë	Antonela Agaj	Vlorë	(033)229897/ 0682079969
Terre des Hommes	Jonida Dhroso/ Ermonela Gurakuqi	Sheshi "4 Heronjtë"	(033)222985/ 0672087263/ 0689012193

Zona: Korçë			
Instituti/Organizata	Kontakti	Adresa	Tel.
Drejtoria e Policisë			(082)42919/ 42019
Spitali Korçë		28 Nëntori,Lagjia 7	(082)242972/ 2742/2755
Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve		Bulevardi"Fan.S.Noli"	(082)250 277
Sektori i Dhunës në Familje			0694108986
Misioni "Emanuel"	Mariela Baraku	Lagjia e re, Rruga e Unazës	
Qendër Ditore Korçë	Sirjeta	Korçë	(082)53711
DORCAS AID International Albania	Vjola Bogdani	Lagjia e re e sportit, Rruga e Unazës	(082)242115
Fondacioni "Ndihmë për Fëmijët"		Rr.``Nuçi Naçi``,Nr.55	(082)253795
Roma për Intergrim	Fatime Xhambazi	Lagjia 16,Rruga``Kiço Drenova``	(082)48850
Romani Baxt Albania	Miranda Fejzo		0692952631
Shoqata "Lulet e Vogla"	Rajmonda Trebicka	Bulevardi "Fan S. Noli"	(082)245423/ 0692132989
Terre des Hommes	Mariana Lara/ Alketa Zallemi	Bulevardi "Fan S. Noli"	(082)250277/ 0692504959/ 0682007462
Klinika Ligjore për të Mitur		Rruga``Floresha Myteveli``përballë bashkisë	(082)242115
Shoqata "Kabaja"	Rezul Duro	Rr.``Kajo Karafili``,Nr.19	(082)251213
Qendra Rezidenciale e Zhvillimit	Arjana Skllavi	Lagjia``Çlirimi i Korçës``,Nr.2	(082)242643
Shoqata e Përfitimit Fizik	Isuf Salçe	Rr.``6 Dëshmoret``,Lagjia 7, Nr.34	0692534907/ (082)242883
Fondacioni "Tabita"	Voltisa Furxhi	Blloku i Ri i Sportit, Rruga e Unazës,Godina e Dorcas Aid Albania,Korçë	(082)253884

Zona: Berat			
Instituti/Organizata	Kontakti	Adresa	Tel.
Urgjenca			(032)234222
Spitali Berat		Lagjia "Kushtrimi"	(032) 34237
Drejtoria e Policisë	Edmond Selma	Lagja 30 vjetori	0694103275
Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve		Bulevardi"Republika"	(032)231 978
Qendra e Këshillimit për Gra e Vajza	Lefteri Kosova	Pallati i Kulturës, kati 1	(032)231004
Kryqi i Kuq	Tatiana Toska	L. "Dëshmorët e Kombit" (pranë xhamisë)	(032)232916

Zona: Lushnjë			
Instituti/Organizata	Kontakti	Adresa	Tel.
Policia			(035)330/ 129/126
Spitali Lushnjë		Lagjja "Xhevdet Nepravishta" Rruga "Stadiumit"	(035) 22131
Shërbimi Primar Shëndetësor	Zeqime Sheme	Lagjja Kongresi	0692939115
Kryqi i Kuq	Luiza Petova	Përballë komisaritit	(035)223808

Zona: Fier			
Instituti/Organizata	Kontakti	Adresa	Tel.
Policia			(034)224000
Urgjenca			(034)222021, 222322
Spitali Fier		Lagjja "1 Maj" Rruga "Çamëria"	(034) 22761
Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve		Rr "Brigada e 12-të Sulmuese" Lgj "Kastriot"	(034)22092
Kryqi i Kuq		Lagjja "Apollonia"	(034)222099
Fondacioni PNUD		Lagjja "Kastriot"	(034)224537
Terre des Hommes	Alma Agalli/ Denisa Ahmeti	Rr. 'Brigada e 12-të Sulmues', Lgj. "Kastriot"	(034)22092/ 0692320724/ 0689012181/ 0682010929

Zona: Shkodër			
Instituti/Organizata	Kontakti	Adresa	Tel.
Policia			(022)243 232
Spitali			(022) 47289
Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve	Lgj "Qemal Stafa", Rr "13 Dhjetori"Nr.1		(022)255 755
Zyra për Mbrojtjen e Fëmijëve	Rudina Kruja	Lagjja "13 Dhjetori" Nr 1 Bashkia Shkodër	(022)243232
Drejtoria e Policisë-Qarku Shkodër/ Seksioni për Mbrojtjen e të Miturve dhe Dhunës në Familje	Gjovalin Preci	Lagjja ``Partizani``	
Klinika Ligjore për të Mitur		Rruga "Don Bosko", përballë Gjykatës	0682210379
Qendra "Don Bosko" Shkodër	Don Gino Martucci	Rruga "Don Bosko"	(022)242 101
Shoqata " Malteser"	Maranaj Marku	L.Perlat Rexhepi, Rr Ludovik Saraçi, nr 6	
Shoqata "Sos"	Helga Smakaj	L.Vasil Shanto ,Rr Marin Barleti	0682225686
Shoqata " Lvia"	Arsa Kaçurri	Rr Lin Delia, nr 36.	0682024859 ; 0682795582
Shoqata "Every Child" Shkodër	Alma Guli	Lagjja ``Tom Kola`` , Rr. ``Lin Delia``	
Shoqata "Kolping"	Andrea Darragjati	Sarreq ; Rr "Skenderbeg"	(022)2 45492/ 0684021759
Shoqata "Misionarët e Bamirësisë"	Motra Surgita	"Rr Marin Barleti", 68, Lagjja "Ndocmadhi"	(022)48356

Shoqata "Shpresa"	Silvana Vignali	L.``3 Heronjtë e Vigut``,Rr.``Pal Engjëli" Nr 5.	(022)45257/ 0684031029
Qendra "The Door"	Kastriot Faci	L.Naim Gjylbegu, Rr.Bujar Bishanaku, Nr 799	(022)243729

Zona: Lezhë			
Instituti/Organizata	Kontakti	Adresa	Tel.
Spitali Lezhë		Lagjia "Spitali"	(021) 54485
Këshillimi për Gra dhe Vajza			(021)52475
Kryqi i Kuq	Florinda Gjergji	Pallati pas stadiumit	(021)524571
CARITAS			(021)524886

Zona: Dibër			
Instituti/Organizata	Kontakti	Adresa	Tel.
Spitali Dibër		Bulevardi " Elez Isufi"	(218)2181
Prokuroria	Arben Nika	Bul. Elez Isufi	(218)2066 / (218)223508
Gjykata	Veat Aga	Lagjia Nazmi Rushit	(218) 30952062

Zona: Kukës			
Instituti/Organizata	Kontakti	Adresa	Tel.
Prokuroria	Hilmi Duraku	Lagjia 5	(024)222377
Fondacioni Rilindja			(024)22381
Fëmijët Jetimë	Tatjana Kerxhaliu	Lagjia 6, pas Shtypshkronjës	(024)22431
Qendra e Këshillimit të Grave dhe Vajzave	Vera Isetsaj	Hotel "Gjallica", kati i 2-të	(024)24278

Zona: Durrës			
Instituti/Organizata	Kontakt	Adresa	Tel.
Drejtoria e Policisë	Aleks Hajdari	Durrës	0694102933
Spitali (Urgjenca)	Fatmir Lama		(052 222222/ 0692512514
Drejtoria e Shërbimit Social - Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve	Olta Bajraktari	Qendra e të moshuarve ish URT	0672164470
Qendra e Zhvillimit B 16 Rezidencial -Valët e Detit	Xhulieta Hasko	Lagja 12 , Rr' Koco Kazanxhi"perball ish Cirku I vjeter	(052)22658
Kryqi i Kuq		Zyrat 18, Aleksandër Goga	(052)23867/24833
Terre des Hommes	Olta Bajraktari/ Floriana Aliu	Rr. "Sheshi Iliria", Lgj. Nr. 1	(052)224794
Sot për të Ardhmen	Menada Petro	Lagjia 17. Rr "Jeta e re"	(052)237003/ 0692488208
Qendra e Gruas me Probleme Sociale	Bajana Cevoli	Lagjia 2, Rr. "A.Goga", prapa gjykatës	(052)234600/ 0693751196
Dielli i Mëngjesit	Bledar Kodra	Lagjia 18	(052)238037/ 0694337651
Nehemia	Katerina Ormanidhi	Lagjia 14, Nish Tulla	(052)224226
PNUD	Darina Cani		0682094883
Shoqata Kombëtare e	Marjana Biba	Lagjia 7, Rr.H	0682159743

Jetimëve		Demiri	
Qendra Komunitare për të Rinjtë	Marvina Troka	Lagjia nr 15 pranë shkollës N.Babameto	0682159743
Observatori për të Drejtat e Fëmijëve	Izolda Canka		0682159743

Zona: Elbasan			
Instituti/Organizata	Kontakti	Adresa	Tel.
Policia			(054)59965
Spitali			(054)253409
Zyra e Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve	Nadire Kreka	Bashkia Elbasan, Godina Nr.2	0692295921
Tjetër Vizion	Teit Tabaku	Lagjia ``Aqif Pasha, ``Rr. ``Ali Arapi``	(054)252919
Drejtoria e Policisë-Qarku Elbasan-Zyra për Mbrojtjen së të Miturve dhe Dhunës në Familje	Fatbardha Menalla/Salla Operative		0694107561
Qendra Komunitare për Fëmijët dhe të Rinjtë Romë	Liman	Lagja 5 Maji, Rrapishtë	(054)57532
Motrat "Nënë Tereza"	Motra Rozita	Rr. ``Isuf Kondakciu``, Lagjia ``Hekurudha``	(054)252803
Kryqi i Kuq	Kriselda Pepa	Lagjia ``Kongresi i Elbasanit``, Pall.35/1	(054)253261
Fondacioni "Shtëpia e Shpresës"	Alban Medelko	Lagjia ``Visarion Xhuvani``, Rr. ``Rinia``, Nr.6	(054)252012 0694035910
Shoqata "Në dobi të Gruas Shqiptare – Njomzakët"	Marsida Dylgjeri	Pranë shkollës ``Naim Frashëri``	(042)23001
Shoqata "Forum i Gruas"	Dhoksi Quku	Lagjia ``5 Maji``, Rr. ``Fetah Ekmeciu``, P.450/1	(054)255509
Zyra Rajonale Shërbimi Social Shtetëror	Alda Biçoku	Lagjia ``Kongresi i Elbasanit``, Pall.35/3	(054)247201
Bashkia Elbasan – Seksioni i Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve		Lagjia ``Kongresi i Elbasanit``, Godina nr.2	0692295921
Terre des Hommes	Nadire Kreka/Ormela Jani	Lgj. "Kongresi i Elbasanit", Godina nr. 2	0692295921/ 0689012174

Zona: Tiranë			
Instituti/Organizata	Kontakti	Adresa	Tel.
Policia			129
Urgjenca			127
POLIKLINIKA NR.1		Lagjia Nr.1, pranë Ures se Tabakeve	(042)223138/ 0672508989
POLIKLINIKA NR.2	Mira Korfuzi	Lagjia Nr.2, prapa Rozafa Palace	(042)2371316
POLIKLINIKA NR.3	Shkendije Topi	Rr. ``Siri Kodra``ish Punishtja e Pastave	(042)364113
POLIKLINIKA NR.4	Artenca Collaku	Lagjia Nr.4, Rr. ``Siri Kodra``, Nr.103 Mbi Dispanserine	(042)223094

POLIKLINIKA NR.5	Pranvera Spahaj	Rr.``Islam Alla``,prane shkolles``Konferenca e Pezes``	(042)258174
POLIKLINIKA NR.6	Ramiz Kernaja	Rr.``Haki Stermilli``,Lagjia nr.6,Kombinat	(042)352111
POLIKLINIKA NR.8	Dhurata Meta	Qendra Shëndetësore/ Pallatet Moskat	(042)23367
POLIKLINIKA NR.9	Uljana Lekbello	Prane kryqezimit te 21 Dhjetorit	0692506723
POLIKLINIKA NR.10	Makbule Naipi	Lagjia Nr.10	0694026401
POLIKLINIKA E QYTET-STUDENTI	Gazmend Doda	Qytet Studenti	(042)348673
QËNDRA KOMUNITARE E SHENDETIT MENDOR,NR.1	Florida Dobi	Rr.``Stavri Vinjaku``.Mbrapa Ambasadës Amerikane	(042)375929
QËNDRA KOMUNITARE E SHENDETIT MENDOR,NR.2	Zana Kokomani	Pas Shkollës``Sabaudin Gabrani``,Ngjitur me çerdhen ``4 Stinë``	(042)259426
QËNDRA KOMUNITARE SOCIALE PËR FAMILJET DHE FEMIJËT NË NEVOJE	Donika Naqi	Rr.``Maliq Muca``,Mbrapa Zerit te Popullit	(042)234778
VIS-ALBANIA	Paola Dutto	Rr.Don Bosko	0682029419
ADRA/ KLINIKA SHËNDETËSORE FAMILJARE ADVENTISTE	Suzane Ilia	Rr.``Bedri Karapici``,Qyteti I nxenesve,Tirane,Kutia Postare 2403	(042)224027/ 0694073179
QËNDRA TERRES DES HOMMES	Edlira Bashmili	Rr.``Donika Kastrioti``,Vila 9/1	(042)258288/ 2251679
QËNDRA EKONOMIKE E ZHVILLIMIT DHE EDUKIMIT TË FËMIJEVE	Vasil Dhano	Rr.e Barrikadave/prapa Maternitetit te vjeter	
Qendra Sociale e Bashkisë së Tiranës	Orinda Alliu	Bulevardi Zogu I Pare,Pas Ministrise se Drejtesise	(042)34778
FËMIJËT TË PARËT	Flamur Gorica	Blv.``Gjergj Fishta``,Kulla 8,Ap.10	
QËNDRA E ZHVILLIMIT TË FËMIJEVE``PËLLUMBAT``	Eda Sherifi/ Alma Kapidanja	Rr.``Stavri Vinjau``,Mbas Ambasades Amerikane	(042)371206
QËNDRA PËR NISMA LIGJORE QYTETARE	Besa Saraci	Rr " Vaso Pasha "P 12, Ap 1, Shk 1	(042)259795
ARSIS/ ASSOCIATION FOR THE SOCIAL SUPPORT OF YOUTH	Zini Kore	Rr.``Sulejman Delvina``,Pallati Moskat 3,Shk.5,Ap.28,Tirane	(042)249879/ 0693862123
BETHANY SOCIAL SERVICES	Ermira Gjata./ Agim Xhumari	Rr.``Frederik Shiroka``,Kulla B-04./ Pallati I Brigadave,Sauk	(042)239297
QËNDRA SOCIALE``DON BOSKO``	Don Marek Gryn	Rr, Don Bosko	(042)40 59 51/ 069 40 54 009
KOMUNITETI``EMANUEL``, SHQIPËRI	Besa Rroshi	Rr.``e Duresit``.Pallati I ri,Prane gjimnazit``Qemal Stafa``	(042)258003
Q. E ZHVILLIMIT "SHTEPIA	Ingrid Trajani	Rr. "Myslym Shyri",	0692380666

E KUQE"		Pallati 44/3	
QËNDRA KOMBETARE E MIRËRRITJES,ZHVILLIMIT DHE REHABILITIMIT TË FËMIJEVE.	Aurora Cullufe	Rr.``Haki Stermilli``,Kombinat	
FËMIJET E BOTES DHE TË SHQIPËRISE-TË DREJTAT E NJERIUT./FBSH-DN	Klara Simoni	Rr.``Niko Avrami``, Nr.28,Tiranë	(042)378192
TË NDRYSHËM DHE TË BARABARTE	Mariana Meshi	Rr.``Bajram Curri``,Nr.31/1	(042)254532

Siguria e Pjesëmarrësve dhe Ekipit Kërkimor

Siguria e pjesëmarrësve duhet të jetë shqetësimi juaj i parë, por dhe **siguria juaj** është po aq e rëndësishme.

Kur ka probleme në lidhje me sigurinë, atëherë duhet të reagoni në mënyrën e duhur. Disa rregulla të përgjithshëm janë:

- Nuk duhet asnjëherë të shkoni në terren (shkollë apo shtëpi) vetëm; duhet që gjithmonë të jeni të shoqëruar me të paktën një koleg/e (qoftë dhe në rastin kur shkoni në një shtëpi sa për të marrë një pyetësor).
- Në terren duhet gjithmonë të mbaini në vend të duksëhm dokumentin që ju identifikon si staff të CRCA.
- Koordinator i studimit si dhe personi që ju shoqëron në terren duhet ta dinë gjithmonë vendndodhjen tuaj; informojini ata për ndryshime të papritura në itinerar.
- Studiuesit
 - Duhet ta ndalojnë intervistën sa herë që një person i tretë hyn në vendin ku po zhvillohet intervista, deri në momentin që rifitohet privacia.
 - Mos i administroni asnjëherë pyetësorët kur të tjerët (p.sh mësuesit) janë prezent në klasë.
- Duhet gjithmonë të përshkruani studimin në publik në mënyrë e parapërcaktuar (përshkruar në kapitullin D7)
- Ndiqni në mënyrë rigoroze Planin e Mbrojtjes së Sigurisë (përshkruar në kapitullin D8)

Plan Sigurie në rast se mendoni se ju (ose një fëmijë) jeni në rrezik

- Mos e humbni qetësinë dhe përpiquni të vlerësoni realisht rrezikun dhe seriozitetin e situatës
- Mbani gjithmonë me ju
 - Një celular i cili duhet të jetë i ndezur (por në opsionin qetësi) ku keni memorizuar numrin e koordinorit që në rast se ju duhet ta merrni në telefon
- Mbani me vete listën e numrave të emergjencës që do ju japë Koordinatori
- Mos shprehni agresion sado që të provokoheni nga dikush
- Mos u përpiqni ta zgjidhni vetë situatën. Në varësi të rastit:
 - Kërkoni nga kolegët tuaj, koordinatori, ose autoritetet lokale
 - Largohuni nga vendngjarja së bashku me kolegun tuaj; nëse nuk jeni bashkë, telefonojini që ta lajmëroni se po largoheni dhe se duhet të vijë me ju

- Telefononi sa më shpejt koordinatorin që ta informoni mbi incidentin
- Raportoni gjithçka në mbledhjet ditore supervizuere pavarësisht se sa të parëndësishme mund t'ju duken ju ose kolegëve tuaj.

D.8. Çfarë të bëni në rast se...

Çfarë të bëni në rast se një fëmijë...	
Refuzon të plotësojë pyetëtorin (shënon “Jo” në formën e pëlqimit)?	Në këtë rast fëmijës do i jepet një fletë bosh ku do të shkruajë një ese mbi marrëdhëniet prind-fëmijë
Kërkon të plotësojë pyetëtorin në klasë por prindi nuk ka dhënë pëlqim?	Thojini fëmijës që në vend të pyetëtorit do të bëjë një aktivitet tjetër: të shkruajë një ese mbi marrëdhëniet prind-fëmijë (tema e plotë do ju jetë dhënë më parë nga koordinatori). Në rast se fëmija insiston shumë të plotësojë pyetëtorin, lëreni fëmijën të plotësojë pyetëtorin po hiqeni pyetëtorin mënjandë dhe shënoni kodin. Informoni koordinatorin në mbledhjen e radhës.
Ju tregon eksperiencia abuzimi në pyetësor ose me fjalë?	Mblidhni informacion dhe raportojini rastin Koordinatorit. Nëse flisni vetë me fëmijën jepini informacion mbi burimet lokale.
Ju tregon së është viktimë e formave të rënda të abuzimit?	Mos i premtoni fëmijës se do e mbani sekret. Mblidhni informacion dhe raportoni tek Koordinatori.
Çfarë të bëni në rast se një mësues/e...	
Insiston të jetë prezent në klasë gjatë plotësimit të pyetëtorit	Thoni me edukatë por të vendosur: “Na vjen keq por nuk lejohet që tni klasë të ketë njeri tjetër përveç ekipit kërkimor dhe nxënësve” . Nëse insiston reforjeni tek drejtori i shkollës (nëse keni rënë dakort më parë) dhe/ose koordinatori juaj
Ju kërkon t'i jepni një pyetësor qoftë dhe për ta lexuar?	Thoni: “na vjen keq por nuk më lejohet”
Ju shpreh qëndrim negativ ndaj temës së studimit ose ndaj ekipit kërkimor	Nëse ju kërkohet një përgjigje, thoni me edukatë diçka neutrale si: “në shumë vende kjo është një çështje e rëndësishme” ose “për disa njerëz kjo është një çështje e rëndësishme”
Ankohet që nuk është informuar mbi studimin?	“Më vjen keq. Ndoshta keni të drejtë, por drejtorja arsimore e zonës tuaj ka komunikuar me drejtorin tuaj në lidhje me këtë çështje dhe ata janë në dijeni.”
Ju tregon për fëmijë konkretë që janë viktimë të abuzimit?	Përpiquni të mblidhni informacion dhe diskutoni në mbledhjet ditore të supervizimit me koordinatorin tuaj.
Ju tregon për një rast abuzimi por do të ruajë anonimatin?	Veproni si më sipër
Çfarë të bëni në rast se një prind...	
Telefonon ose ankohet në person për përmbajtjen e disa nga pyetjeve?	Përpiquni të identifikoni saktë cili është problem i prindit. Informojeni atë që abuzimi/neglizhimi janë problem të rënda në gjithë botën që dëmtojnë rëndë mirëqënien fizike dhe emocionale të fëmijëve. Shpjegoni që të gjithë fëmijët (përfhirë të tyre) kanë përfituar nga këto lloj studimesh sepse ato shërbejnë si thirrje

parandaluese duke ndërgjegjësuar fëmijët që nuk është turp të flasësh për këto çështje; i ndihmon ata të praktikojnë mënyra të ndryshme reagimi dhe i fton që të kërkojnë ndihmë në raste eksperiencash të tilla.

Nëse prindi vazhdon të insistojë referojini tek Koordinatori.

ANEKSET

Aneksi 1: Pyetjet e Mundshme të Pjesëmarrësve dhe Përgjigjet e Standartizuara

Pjesëmarrësit (prindër dhe fëmijë) mund t'ju bëjnë pyetjet e mëposhtme. Poshtë ju janë dhënë përgjigjet standarte për disa nga pyetjet që mund t'ju bëhen.¹⁴ Kujdesuni që të familjarizoheni me këto përgjigje si dhe me gjithë procedurat e projektit që të mund të adresoni me konfidencë çdo pyetje që mund t'ju bëhet.

Përgjigjet më poshtë janë të vlefshme si për fëmijët ashtu dhe për prindërit si dhe për rastet kur pyetësorët i plotësojnë vetë pjesëmarrësit apo kur i plotësoni ju nëpërmjet intervistave.

Për pyetjet e paparashikuara mos u përpiqni të jepni përgjigje nga mendja juaj; shënojeni këto pyetje dhe diskutojni gjate mbledhjes së supervizimit.

➤ Kush po e zhvillon këtë studim (ose kur shprehin dyshim në lidhje me organizatën që zhvillon studimin ose qëllimet e studimit)?

Ky studim po zhvillohet nga Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri në bashkëpunim me Departmentin e Shëndetit Mendor dhe Mirëqënies Sociale që ndodhet në Greqi. I njëjti studim është duke u zhvilluar njëkohësisht në 9 vende të Ballkanit (Shqipëri, Bosnie-Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Maqedonia, Greqia, Rumania, Serbia dhe Turqia). Të gjitha këto vende po punojnë së bashku që të kuptojnë më mirë problemet që mund të ndikojnë shëndetin fizik dhe mendor të fëmijëve si dhe problemet që prindërit mund të hasin gjatë rritjes së fëmijëve të tyre.

➤ Kush e financon këtë studim?

Studimi financonet nga Programi 7th Framework i Komisionit European dhe Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri.

➤ Do e nxirrni emrin tim? Si të sigurohem që do e ruani konfidencialitetin?

Prindërve	Fëmijëve
Emri juaj nuk del në asnjë vend në pyetësor. Ne duam vetëm të kombinojmë përgjigjet e të gjithë prindërve që marrin pjesë në studim dhe fëmijëve të tyre. Përgjigjet tuaja individuale nuk do raportohen. Të gjithë studiuesit në këtë studim janë trainuar mbi çështjet e konfidencialitetit dhe jemi të detyruar të ndjekim hapat e duhur që gjithë informacioni i marrë nga çdo pjesëmarrës të mbetet konfidencial. Askush nuk do i marrë vesh përgjigjet që më ke dhënë, përveç rasteve kur ti vetë do të m'i tregosh.	Emri juaj nuk del në asnjë vend në pyetësor. Ne duam vetëm të kombinojmë përgjigjet e të gjithë fëmijëve që marrin pjesë në studim. All researchers are especially trained for that. Askush nuk do i marrë vesh përgjigjet që më ke dhënë, përveç rasteve kur ti vetë do të m'i tregosh.

¹⁴ Ky aneks është bazuar në Manualin e ISPCAN për pyetësorin ICAST- CH (ISPCAN, 2006, faqe 6) dhe Manualin për pyetësorin ICAST-P (ISPCAN, 2006b, faqe.8).

Çfarë ndodh nëse nuk dua të marr pjesë ose dua të ndërpres pjesëmarrjen më vonë?

Prindërve	Fëmijëve
Asgjë! Nuk jeni i/e detyruar të merrni pjesë. Ne sigurisht që duam që ju të merrni pjesë pasi do donim të merrnin opinionin e sa më shumë prindërve. Përgjigjet tuaja dhe të fëmijës tuaj do na ndihmojnë që të ndërtojmë shërbime më të mira për fëmijët dhe familjet në nevojë. Gjithashtu, dua t'ju kujtoj se po të doni mund të zgjidhni pyetjet që nuk doni t'ju përgjigjeni ose të ndërprisni plotësimin e pyetësorit kur të doni dhe e njëjta gjë vlen dhe për fëmijën tuaj.	Asgjë! Nuk je i/e detyruar të merrni pjesë. Ne sigurisht që duam që të marrësh pjesë pasi do donim të merrnin opinionin e sa më shumë fëmijëve. Përgjigjet e tua do na ndihmojnë që të ndërtojmë shërbime më të mira për fëmijët dhe familjet në nevojë. Gjithashtu, dua të të kujtoj se po të duash mund të zgjidhni pyetjet që nuk do t'i përgjigjesh ose të ndërpresësh plotësimin e pyetësorit kur të duash.

Sa i gjatë është/Sa kohë do më duhet?

Për pyetësorin që e plotësojnë vetë

Prindërve	Fëmijëve
Zakonisht zgjat 15-25 minuta; megjithëse persona të ndryshëm ndryshojnë në sa kohë ju duhet, varet nga sa do të shkruash për të sqaruar përgjigjet.	Zakonisht zgjat 15-50 minuta. Por koha varet nga personi në person. Varet sa do të duash të shkruash për të sqaruar përgjigjet.

Intervista

Prindërve	Fëmijëve
Zakonisht zgjat 45 minuta megjithëse persona të ndryshëm ndryshojnë në sa kohë ju duhet, varet nga sa do të thoni për të sqaruar përgjigjet.	Zakonisht zgjat 50 minuta. Por koha varet nga personi në person. Varet sa do të duash të thuash për të sqaruar përgjigjet.

Nga e gjetët emrin /adresën/telefonin tim?

Për pyetësorin që e plotësojnë vetë

Prindërve	Fëmijëve
Ministria e Arsimit na dha listën e shkollave në zonën tuaj. Ne zgjodhëm disa shkolla në këtë zonë dhe shkolla e fëmijës tuaj u përzgjedh. Prandaj erdhëm tek ju pasi jemi të interesuar jo vetëm për përgjigjet e fëmijës tuaj por dhe për opinionin e prindërve. Ne nuk e dimë (dhe nuk kemi pse ta dimë) emrin tuaj.	Ministria e Arsimit na dha listën e shkollave në zonën tuaj. Ne zgjodhëm disa shkolla në këtë zonë dhe shkolla e jote u përzgjedh. Prandaj erdhëm tek ti. Ne nuk e dimë (dhe nuk kemi pse ta dimë) emrin tënd.

Intervista

Prindërve	Fëmijëve
-----------	----------

<p>Studimi po kryhet si me fëmijë që janë në shkollë dhe me ata që e kanë lënë shkollën. Qendra komunitare ku shkon fëmija juaj na dha kontaktet tuaja në mënyrë që ne të bëjmë një intervistë me fëmijën dhe me prindërit/kujdestarët. Prandaj dhe kemi ardhur tek ju dhe nuk na nevojitet emri juaj i plotë. Arsyeya e vetme pse kemi kërkuar kontaktet tuaja është që të kontaktonim bashkë dhe të të ftonim të merrje pjesë në studim.</p>	<p>Studimi po kryhet si me fëmijë që janë në shkollë dhe me ata që e kanë lënë shkollën. Qendra komunitare ku ti shkon f na dha kontaktet tuaja në mënyrë që ne të bëjmë një intervistë me ty dhe me prindërit/kujdestarët e tu. Prandaj dhe kemi ardhur tek ju dhe nuk na nevojitet emri juaj i plotë. Arsyeya e vetme pse kemi kërkuar kontaktet tuaja është që të kontaktonim bashkë dhe të të ftonim të merrje pjesë në studim.</p>
--	---

➡ Për çfarë do më pyesni?/Cili është qëllimi i këtij studimi?/Pse po e zhvilloni këtë studim?

Ne duam të mësojmë mbi marrëdhëniet prind-fëmijë dhe mënyrat e disiplinimit që prindërit përdorin dhe sa funksionojnë këto mënyra. Gjithashtu ne duam të studiojmë disa çështje të lidhura me shëndetin fizik dhe mendor të fëmijëve në familje. Përgjigjet tuaja dhe të fëmijës/prindit tënd janë shumë të dobishme për të krijuar shërbime për shumë familje të tjera.

➡ Si /Pse zgjodhët mua/fëmijën tim?

Pyetësi	Intervista
<p>Ne zgjodhëm rastësisht disa shkolla nga gjitha shkollat e zonës tuaj.</p> <p>Prindërit: Shkolla e fëmijës tuaj u përzgjidh dhe gjithë nxënësit e klasës së fëmijës tuaj (dhe prindërit e tyre) i kemi ftuar të marrin pjesë në studim.</p> <p>Fëmijët: Shkolla juaj u përzgjedh për studimin dhe prandaj jemi këtu.</p>	<p>Kemi ardhur tek ju pasi duam të marrim si opinionin e fëmijëve që janë në shkollë dhe të prindërve të tyre, por dhe të fëmijëve që kanë braktisur shkollën dhe të prindërve të tyre.</p> <p>Prindërit: Qendra komunitare ku shkon fëmija juaj është përzgjedhur që të jetë në studim dhe gjithë fëmijët e moshës së fëmijës tuaj dhe prindërit e tyre janë ftuar të marrin pjesë në studim.</p> <p>Fëmijët: Qendra komunitare ku ti shkon është përzgjedhur që të jetë në studim dhe prandaj erdhëm tek ty.</p>

➡ Ky studim po bëhet në gjithë Shqipërinë apo vetëm në zonën tonë?

Ky studim po bëhet njëkohësisht në gjithë Shqipërinë dhe në 8 vende të tjera të Ballkanit, si Greqi, Serbi, Bullgari, Bosnie, Maqedoni etj. Ne shkojmë në gjithë Shqipërinë dhe më saktë në këto zona: Kukës, Dibër, Lezhë, Shkodër, Berat, Fier, Lushnjë, Korçë, Vlorë, Tiranë, Durrës, dhe Elbasan.

Doni të mësoni nëse e abuzoj fëmijën tim?

Studimi ynë investigon eksperiencat e fëmijëve në shtëpitë e tyre. Ne duam veçanërisht të dimë mënyrat e ndryshme që prindërit dhe fëmijët përdorin për të komunikuar në lidhje me çështje të ndryshme dhe prandaj pyesim dhe prindërit dhe fëmijët. Njëra nga këto çështje është dhe disiplinimi i fëmijëve dhe nganjëherë ndodh që disa prindër i abuzojnë ose keqtrajtojnë fëmijët e tyre.

A i bëni të njëjtat pyetje fëmijës tim?

Ne e pyesim fëmijën për të njëjtat gjëra/çështje por pyetëori i tyre nuk është identik me tuajin. Gjithasht, ne e pyesim fëmijën tuaj dhe për eksperiencat e tij/saj me fëmijë të tjerë të së njëjtës moshë.

Përgjigje të standartizuara që duhet të përdorni nëse, gjatë mbledhjes së të dhënave, pjesëmarrësit ju kërkojnë sqarime mbi:

Nr. P	Pyetje mbi ICAST-CH (fëmijët)	Përgjigje e standardizuar
3	Duhet ta shkruaj emrin e shkollës këtu?	Po
5.2	Çfarë do të thotë “niveli i arsimit”?	Do të thotë sa shkollë kanë bërë prindërit e ty.
	Çfarë janë studimet pasuniversitare?	Studime që dikush bën mbasi ka mbaruar universitetin.
5_6	Ta vë dhe veten këtu?	Jo. Por shkruaj gjithë njerëzit e tjerë që jetojnë në të njëjtën shtëpi me ty.
	Gjyshi dhe gjyshja jetojnë në të njëjtën shtëpi/pallat por në kat/apartament tjetër; si të përgjigjem?	Nëse ti ndihesh sikur ata jetojnë në një shtëpi me ty, atëherë shkruaj PO; p.sh. nëse ti rri me ta çdo ditë ose pothuajse përditë dhe nëse ata kujdesen për ty, atëherë PO, ju jetoni bashkë.
	Çfarë do të thotë të afërm të tjerë? Duhet t’ju shkruajmë emrat?	Të afërm të tjerë janë persona që kanë lidhje gjaku me ju si teza, halla, daja, xhaxhallarë, kushërinj etj. Mos i shkruani emrat e tyre dhe mos shkruani asnjë emër në pyetësor që ta mbajmë pyetësorin anonim.
	Unë nuk jetoj në shtëpi por në një institut	Atëherë, shëno kutinë “Njerëz që nuk janë të afërm” dhe shkruaj emrin e institutit ku jeton. Nëse disa ditë në javë/muaj jeton dhe diku tjetër atëherë shëno dhe tek kutitë e tjera.
10.1	Çdo të thotë “i/e sigurtë”?	I/e sigurtë do të thotë që të ndihesh i/e mbrojtur, sikur askush nuk do të të bëjë keq dhe të ndihesh sikur nuk je në rrezik.
10.3	Duhet të zgjedh vetëm një kuti apo dhe më shumë?	Tek kjo pyetje mund të zgjedhësh sa kuti të duash.
11	Çfarë është “alkooli”?	Pije që përmbajnë alkool si verë, birra, raki apo pije të tjera.
	Po nëse ka ndodhur po nuk kisha frikë?	Përgjigju PO vetëm nëse diçka është e vërtetë për ty/të ka ndodhur ty; përndryshe përgjigju JO.
15α	Çfarë do të thotë “vlarë”?	Kur dikush ka vdekur se e ka vlarë dikush.
19B	Çfarë do të thotë “mallkuar”?	Mallkimi është kur dikush të thotë që dëshiron të të ndodhë diçka e keqe dhe ta uron që të ndodhë.
19.2	Çfarë do të thotë “të ka fajësuar”?	Kur dikush të thotë që diçka ka ndodhur për fajin tënd.
19.4	Për gjëra/situata të rëndësishme apo të parëndësishme?	Për çdo gjë; e rëndësishme ose jo.
19.5	“Më ka lavdëruar” do të thotë dhe kur më ka dhënë shpërblim/dhurata?	Lavdërim do të thotë kur dikush të thotë fjalë të mira për diçka që ke bërë.
19.7	Çfarë do të thotë “privilegje”?	Do të thotë diçka e veçantë që të jepet si psh të shohësh TV deri vonë ose të të japin diçka si një lodër

		por me kushtin që nuk e kesh/bësh më po u solle keq.
	Çfarë janë “paratë e xhepit”?	Paratë që të japin prindërit (njëherë në ditë, javë, muaj) që mund ta prishësh për vete.
22	Më ka thënë që do më lërë vetëm por unë e di që nuk e ka pasur me të vërtetë. Të përgjigjem po?	Përgjigju po dhe po të duash shkruaj më shumë tek kutia bosh më poshtë.
25	Më ka ndodhur por nuk jam ndjerë keq se e injorova atë fëmijën. Të përgjigjem po?	Jo. Përgjigju po vetëm nëse je ndjerë keq.
39A	Çfarë do të thotë kjo pyetje?	Do të thotë të rrish në gjunjë, me një këmbë, me fytyrë nga muri etj.
45A	Ku thotë “gjëra seksuale do të thotë dhe puthje/prekje?”	Po, dhe puthje e prekje.
11-14 18-24	Vetëm njerëzit e familjes që jetojnë në shtëpi me mua apo dhe të afërm të tjerë?	Përgjigju po vetëm nëse e ka bërë një person që jeton në shtëpi me ty; nuk ka rëndësi nëse ka ndodhur në shtëpi ose jo. Nëse e ka bërë një i afërm që nuk jeton me ty, përgjigju jo.
“Dëshiron të thuash diçka më tepër?”:		
	Është e detyrueshme të shkruajmë në këtë kuti?	Jo. Shkruani vetëm nëse doni të thoni diçka si psh kush e e ka bërë apo si ndodhi, apo nëse doni të shpjegoni diçka.
	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Sa shumë duhet të shkruaj? ▪ Sa detaje të jap? 	Nuk ka nevojë për shumë detaje. Shkruaj aq sa do të ndash me ne.
Për çdo pyetje		
	Po, <...> im e ka bërë por e kishte me shaka.	Po të duash, shkruaje në kutinë bosh më poshtë që ishte shaka, por përgjigju duke shënuar sa herë të ka ndodhur.
	Një fëmijë ju shpjegon diçka me fjalë dhe ju pyet, “ ta shkruaj këtë tek kjo pyetja”?	Nëse nuk jeni të sigurtë që përgjigja është PO/JO, duhet të thoni: <ul style="list-style-type: none"> ▪ “bëje si e mendon ti më mirë” ose ▪ “Përpiqu të japësh përgjigjen që tregon më mirë eksperiencën/mendimin tënd ” Për më tepër mund t’i thoni fëmijës: <ul style="list-style-type: none"> ▪ “shkruaj dhe në kutinë “Dëshiron të thuash diçka më tepër?”
Shkalla		
	A duhet patjetër të jap numrin ekzakt që diçka ka ndodhur?	Po! Por nëse e ke të vështirë të numërosh numrin ekzakt, atëherë thuaj përafërsisht (psh 13-50 herë gjatë vitit të fundit do të thotë disa herë në muaj).
	Nëse diçka ka ndodhur vetëm një herë dhe jo gjatë vitit të fundit, duhet të them “Asnjëherë” apo “ka ndodhur më parë”?	Shëno kutinë “jo gjatë vitit të fundit por më ka ndodhur më parë” Dhe —mund të shkruash që ka ndodhur vetëm një herë në kutinë bosh më poshtë.

Nr. p	Pyetje mbi ICAST-P (prindërit)	Përgjigje e standardizuar
5.1	Ta shënoj dhe fëmijën për të cilin po plotësoj pyetësorin (që jeton në të njëjtën shtëpi)?	Jo, duhet të shënoni TË GJITHË personat përveç fëmijës për të cilin po përgjigjeni. Për çdo person duhet të shënoni lidhjen që ka me fëmijën. Mos harroni të shënoni dhe veten..
6	Doni të thoni një person i tretë, përveç meje dhe babait/mamasë?	Jo, duam të themi –përveç teje- kush është personi i 2-të që kujdeset rregullisht për fëmijën. Ky person i 2-të mund të jetë prindi tjetër ose një person tjetër. Nëse ka më shumë se një person, tek pyetja 7 që vijon, duhet të zgjidhni vetëm një, personin që kujdeset rregullisht për fëmijën.
7.1 & 8-39a	Për cilin person duhet t’ju përgjigjem këtyre pyetjeve?	Në varësi të rastit, udhëzoheni prindin sipas mundësive të mëposhtme të renditura hierarkisht:

		<ul style="list-style-type: none"> ▪ Për prindin tjetër (nëse jetojnë bashkë) ▪ Për prindin tjetër jo biologjik (njerkun/njerkën) që jeton në një shtëpi me fëmijën ose për prindin tjetër të fëmijës (që jeton në një shtëpi tjetër) ▪ Për <... > që thatë në pyetjen 7 që kujdeset për fëmijën ▪ Për kë tjetër doni të përgjigjeni? (nëse asnjë nga mundësitë më lart nuk vlen)
	Është e vështirë për mua/nuk më takon /nuk dua të përgjigjem për prindin tjetër	Sigurisht që nuk jeni të detyruar dhe mund të vendosni të mos u përgjigjeni pyetjeve që nuk doni. Por, nëse nuk është shumë e vështirë, të lutem të përpiqesh t'ju përgjigjesh pyetjeve për prindin tjetër mesa mundesh.
	Nëse prindi vazhdon të refuzojë	Në rregull! Mund të përgjigjesh vetëm për veten.
8	Për gjëra/situata të rëndësishme apo të parëndësishme?	Për çdo gjë; pak rëndësi ka nëse çka bëri fëmija ishte e rëndësishme apo jo.
17a	Ja kam thënë <ul style="list-style-type: none"> ▪ <...> por nuk e kisha seriozisht ▪ Do ta lë tek <...> dhe <...> do ta marri Duhet të them PO?	PO. Kjo pyetje ju kërkon nëse e keni kërcënuar fëmijën, jo nëse e keni bërë me të vërtetë këtë gjë apo në keni ndër mend ta bëni.
24	Doni të thoni një shuplakë të vogël në vithe apo ndonjë gjë më të rëndë?	Ju pyesim për shuplakë, pavarësisht sa herë dhe sa fort e keni qëlluar.
28 a-b-c	Po nëse vetëm e kam kërcënuar po nuk e kam bërë ndonjëherë?	Pyetja është vetëm a e keni bërë dhe nëse po sa herë..
34a	E kam kërcënuar ta lëdoj por jo ta vras (ose anasjelltas)	Nuk ka rëndësi nëse ke bërë njërin ose të dyja nga këto.
34a	I kam thënë fëmijës "do të vras", por nuk e kisha seriozisht, e thashë me shaka.	Në këtë rast nuk quhet si kërcënim. Shënim: E mësipërmja vlen vetëm për rastet kur fraza përdoret në kuptim figurativ.
38.2	<ul style="list-style-type: none"> ▪ I kam bërë <...> fëmijës. Mendon se është ndjerë i turpëruar? ▪ E kam krahasuar me të tjerë por jo në mënyrë turpëruese ▪ Doja ta turpëroja por nuk u turpërua 	Nuk mund ta di sesi është ndjerë fëmija; vetëm ti mund ta dish nëse sipas mendimit tënd është turpëruar apo jo. Numëro vetëm rastet kur fëmija është turpëruar, pavarësisht nëse doje ta turpëroje ose jo.
42.1	Vetëm në shtëpi apo të përgjigjem dhe për në shkollë?	Jo, përgjigju vetëm nëse një fëmijë tjetër në shtëpi e ka bërë këtë gjë. .
45	Duhet të zgjedh vetëm një përgjigje apo dhe më shumë?	Për këtë pyetje mund të zgjedhësh sa përgjigje të duashn: duhet të shënosh TË GJITHA metodat që ti (ose prindi tjetër) përdorni me fëmijë dhe që funksionojnë, pra që e bindin të bëjë atë çka doni.
45	T'i përgjigjem pyetjes vetëm për mënyrat që përdor unë apo dhe për prindin tjetër??	Mund të përgjigjesh për të dy: për çka përdor ti dhe prindi tjetër për të ndryshuar sjelljen e fëmijës.
47 48	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Nga ta di unë? ▪ Këto pyetje janë shumë të përgjithshme ▪ Duhet t'ju përgjigjem të gjithave apo vetëm atyre që ja di përgjigjen 	Ne duam të dimë vetë opinionin tuaj në lidhje me këto çështje; nuk po ju pyesim çfarë ndodh në të vërtetë por çfarë mendoni ju se ndodh.
49i	Më ka sulmuar i dashuri. Vlen?	Po, vlen
49j	Cili është ndryshimi mes sulmit seksual dhe detyrimit për të bërë seks	Sulmi seksual përfshin të gjithë sjelljet seksuale përveç marrëdhënies me zor.
Pyetjet demografike		
1-6	Të përgjigjem për të dy prindërit apo vetëm për vete?	Për të dy; për vete në këtë kolonë (e majta për mamanë, e djathta për babanë) dhe në kolonën tjetër

		për prindin tjetër.
	Prindi tjetër nuk jeton më/nuk jeton me fëmijën. Duhet të përgjigjem për të?	Po
	Personi që jeton me fëmijën nuk është prindi, por bashkëshorti/partneri im. Për kë ta plotësoj kolonë?	Për prindin tjetër të fëmijës (pavarësisht në jeton me ju apo jo)
	[[ICAST-P plotësohet nga një kujdestar dhe jo nga prindërit: Për kë duhet ta plotësoj?	Për prindërit e fëmijës
Për çdo pyetje		
Ja kam bërë fëmijës por ishte	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Me shaka ▪ Aksident/pa dashje" 	Si për gjithë pyetjet e tjera duhet të shkruash sa shpesh ka ndodhur gjatë vitit të fundit apo në ka ndodhur më parë (pavarësisht në ishte shaka apo aksident) Përfundim: përdorimi figurative i frazës "Do të të vrasim gonna kill you" (shiko pyetjen 34a)
Shkalla		
Nëse diçka ka ndodhur vetëm një herë dhe jo gjatë vitit të fundit, duhet të them "Asnjëherë" apo "ka ndodhur më parë"?		Shëno kutinë "jo gjatë vitit të fundit por më ka ndodhur më parë"

Aneksi 2a: Forma Raportuese për Pyetësorët e plotësuar në Shkollë

Emri i Studiuesit 1:		Emri i Studiuesit 2:	
Emri dhe adresa e shkollës:		Nr i klasës dhe Nr i nxënësve në klasë (sipas gjinive):	Djem: Vajza:
Data dhe ora:	____/____/____	Nga: ____:____ Deri: ____:____	Kodet e pyetësorëve të plotësuar:

ICAST-CH		ICAST - P	
Refuzime nga fëmijët për të plotësuar pyetësorin		Refuzime nga prindërit	
Sa?	Cilat numra serial?	Sa përgjigje negative pjesëmarrjen tyre?	Arsyet (nëse dihen)
Arsyet (nëse dihen):			
Pëlqimi i prindërve		Mënyra e mbledhjes së të dhënave për ICAST-P	
Sa përgjigje negative për pjesëmarrjen e fëmijëve?	Sa forma pëlqimi të pakthyer?	<input type="checkbox"/> I plotësuar vetë <input type="checkbox"/> i mbledhur në shkollë <input type="checkbox"/> vizitë tek prindërit: _____ <input type="checkbox"/> Intervista: _____	
Shënime mbi pyetësorët		Pyetësorët e prindërve që mungojnë	
		Numrat serial	Shënime
RASTE TË RAPORTUARA ABUZIMI (specifikoni):		Shënime:	

Aneksi 2b: Forma Raportuese për Intervistat e Strukturuar

Emri i intervistuesit:	Emri i studiuesit 2:
Data dhe ora:	Nga: ____ : ____ Deri: ____ : ____
Personi i intervistuar:	<input type="checkbox"/> Prindi <input type="checkbox"/> Fëmija

A/A	Nr serial	Refuzime nga prindërit	Shënime
1		<input type="checkbox"/> për pjesëmarrjen e fëmijëve <input type="checkbox"/> për pjesëmarrjen e tyre Arsyet	
		Refuzime nga fëmija	
		Arsyet	
2		<input type="checkbox"/> për pjesëmarrjen e fëmijës <input type="checkbox"/> për pjesëmarrjen e prindërve Arsyet	
		Refuzime nga fëmija	
		Arsyet	
3		<input type="checkbox"/> për pjesëmarrjen e fëmijës <input type="checkbox"/> për pjesëmarrjen e prindërve Arsyet	
		Refuzime nga fëmija	
		Arsyet	

Aneksi 3a: Kartat e Intervistës për Prindërit
(të printohen nga të dy anët)

Prisni kartat ku tregohet dhe shpërndajani kërkuësve. Meqë shkallët e përgjigjes nuk janë të njëjta për të gjitha pyetjet, nga njëra anë tregohet cili numër i pyetjes i korrespondon shkallëve.

- **Asnjëherë në jetën time**

Gjatë vitit të fundit (gjatë 12 muajve të fundit):

- **1 - 2 herë (një ose dy herë në vit)**
- **3 - 5 herë (disa herë në vit)**
- **6 - 12 herë (një herë në muaj ose dy muaj)**
- **13-50 (disa herë në muaj)**
- **Më shumë se 50 herë (një herë në javë ose më shpesh)**
- Jo gjatë vitit të fundit por **ka ndodhur më parë**
- Nuk dëshiroj të përgjigjem



- **Pothuajse gjysma**
- **Më shumë se gjysma**
- **Rreth gjysma**
- **Më pak se gjysma**
- **Pothuajse asnjë/ Asnjë**

Prindi: Pyetjet 8-42a

Prindi: Pyetjet 47 - 48

- **Shumë herë**
 - **Nganjëherë**
 - **Një ose dy herë**
 - **Asnjëherë**
-
- **Nuk e di/Nuk më kujtohet**
 - **Nuk dëshiroj të përgjigjem**



- **Jo, nuk sjell rezultat**
- **Në shumicën e rasteve nuk sjell rezultat**
- **Në shumicën e rasteve sjell rezultat**
- **Po, sjell rezultat**

Prindi: Pyetjet 49 a-j

Prindi: Pyetja 50

- | | |
|--|--|
| <input type="checkbox"/> Të flas dhe diskutoj me të | <input type="checkbox"/> Të mos i jap për të ngrënë apo pirë, ta mbyll në shtëpi |
| <input type="checkbox"/> T'i shpjegoj pse diçka është e gabuar | <input type="checkbox"/> Ta ndëshkoj fizikisht (ta qëlloj, ta rrah) |
| <input type="checkbox"/> T'i ndaloj diçka (psh TV, aktivitetet sportive, paratë e xhepit, celularin) | <input type="checkbox"/> Ta paralajmëroj për pasojat e sjelljes së tij/saj |
| <input type="checkbox"/> Ta lavdëroj dhe përgëzoj | <input type="checkbox"/> T'i bërtas |
| <input type="checkbox"/> T'i premtoj shpërblime (psh dhurata) | <input type="checkbox"/> Të vendos rregullat bashkë me të |
| <input type="checkbox"/> Ta krahasoj me fëmijët e tjerë | <input type="checkbox"/> Të vendos rregulla të rrepta |
| <input type="checkbox"/> Ta bind që të bëjë diçka | <input type="checkbox"/> Të vendos rregulla të qëndrueshme |
| <input type="checkbox"/> Ta këshilloj | <input type="checkbox"/> Të sillem vetë si e këshilloj atë të sillet (t'i |
| <input type="checkbox"/> Të mos i flas me gojë kur bën diçka të gabuar (jap shembullin e mirë) | <input type="checkbox"/> Tjetër (shkruani): _____ |
| <input type="checkbox"/> Ta lë të mësojë nga gabimet e veta duke vuajtur pasojat e sjelljes së tij/saj | <input type="checkbox"/> Tjetër (shkruani): _____ |
| <input type="checkbox"/> Të dëgjoj shpjegimet që më jep për sjelljen e tij/saj | |

Prindi: Pyetja 45

Aneksi 3b: Kartat e Intervistës për Fëmijë

(të printohen nga të dyja anët)

Prisni kartat ku tregohet dhe shpërndajani kërkuesve. Meqë shkallët e përgjigjes nuk janë të njëjta për të gjitha pyetjet, nga njëra anë tregohet cili numër i pyetjes i korrespondon shkallëve.

Shënim: Në rast kur në gjuhën tuaj gjinia mashkullore dhe femërore shprehen me forma të ndryshme, ju lutemi të krijoni karta të ndryshme për djemtë dhe vajzat për pyetjet 15-17

Prindërit e tu janë:

- Të martuar
- Të divorcuar/të ndarë
- Nuk janë martuar
- Të ve (njëri nga prindërit nuk jeton më)

- Nuk dëshiroj të përgjigjem
- Nuk e di



Niveli i arsimit i prindërve të tu është/ishte:

- Nuk ka shkuar në shkollë
- Disa klasë të fillores(sa? _____)
- 8-vjeçar
- I mesëm
- Shkollë profesionale
- Universitet
- Studime pasuniversitare (master, doktoraturë)

- Nuk e di

Fëmijë: Pyetja 5.1

Fëmijë: Pyetja 5.2

- **Gjithmonë**
- **Zakonisht**
- **Pak herë**
- **Asnjëherë**



- **Asnjëherë në jetën time**

Gjatë vitit të fundit (gjatë 12 muajve të fundit):

- **1 - 2 herë (një ose dy herë në vit)**
- **3 - 5 herë (disa herë në vit)**
- **6 - 12 herë (një herë në muaj ose dy muaj)**
- **13-50 (disa herë në muaj)**
- **Më shumë se 50 herë (një herë në javë ose më shpesh)**
- Jo gjatë vitit të fundit por **ka ndodhur më parë**
- Nuk dëshiroj të përgjigjem

Fëmijë: Pyetja 10.1 – 10.2

Fëmijë: Pyetja (11-14) & (18A – 46)

- **Po**
- **I pasigurtë**
- **Jo**
- Jo gjatë vitit të fundit por **ka ndodhur më parë**



- **Po**
- **E pasigurtë**
- **Jo**
- Jo gjatë vitit të fundit por **ka ndodhur më parë**

Fëmijë (Vajzë): Pyetjet (15a - 17)

Fëmijë (Djalë): Pyetjet (15a - 17)

- | | |
|---|---|
| <input type="checkbox"/> Të diskutojnë dhe të flasin me mua | <input type="checkbox"/> Të mos më japin për të ngrënë ose të më mbyllin në shtëpi |
| <input type="checkbox"/> Të më shpjegojnë pse diçka është e drejtë ose e gabuar | <input type="checkbox"/> Të më ndëshkojnë fizikisht (p.sh. të më rrahin) |
| <input type="checkbox"/> Të më ndalojnë diçka (p.sh. TV, aktivitetet sportive, lekët, celularin) | <input type="checkbox"/> Të më paralajmërojnë për pasojat e sjelljes time |
| <input type="checkbox"/> Të më lavdërojnë | <input type="checkbox"/> Të më bërtasin |
| <input type="checkbox"/> Të më premtojnë shpërblime (p.sh. të më blejnë dhurata) | <input type="checkbox"/> Të vendosin rregullat bashkë me mua |
| <input type="checkbox"/> Të më krahasojnë me fëmijë të tjerë | <input type="checkbox"/> Të më vënë rregulla të rrepta |
| <input type="checkbox"/> Të përpiqen të më bindin për diçka | <input type="checkbox"/> Të më vënë rregulla të përcaktuara dhe të qëndrueshme |
| <input type="checkbox"/> Të më japin këshilla | <input type="checkbox"/> Të sillen vetë siç më këshillojnë mua (të japin vetë shembullin e duhur) |
| <input type="checkbox"/> Të mos më flasin me gojë kur bëj gabim | <input type="checkbox"/> Tjetër (shkruaj çfarë): _____ |
| <input type="checkbox"/> Të më lënë të vuaj pasojat e sjelljes time që të mësoj nga gabimet e mia | <input type="checkbox"/> Tjetër (shkruaj çfarë): _____ |
| <input type="checkbox"/> Të dëgjojnë shpjegimet e mia për sjelljen time | |

Fëmijë: Pyetja 10.3

Aneksi 4a: Pyetësori i modifikuar ICAST-CH

Aneksi 4b: Pyetëtori i modifikuar ICAST-P